

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime

2019



Publikuar nga Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Rr. "VIKTOR EFTIMIU" Nd. 1, Njësia Administrative Nr.5, 1022
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel: +355 42 258 046
Faqja e internetit: www.erru.al
©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Tetor 2020

PËRMBAJTJA

Shkurtime	2
Përmbledhje	3
Hyrje	8
1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca	10
1.1 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin	10
1.1.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)	11
1.1.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale	12
1.1.3 Norma e Arkëtimit	15
1.1.4 Niveli i Matjes	16
1.1.5 Efiçenca e Stafit	17
1.1.6 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	17
1.1.7 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe të KUN	18
1.2 Rezultatet Financiare të Sektorit	19
1.2.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet	19
1.2.2 Nevoja për Investime Kapitale dhe Financimi i Sektorit UK	21
Investimet nga Buxheti i Shtetit	21
Investimet nga Donatorët e Huaj	22
1.3 Reforma në Sektor dhe Nevoja për Agregim.....	23
1.4 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave.....	25
2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime	26
2.1 Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Grupimeve të Shoqërive UK.....	26
2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU	28
2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës	29
2.3.1 Uji Pa të Ardhura	29
2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M	34
2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale	41
2.3.4 Norma e Arkëtimit	43
2.3.5 Niveli i Matjes	47
2.3.6 Efiçenca e Stafit	52
2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	59
2.3.8 Mbulimi me Kanalizime	63
3 Konkluzione dhe Rekomandime	69
4 Tema e Veçantë : Përballueshmëria (Affordabiliteti) e Pagesës së Faturës së Ujit (Studim nga ERRU, Tetor 2019)	70
5 Aneke: Të dhënat Kryesore të Sektorit	78

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjiellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUM	Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesor të Performancës
OAF	Operator i Alternativës së Fundit
SKP	Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operim dhe Mirëmbajtje
NAP	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme
NAK	Norma e Arkëtimit Korente
UPA	Uji Pa të Ardhura

Përmbledhje

Qëllimi i Raportit të Performancës, si Instrument Analize, Informimi dhe Transparence i Sektorit UK

Raporti i Performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve për vitin 2019 hartuar nga ERRU, ka për qëllim informimin dhe transparencën ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit në nivel qendror dhe lokal. Në të pasqyrohet analiza e sektorit në përgjithësi dhe të secilës shoqëri UK në veçanti duke bërë krahasimin me vitin paraardhës (benchmarking). Raporti përmbledh gjithashtu rekomandimet përkatëse për përmirësimin e performancës së sektorit në përputhje me stadin aktual të reformës së këtij sektori që qeveria qendrore ka iniciuar prej 3 vitesh.

Hartimi dhe publikimi i raportit është kushtëzuar nga koha kur shoqëritë UK dorëzojnë zyrtarisht të dhënat ekonomike financiare të certifikuara (Bilancet Financiare). Arsyeja që këtë vit publikimi i raportit bëhet relativisht me vonesë është sepse këtë vit referuar Aktit Normativ të Kryeministrit Nr. 10, datë 26.3.2020 për shkak të pandemisë COVID 19 shoqëritë UK i dorëzuan ato në fund të muajit korrik në vend të fundit të marsit. ERRU me anë të këtij Raporti realizon detyrimin që e ngarkon ligji duke dhënë vlerësimin në lidhje me performancën e sektorit në pozita asnjëse si institucion i pavarur.

Cilësia e Shërbimeve, Bilanci Financiar dhe Treguesit Kryesorë të Performancës së Sektorit UK

Gjatë vitit 2019 në sektor, si rezultat i investimeve fizike të suksesshme nga Qeveria Qendrore nëpërmjet AKUM-it është përmirësuar cilësia e shërbimeve, veçanërisht në qytetet Tepelenë, Memaliaj, Përmet dhe Cërrik. Tashmë këto qytete furnizohen me ujë 24 orë në ditë duke iu bashkangjitur listës së 9 qyteteve, përkatësisht Korçë, Pogradec, Fier, Lezhë, Fushë Arrëz, Tropojë, Bilisht, Konispol dhe Maliq, të cilat kanë realizuar që në vitet e mëparshme një furnizim me ujë pa ndërprerje për popullsinë.

Për vitin 2020 nga investimet e qeverisë qendrore nëpërmjet AKUM pritet që të realizohet furnizimi me ujë për 24 orë/ditë edhe për 8 qytete të tjerë, përkatësisht, Pukë, Vau Dejës, Koplik, Krujë, Peqin, Këlcyrë, Ersekë, Rrëshen dhe Poliçan, që e çon në fund të vitit 2021 në 22 numrin e qyteteve të furnizuara me ujë pa ndërprerje në të gjithë vendin. Qeveria qendrore nëpërmjet AKUM ka në objektivin e saj afat shkurtër që nga 66 qendra urbane në vend, 52 prej tyre do të kenë furnizim me ujë pa ndërprerje deri në fund të vitit 2021, dhe 58 deri në fund të vitit 2023.

Performanca financiare e sektorit për vitet 2018 dhe 2019 jepet në mënyrë të përmbledhur në tabelën 1 të mëposhtme.

Tabela 1. Performanca financiare e sektorit për vitet 2018 dhe 2019.

Nr.	Zërat e Shpenzimeve	Viti 2018 (në 000 lekë)	Viti 2019 (në 000 lekë)	Diferenca 2019/2018 (në 000 lekë)	Diferenca 2019/2018 (në %)
1	Kostot e O&M	8,226,890	9,113,875	+886,985	+11%
2	Kostot Kapitale	2,453,231	3,480,569	+1,027,338	+42%
3	Kostot Totale	10,680,121	12,594,444	+1,914,323	+18%
4	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	9,799,216	9,763,452	-35,764	-0,4%
5	Të Ardhurat nga Subvencionet	1,055,910	700,000	-355,910	-34%
6	Totali i të Ardhurve	10,855,126	10,463,452	-391,674	-3,6%
7	Mbulimi i Kostove O&M	132%	115%		-17%
8	Mbulimi i Kostove Totale	102%	83%		-19%

Siç shihet nga tabela e mësipërme, gjendja financiare e sektorit UK për vitin 2019 është përqësuar krahasuar me vitin 2018 në drejtim të mbulimit të kostove të O&M dhe atyre totale. Gjendja financiare për pjesën më të madhe të shoqërive UK është akoma e paqëndrueshme, ku 43 nga 57 shoqëri UK në të gjithë vendin nuk arrijnë të mbulojnë Kostot Direkte të Operim-Mirëmbajtjes me të ardhurat.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 9 763.5 milion lekë të ardhura, por krahasuar me vitin paraardhës të ardhurat nga aktiviteti janë ulur me 35.7 milion lekë. Të ardhurat nga aktiviteti kanë mbetur pothuajse konstante, por janë ulur me rreth 30% të ardhurat nga subvencionet. Të ardhurat kanë pësuar rënie të konsiderueshme në shoqëritë e mëdha (Grupi I-rë)¹ me 133 milion lekë, veçanërisht në shoqëritë UK, Tiranë, Durrës, Kamëz dhe Lezhë, ku rënia e të ardhurave ka ardhur si pasojë e dy tërmeteëve që goditen këto qytete, ku praktikisht një pjesë e mirë e konsumatorëve nuk u faturua sidomos për dy muajt e fundit të vitit. Ndërkohë gjendjen e sektorit e kompenson disi Grupi i II-të i shoqërive të cilat rezultojnë në total me plus 135 milion lekë të ardhura të realizuara, ku veçohen shoqëritë, Gjirokastër, Cërrik, Dibër, Librazhd, Dropull dhe Malësi e Madhe.

Në të ardhurat negativisht ka influencuar gjithashtu zvogëlimi i shumës së subvencioneve të akorduara nga buxheti me rreth 300 milion lekë më pak krahasuar me një vit më parë. Në përqësimin e gjendjes së tablosë së përgjithshme të sektorit krahasuar me një vit më parë, ka influencuar edhe rritja e kostove, përkatësisht për kostot e O&M nga rritja e zërave të kostove të energjisë, të materialeve dhe të shërbimeve të nënkontraktuara. Rritjet e kostove kanë ardhur kryesisht nga shtimi në zonën e shërbimit të ujësjellesave të zonave rurale, ndërsa Kostot Totale janë rritur nga zërat, amortizim i aseteve dhe interesat e kredive.

Për të mbuluar diferencat e kostove të O&M me të ardhurat nevoja reale për subvencione për vitin 2019 llogaritet në 1,340.5 milion lekë (rreth 10.7 milion euro) ndërkohë që fondi i akorduar shoqërive si subvencion ishte rreth 700 milion lekë (5.7 milion euro). Përgjithësisht diferenca e pa mbuluar e kostove të O&M me subvencione ka patur si konsequencë mospagimin e faturave të energjisë elektrike të shoqërive ndaj OSHEE-së duke rritur më tej borxhin e shoqërive ndaj këtij të fundit.

Vlerësohet pozitivisht fakti që AKUM një pjesë të mirë të subvencioneve (300 milion lekë) e ka shpërndarë si incentiva performance për investime fizike për shoqëritë, Korçë, Berat-Kuçovë, Librazhd dhe Pogradec, të cilat i mbulojnë kostot O&M me të ardhurat nga aktiviteti.

Performanca e sektorit të UK jepet në mënyrë të përmbledhur në Tabelën 2 bazuar në Treguesit Kryesorë të Performancës që ERRU përdor për të vlerësuar performancën e shoqërive UK.

1

Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjellës Kanalizme
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjellës Kanalizme
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjellës Kanalizme

Tabela 2. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK (TKP)

Treguesit e Performancës	2018	2019	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
Uji Pa të Ardhura (%)	63	63.7	↘	30
Mbulimi i Kostove O&M (%)	119	107.1	↘	100
Mbulimi i Kostos Totale (%)	92	77.5	↘	80
Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	98	95.8	↘	82
Norma e Arkëtimit Korente(%)	79	79.8	↗	82
Niveli i Matjes (%)	74	77.3	↗	85
Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	5.35	5.33	↗	4/6/10
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	12.7	13.3	↗	18
Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	52	51	↘	75
Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	77	76.8	↘	n/a

Burim informacioni: ERRU

Nga tabela vërehet që nivelet e TKP për sektorin për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 kanë tendencë negative për 6 tregues, ndërsa 4 treguesit e tjerë janë përmirësuar.

Cilësia e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve në drejtim të kohës së furnizimit me ujë (mesatarisht 13.3 orë/ditë), treguesi i Niveli i Matjes (77.3%), Norma e Arkëtimit Korente (79.8%) krahasuar me vitin 2018, edhe pse janë përmirësuar mbeten përsëri jo në nivelet që ERRU konsideron për performancë të mirë. Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit (mesatarisht 5,33 staf/1000 lidhje) ka një përmirësim të lehtë edhe pse sektori vazhdon të paraqitet i mbingarkuar me staf.

Treguesi Mbulimi i Kostove O&M paraqitet në nivel të mirë, por me një rënie të ndjeshme kundrejt vitit 2018 për shkak të rritjes së kostove krahasuar me një vit më parë. Përkeqësim të madh ka pësuar dhe treguesi Mbulimi i Kostove Totale në 77.5% nga 92% që ishte në vitin 2018.

Me rënie, por në nivele të ulëta janë dhe Treguesit Mbulimi me Furnizimin me Ujë dhe KUN dhe Uji Pa të Ardhura. Treguesi i fundit gjithsesi duhet marrë me rezervë sepse një pjesë e mirë e ujit të prodhuar nuk llogaritet me matje, por me vlerësim empirik.

Reforma e Qeverisë në Sektorin UK dhe Agregimi i Shoqërive UK

Reforma në Sektorin UK iniciuar në janar 2016, sipas VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e sektorit UK” është akoma në proces zbatimi. Si rezultat deri në fund të vitit 2019, vetëm 37 shoqëri UK kanë përfunduar riorganizimin e tyre dhe janë licencuar nga ERRU sipas reformës.

Reforma po ndiqet nga afër gjithashtu edhe nga AKUM në zbatim të kontratave të performancës të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Bashkive bazuar në tregues performance që kushtëzojnë edhe shpërndarjen e subvencioneve, si dhe të incentivave për investimet fizike.

Në fund të vitit 2019, për përshpejtimin dhe arritjen e përmirësimit të gjendjes në sektor, MIE përpiloi një qasje që është përfshirë në Projekt-Ligjin për Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve, por që akoma është pranë Këshillit të Ministrave për aprovim. Në princip, qasja propozon agregimin e detyruar të shoqërive me performancë të dobët duke i menaxhuar ato me anë të subjektit Struktura e Kompetencave të Përbashkëta (SKP).

Gjithsesi nevoja për agregim është imediate pasi një sektor mjaft i fragmentarizuar me 57 shoqëri UK vuan nga mungesa e ekonomisë së shkallës dhe operon me kosto mjaft të larta. Krahas qasjes së mësipërme ERRU propozon seleksionimin e 2-3 rasteve të mundshme të një agregimi të suksesshëm sipas parimit me baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria

qendrore. Këto raste pozitive do të shërbejnë më tej si bazë për agregimin aty ku është e mundshme për të gjithë sektorin

Vështirësitë e Shoqërive UK për tu Licencuar pranë ERRU

Shoqëritë UK përgjithësisht ato të vogla kanë vështirësi për përmbushjen e kushteve për tu licencuar në përputhje me kërkesat ligjore. Shkaqet kryesore janë mungesa në kapacitetet njerëzore kryesisht të drejtuesve teknikë me diplomimin e duhur, si dhe pajisja e shoqërive me Akt Miratimin Higjeno-Sanitar nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror. Procedura për përfitim të këtij Akti duhet rishikuar sepse ka paqartësi, si dhe plotësimi i kushteve ligjore aktuale për përfitim të tij kërkon vlera mjaft të mëdha të investimeve fizike që veçanërisht shoqëritë e vogla nuk mund ti plotësojnë.

Planet e Biznesit 5 Vjeçare si Instrument i Përmirësimit të Menaxhimit të Shoqërive UK Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave të Raportuara nga Shoqëritë UK

Në Planet 5 Vjeçare të Biznesit të shoqërive UK pasqyrohen Treguesit Kryesorë të Performancës si objektiva përmirësimi për çdo vit, planet e veprimit, programi i përmirësimit të menaxhimit dhe investimeve fizike të domosdoshme për arritjen e objektivave. Ka mjaft Shoqëri UK ku mungojnë Planet e Biznesit 5 vjeçar, të cilat duhet të hartohen me prioritet. Kjo gjendje është e evidente kryesisht për shoqëritë e vogla, të cilat nuk kanë kapacitete dhe mjetet e duhura financiare për realizimin e tij, hartimi i të cilave duhet të mbështetet financiarisht nga buxheti dhe/ose donatorët.

Raporti i Performancës për vitin 2019 është hartuar mbi bazën e të dhënave dhe informacionin e grumbulluar për herë të parë nga njësia e monitorimit pranë ERRU-së. Besueshmëria dhe saktësia tekniko-ekonomike mbetet akoma problem që konstatohet gjatë verifikimeve të Bilanceve Financiare, Bilanceve të Ujit, por dhe gjatë aplikimeve nga shoqëritë UK për tarifa të reja. ERRU e ka në qendër të vëmendjes përmirësimin e besueshmërisë së bazës së të dhënave dhe është duke intensifikuar kërkesën ndaj shoqërive UK në mënyrë që të rrisin përgjegjshmërinë e tyre gjatë raportimit të të dhënave të kërkuara.

Shoqëritë UK Janë të Mbingarkuara me Staf

Efektet e riorganizimit të shoqërive vazhdojnë të ndihen sidomos në drejtim të rritjes së stafit operues. Për vitin 2019 ky tregues është në vlerat 5.33 staf/1000 lidhje UK, që ende mbetet larg nivelit të kërkuar. Në fakt stafi në total është rritur me 336 punonjës, por përmirësimi i lehtë i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i shtimit të numrit të lidhjeve UK. Shtimi i numrit të punonjësve ka ardhur si rezultat i riorganizimit të shoqërive nga shtimi i sistemeve të furnizimit me ujë të zonave rurale që duhen administruar dhe siguruar si objekte të rëndësishme të veçantë.

Investimet në Nivelin Strategjik

Gjatë vitit 2019 investimet në sektorin e ujësjellës kanalizimeve janë realizuar pothuajse në mënyrë të barabartë në vlerë nga buxheti i shtetit dhe nga donatorët e huaj në formën e granteve ose huave në norma të ulta interesi. Totali i këtyre investimeve shkon në rreth 72 milion euro, por akoma mbetet larg nevojave reale për investime në sektor. Tabela 3 jep investimet e realizuara gjatë vitit 2019 në Sektorin UK të cilat kanë patur një tendencë në rritje krahasuar me vitin 2018.

Tabela 3. Investimet në Sektorin UK Viti 2018-2019

Nr.	Burimi i Financimit	Viti 2018 (në 000 lekë)	Viti 2019 (në 000 lekë)	Difrenca (në 000lekë)
1	Financim nga Buxheti	3,106,825	4,432,000	+1,325,175
2	Financim i Huaj	5,592,681	4,497,755	-1,094,926
3	Totali në 000 lekë	8,699,506	8,929,755	+230,249
4	Totali në euro	69,596,048	71,438,040	1,841,992

Investimet e kryera me fonde të buxhetit jepen të detajuara në Tabelën 46 Aneks 8. Projektet me financime të huaja jepen në Tabelën 9, ku veçohen ato të financuara nga BB dhe BE për Durrësin, projekti në mbështetje të rrjetit hidrik të Tiranës financuar nga

Qeveria Italiane, si dhe programi i infrastrukturës bashkiake III dhe IV financuar nga KfW dhe SECO.

Gjithsesi referuar Master Planit të Furnizimit me Ujë dhe KUN nevojat për investime në sektor të projektuara deri në vitin 2040 vlerësohen rreth 5 miliard euro, këto investime janë akoma larg nevojave reale që ka sektori UK.

Ndihet nevoja e miratimit të draftit mbi dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit Ujësjellës Kanalizimeve. Modeli i hartuar për mbulimin e skemës së financimit në 2016 identifikoi rrugët e financimit për mbulimin e nevojave të investimeve fizike dhe institucionale për përmirësimin e performancës së sektorit sipas objektivave strategjike me kontributet e parashikuara sipas sistemit 3T-të, përkatësisht nga Taksat (buxheti), Transfertat (donatorë), si dhe nga Tarifatat e konsumatorëve. Për këto të fundit duke patur parasysh dhe respektuar kriterin e përballueshmërisë së faturës së shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve nga konsumatorët.

KONKLUZIONE, REKOMANDIME

- Kërkohej një angazhim më serioz nga Bashkitë dhe shoqëritë përkatëse UK për të përfunduar procesin e licencimit pasi akoma janë 20 shoqëri të pa licencuara nga ERRU në përputhje me reformën e riorganizimit të shoqërive.
- Shoqëritë duhet të kenë në vëmendje të tyre mirë menaxhimin e aseteve duke hartuar dhe zbatuar Planin e Menaxhimit të Aseteve që mundësojnë një planifikim më efikas të investimeve në sektor dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve për konsumatorët.
- Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura mbetet problem serioz për mjaft shoqëri UK. Shoqëritë e dobëta financiarisht duhet të mbështeten nga qeveria qendrore për instalimin e matësave të ujit në burim dhe konsumatorët familjarë në mënyrë që të hartohen bilanci i ujit të sakta si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Duhet të rritet përgjegjshmëria nga stafet drejtuese të shoqërive në drejtim të saktësisë të raportimit të të dhënave në ERRU në mënyrë që të disponohet një bazë e saktë dhe e besueshme e të dhënave për vlerësimin dhe monitorimin e sektorit
- Duke pasur parasysh rëndësinë e Planeve të Biznesit 5 Vjeçare për shoqëritë UK, të nxitet nga ERRU hartimi i tyre si një kërkesë e detyrueshme e metodologjisë së tarifave që do të aprovohet së shpejti. AKUM të vlerësojë nevojat dhe të nxisë financimin e hartimit të tyre nga qeveria qendrore dhe donatorët, në veçanti për shoqëritë që kanë mundësi financiare të kufizuara.
- Të analizohen thellësisht elementët bazë të qasjes së re si strategji për agregimin e sektorit në aspektet praktikë-ligjore të ngritjes dhe veprimtarisë së Operatorit të Alternativës së Fundit dhe Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta, si dhe të rekomandimit për agregimin e sektorit me disa shembuj agregimi të suksesshëm. ERRU rekomandohet të përfshihet në procesin e përcaktimit të prioritetëve të investimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve.
- Të përditësohet Master Plani Kombëtar i Sektorit të UK për të përfshirë në të nevojat për investime edhe të zonave të reja rurale që më parë kanë qenë jashtë zonës së shërbimit të shoqërive UK dhe ndryshimet të cilat duhet të reflektohen edhe në draftin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve.

Hyrje

Enti Rregullator i Ujit është një institucion publik i pavarur, përgjegjës për rregullimin dhe monitorimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar. Hartimi i Raportit Vjetor të Performancës së Sektorit të UK dhe të secilës shoqëri UK të licencuar përbën një detyrim ligjor të ERRU-së. ERRU si institucion i pavarur ka për detyrë që të jetë sa më objektiv në vlerësimet e tij për sektorin e UK, pjesë e rëndësishme e të cilit është hartimi i Raportit Vjetor 2019 të Performancës të Sektorit UK.

Raporti i Performancës së shoqërive UK 2019 hartuar nga ERRU është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Në të jepet një pasqyrë e sektorit krahasuar me vitet paraardhëse (benchmarking) dhe tendenca e performancës të të gjithë sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri.

Raporti i Performancës së shoqërive UK për vitin 2019 për herë të parë është hartuar duke u bazuar në të dhënat teknike ekonomike vjetore të operimit të shoqërive UK për vitin 2019 të raportuara pranë sektorit të monitorimit dhe performancës të ERRU-së.

ERRU mori iniciativën për të patur bazën e saj të pavarur të të dhënave për monitorimin e shoqërive dhe hartimin e Raporteve Vjetore të Performancës së shoqërive për të minimizuar problemin kronik të vërtetësisë dhe pasaktësisë së të dhënave që influencën në arritjen e konkluzioneve sa me objektive për përmirësimin e performancës së sektorit.

ERRU dy vitet e fundit ka bërë të mundur të realizojë hartimin dhe publikimin e Raportit jo me vonë se fundi i Qershorit në mënyrë që t'i lihet shoqërive një kohë minimale gjatë vitit pasardhës për zbatimin e rekomandimeve që jepen në Raport për përmirësimin e performancës së sektorit. Këtë vit për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, raporti vjetor i performancës të shoqërive UK për vitin 2019 nuk mundi të publikohej në fund të Qershorit, sepse referuar Aktit Normativ të Kryeministrit Nr. 10, datë 26.3.2020 për shkak të pandemisë COVID 19 afati i dorëzimit të Bilanceve Financiare të hartuara nga një auditues i certifikuar për shoqëritë UK, u shty deri në fund të Korrikut 2020. Theksojmë faktin se bilancet financiare janë baza kryesore e të dhënave ekonomike-financiare për hartimin e raportit të performancës së sektorit UK të cilës ERRU i kushton një rëndësi të veçantë.

Raporti analizon shkaqet e performancës jo të kënaqshme të sektorit UK dhe jep rekomandime për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomike të performancës së shoqërive. Gjithashtu shoqëritë UK e shohin raportin si një mjet për të krahasuar performancën e shoqërisë së tyre me ato të shoqërive të tjera të ngjashme në sektorin UK.

Sektori UK gjatë vitit 2019 krahasuar me vitin paraardhës ka patur tendencë pozitive në katër treguesit, përkatësisht "Norma e Arkëtimit Korente", "Niveli i Matjes", "Eficienca e Stafit " si dhe " Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë", por ka patur tendencë negative në treguesit e tjerë. Shqetësues është fakti i rënies së treguesit të Mbulimit të Kostove OM dhe ato Totale. Treguesit e Mbulimi me Ujë dhe Kanalizime, Uji Pa të Ardhura si dhe Norma e Arkëtimit e Përgjithshme janë pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës me diferenca të vogla që si shkak kryesor kanë zgjerimin e zonës së shërbimit, por janë konstatuar edhe pasaktësi krahasuar me raportimet e mëparshme nga ana e shoqërive UK.

Mungesa e përmirësimit në të gjithë treguesit e performancës së sektorit UK lidhet gjithashtu me realitetin e përballimit të problematikave nga riorganizimi i shoqërive UK nga shtimi në zonën e tyre të shërbimit të mjaft zonave rurale që më parë administroheshin nga vetë ish Komunat.

Përfshirja e zonave të reja rurale në zonën e shërbimit të shoqërive UK ka përkeqësuar treguesit e performancës financiare të tyre pasi zonat rurale në përgjithësi kanë patur tarifa të ulëta dhe janë karakterizuar nga një shkallë e ulët arkëtimi, gjë që për mjaft shoqëri ka thelluar vështirësitë për mbulimin e kostove të operimit të tyre.

Problematikat e akumuluar në të shkuarën në sektor diktuan nevojën urgjente që reforma në sektor të rikonsiderohej në baza të tjera më realiste dhe efektive, kryesisht në eliminimin e lidhjeve të paligjshme, arkëtimet e debive të prapambetura si dhe objektiva që duhet të realizohen deri në fund të vitit.

Qeveria qendrore edhe gjatë vitit 2019, procedoi me nënshkrimin e kontratave të performancës ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përfaqësuar nga AKUM dhe Bashkive në vend bazuar në tregues performance apriori dhe në vlera të njëjta për të gjitha shoqëritë.

Si rezultat i reformës, sektori pati një ecuri pozitive në drejtim të eliminimit të lidhjeve të paligjshme, si rrjedhojë e aksionit të ndërmarrë në nivel kombëtar i cili ndikoi në rritjen e numrit të klientëve, rritjen e numrit të ujëmatësve të vendosur, gjithashtu edhe rritjen e arkëtimeve të debive të prapambetura si rezultat i angazhimit serioz të shoqërive UK për arkëtimin e tyre dhe ndërgjegjësimin të konsumatorëve.

Problem për Sektorin UK vazhdojnë të mbeten detyrimet e prapambetura që një pjesë e konsiderueshme e shoqërive kanë ndaj OSHEE-së, të cilat në mbyllje të vitit 2019 raportohen rreth 7.5 miliard lekë ose rreth 61% të detyrimeve që sektori UK ka ndaj të tretëve. Mjaft problematike me debi të konsiderueshme nga 0,2 deri 2, 3 miliard lekë paraqiten shoqëritë Durrës, Vlorë, Patos, Tiranë, Kavajë, Fier, Kurbin, Peqin, Lushnje etj., që i kanë ujësjellësat me ngritje mekanike. *Përgjithësisht shlyerja e këtyre detyrimeve ndaj OSHEE kërkon zgjidhje në nivel të qeverisë qendrore sepse është e pamundur që ajo të realizohet me anë të rritjes së tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.*

Viti 2019 është karakterizuar nga një rritje e vëmendjes së qeverisë qendrore për investimet fizike në sektor të realizuara nëpërmjet AKUM-it, ku shuma totale e këtij investimi arriti vlerën e 4 432 milion Lekë ose rreth (35 milion euro), gjë e cila ka sjellë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në furnizim me ujë të pandërprerë (24 orë, ditë) për 4 qytete, përkatësisht Tepelenë, Memaliaj, Përmet dhe Cërrik. Duke shtuar edhe 9 qytetet, Fushë Arrëz, Lezhë, Tropojë, Korçë, Pogradec, Maliq, Bilisht, Fier, dhe Konispol, në të cilat është realizuar më parë furnizimi me ujë pa ndërprerje, shkon në 13 numri i qyteteve që në fund të vitit 2019 kanë cilësi mjaft të lartë të shërbimit të furnizimit me ujë.

Në drejtim të nevojës së përmirësimit të menaxhimit shoqëritë UK të riorganizuara kanë nevojë urgjente që të hartojnë Planet e Biznesit 5 Vjeçar për një skanim të situatës, problematikave, hartimit të plan veprimeve, si dhe të përcaktimit të saktë të nevojave për investime në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Planet e Biznesit 5 Vjeçare të shoqërive UK duhet të konsiderohen si domosdoshmëri dhe baza justifikuese për propozimet për tarifa të reja kur ato aplikojnë pranë ERRU-së.

Si konkluzion, përmirësimi i performancës për të gjithë sektorin në tërësi duhet të lidhet ngushtësisht me një angazhim gjithëpërfshirës të të gjithë aktorëve të këtij sektori, përkatësisht shoqërisë UK, bashkisë dhe qeverisë qendrore me të gjithë instrumentet e tjerë në mbështetje të tyre.

1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca

1.1 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin

Performanca e përgjithshme e sektorit Ujësjetës Kanalizime për vitin 2019 paraqitet në Tabelën 4. Treguesit e Performancës së sektorit UK. Në të jepet gjithashtu tendenca e performancës krahasuar me arritjet e vitit 2018, si dhe me objektivat e "Performancës së Mirë" të përcaktuara nga ERRU.

Tabela 4. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK

Nr.	Treguesit e Performancës	2018	2019	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	63	63.7	↘	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	119	107.1	↘	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	92	77.5	↘	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	98	95.8	↘	82
5	Norma e Arkëtimit Korente(%)	79	79.8	↗	82
6	Niveli i Matjes (%)	74	77.3	↗	85
7	Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	5.35	5.33	↗	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	12.7	13.3	↗	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	52	51	↘	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	77	76.8	↘	n/a

Shënim: Burimi për vitin 2018 është AKUM, për vitin 2019 është ERRU

Nga tabela e mësipërme vërehet që nivelet e treguesve kryesorë të performancës për sektorin për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 kanë tendencë negative për 6 tregues dhe pozitive për 4 tregues.

Cilësia e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve në drejtim të Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë (mesatarisht 13.3 orë/ditë), Nivelit të Matjes (77.3%), Normës së Arkëtimit Korente (79.8%) krahasuar me vitin 2018, edhe pse janë përmirësuar mbeten përsëri në nivele jo të kënaqshme kundrejt referencës që ERRU konsideron për performancë të mirë. Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit (mesatarisht 5,33 staf/1000 lidhje) ka një përmirësim të lehtë edhe pse sektori vazhdon të paraqitet i mbingarkuar me staf dhe shtimi i tij vijon të konstatohet edhe për vitin 2019.

Treguesi Mbulimi i Kostove O&M paraqitet në nivel të mirë, por me një rënie të ndjeshme kundrejt vitit 2018. Përkeqësim të madh ka pësuar dhe treguesi Mbulimi i kostove Totale nga 92% në vitin 2018 në 77.5% për vitin 2019.

Me rënie, por në nivele të ulëta janë dhe Treguesit Uji Pa të Ardhura, Mbulimi me Furnizimin me Ujë dhe me KUN.

Gjithsesi baza e vlerësimit për tu konsideruar nga ERRU si performancë e mirë për disa prej shoqërive duket jo në përputhje me situatën aktuale sepse krahasimi bëhet për zonën e vjetër të shërbimit para riorganizimit të sektorit. Shumë shoqëri janë akoma në fazën e aplikimit për tu licencuar në kuadër të riorganizimit sipas ndarjes së re Administrative dhe më tej për të aplikuar për tarifa të reja që përcaktojnë treguesit e performancës të përmendura më sipër.

ERRU në vijim do të rishikojë nivelet se kush do të konsiderohet performancë e mirë për sektorin UK në përputhje me situatën e re që ka diktuar Reforma Administrative.

1.1.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)

Treguesi "Uji Pa të Ardhura", në rang sektori, për vitin 2019, rezultoi në nivelin 63,7 %, pra është përkeqësuar me 0.7% krahasuar me vitin 2018.

Ky tregues vazhdon të mbetet i lartë dhe në nivele të papranueshme. Në vlerë absolute sasia e ujit të prodhuar në vitin 2019 në sektor është rreth 295,6 milion m³ ku rreth 60% i takon prodhimit me ngritje mekanike dhe rreth 40% me vetërrjedhje. Konstatohet një rritje e volumit të ujit të prodhuar me rreth 3.7% ose 10.7 milion m³ ujë më shumë se viti 2018.

Sasia e ujit të faturuar për vitin 2019 raportohet me rritje 1.5% ose rreth 1,6 milion m³ ujë më shumë se viti 2018.

Rritja jo proporcionale e këtyre dy variablave ka ardhur pasi shumë nga sistemet e furnizimit me ujë të zonave të reja administrative, të cilat ju bashkuan shoqërive UK në zbatim të reformës së re territoriale, ishin mjaft të amortizuara dhe me lidhje të shumta të paligjshme. Rritja e prodhimit të ujit kryesisht për shkak të shtimit të sistemeve të furnizimit me ujë të zonës rurale ishte mjaft më e vogël se sasia e faturuar konsumatorëve të kësaj shtese. Analiza e Bilancit të Ujit tregoi se gjatë vitit 2019, në sektorin UK janë rritur humbjet nga lidhjet e paligjshme në linjat e transmetimit (+0.18%) dhe në rrjetet shpërndarëse(+2%) krahasuar me vitin paraardhës.

Në shumë raste konsumatorët e rinj (zonat rurale të shtuara) janë faturuar me tarifë fikse pavarësisht konsumit real i cili përgjithësisht është shumë më i lartë se vlerësimi/faturimi i bërë nga shoqëria. Gjithashtu, instalimi i matësve të rinj për konsumatorët në disa shoqëri është shoqëruar me fenomenin e rënies së konsumit dhe të faturimit.

Prej disa vitesh shoqëritë depozitojnë pranë ERRU-së Bilancin e Ujit, i cili është një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin e humbjeve teknike dhe administrative si dhe orientimin e shoqërive drejt përmirësimit të treguesit "Uji Pa të Ardhura". Vlerësimi dhe jo matja e ujit të prodhuar në burim si pasojë e mungesës në një pjesë të madhe të matësve në to, si dhe mos pajisja 100% e të gjithë konsumatorëve individualë të shoqërive UK me matësa, e bën vlerësimin e këtij treguesi të ketë një pasaktësi jo të vogël. Gjithashtu edhe mungesa e përgjegjshmërisë nga ana e stafeve drejtuese në drejtim të raportimit të të dhënave është një element tjetër i cili e vështirëson besueshmërinë e këtij treguesi. Edhe gjatë vitit 2019 ku të dhënat janë grumbulluar dhe analizuar nga ERRU, vërehen raportime të ndryshme në data basen e grumbullimit të të dhënave me ato që jepen në bilancet e ujit që shoqëritë dorëzojnë çdo vit pranë ERRU-së.

Në analizat që ERRU bën në aplikimet për nivel të ri tarifor i kushton një vëmendje të madhe analizës së Bilancit të Ujit në mënyrë që ai të paraqesë sa më realisht gjendjen e prodhimit të ujit në sisteme, si dhe të elementëve të tjerë të tij.

Për sa më sipër, edhe përfundimet në lidhje me vlerësimin e UPA si sektor dhe përkeqësimi i këtij treguesi në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 duhen marrë akoma me rezervë.

Sfidë e sektorit për përmirësimin e treguesit të Ujit Pa të Ardhura mbetet ulja e humbjeve administrative dhe humbjeve fizike që lidhen me rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë, si dhe rritja e treguesit të Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë drejt objektivit të furnizimit me ujë 24 orë në ditë. Për arritjen e këtij objekti kërkohet një vlerësim dhe menaxhim i kërkesës për ujë që nga burimi deri tek konsumatori i fundit i rrjetit shpërndarës dhe duhen krahasuar ato me kapacitetet e burimeve aktualisht në shfrytëzim.

Nga ana tjetër ulja e humbjeve lidhet direkt me menaxhimin e kontrollit dhe humbjeve sidomos në rrjetet shpërndarëse. Rrjetet shpërndarëse në sektor kërkohet që të jenë të seksionuara me zona të mbyllura të

matura (DMA) në përputhje me modele hidraulike të tyre që lejojnë vlerësimin dhe kontrollin e humbjeve dhe përcaktojnë masat për zvogëlimin e tyre. Ky duhet të jetë prioritet kryesor i sektorit në vendin tonë.

1.1.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale

Viti 2019 krahasuar me vitin 2018 ka shënuar një përkeqësim të treguesve të Mbulimit të Kostove të O&M dhe ato Totale respektivisht me 11.9% dhe 14.5%. Ky përkeqësim është rrjedhojë e rritjes së Kostove të Operim & Mirëmbajtjes me 887 milion lekë si dhe të Kostove kapitale Totale me 1 027 milion lekë. Të ardhurat e aktivitetit janë pothuajse në nivelin e vitit 2018, me një rënie prej 35.7 milion lekë, e cila ka sjellë përkeqësim të nivelit të mbulimit të kostove me të ardhura.

Tabela 5 jep të detajuara kostot e O&M dhe Kostot Totale për vitet 2018 dhe 2019 dhe diferencat për secilën prej tyre në vlerë absolute në lekë dhe në përqindje.

Tabela 5. Zërat e Kostove të O&M dhe Kostove Totale për vitet 2018 e 2019 (në 000 lekë)

Nr.	Zërat e Shpenzimeve	Viti 2018 (në 000 lekë)	Viti 2019			Diferenca (2019- 2018) (në 000 lekë)	Rritja/Rënia 2019/2018 (në %)
			(në 000 lekë)	Ndaj Kostove të O&M (në %)	Ndaj Kostove Totale (në %)		
1	Kostot e Punës	3,760,301	3,824,243	42	30	63,942	2%
2	Kostot e Energjisë Elektrike	2,365,574	2,678,804	29	21	313,230	13%
3	Kostot e Riparimeve	545,576	374,373	4	3	-171,203	-31%
4	Shërbimet nga Nënkontraktorët	779,886	930,163	10	7	150,277	19%
5	Kosto e Materialeve e Kimikateve	216,069	489,380	5	4	273,311	126%
6	Kosto të Tjera	559,484	816,912	9	6	257,428	46%
	Kostot e O&M	8,226,890	9,113,875	100	72	886,985	11%
7	Kostot e Amortizimit	1,897,345	2,592,402		21	695,057	37%
8	Të tjera Financiare Tatime Taksa, Kredi	555,886	888,167		7	332,281	60%
	Kostot Kapitale	2,453,231	3,480,569		28	1,027,338	42%
	Kostot Totale	10,680,121	12,594,444		100	1,914,323	18%

Për vitin 2019 Kostot e Operimit dhe të Mirëmbajtjes janë rritur me rreth 11%, e shprehur në vlerën 887 milion lekë. Me rritje konstatohen të gjithë zërat sintetik të kostove me përjashtim të zërit kosto e Riparimeve. Rritje të konsiderueshme ka shënuar zëri “Kostot e Energjisë Elektrike” (+313.2 milion lekë), “Shërbimet nga nënkontraktorët” me (+150.3 milion lekë) si dhe “Kostot e Punës (+63.9 milion lekë). Rritje të ndjeshme kundrejt vitit 2018 ka shënuar zëri “Kosto të Tjera”(257.4 milion lekë) në të cilin shoqëritë përfshijnë kostot të cilat nuk janë të pasqyruar në zërat e tjerë të cituar më lart, si kostot për pagesat rregullatore dhe detyrime të prapambetura ndaj ERRU, SHUKALB-it, Këshillave të Administrimit, tarifave ndaj Ministrisë së Mjedisit për përdorimin e ujit nga Basenet, ekspertë kontabël, kostot për nxjerrjet jashtë përdorimit, vendimet gjyqësore etj.

Në detaje analiza për secilin zë të kostos të paraqitur në Tabelën 5 paraqitet si më poshtë:

Kosto e Punës Sektori për vitin 2019 e ka zhvilluar aktivitetin me një staf prej 8245 punonjësish (punonjësit e vet dhe nënkontraktorët) nga 7909 që janë raportuar në vitin 2018, pra me një rritje prej 336 punonjës. Shoqëritë që kanë rritur ndjeshëm numrin e punonjësve janë UK Tiranë me 55 punonjës, UK Durrës me 59 punonjës, UK Kavajë me 56 punonjës, UK Krujë 28 punonjës etj.

Shoqëritë argumentojnë se shtimi i numrit të punonjësve ka ardhur si rezultat i riorganizimit të tyre në përputhje me reformën ku përfshihen mjaft punonjës shtesë të sistemeve të zonave rurale që më parë administroheshin nga vetë ish komuna, si të atyre që kërkohen për të menaxhuar komponentët e sistemeve të furnizimit me ujë nga projekte të ndryshme.

Nga ana tjetër janë shumë shoqëri që kanë reduktuar stafin operues si UK Kurbin me 47 punonjës, UK Lushnjë me 15 punonjës, UK Sarandë me 13 punonjës.

Në përgjithësi, sektori vazhdon të jetë i mbingarkuar me staf të pajustifikuar. Lidhur me këtë tregues, kërkohet një analizë e thelluar për secilën shoqëri në lidhje me numrin e punonjësve dhe pozicionet në organigramë, përshkrimet e punës dhe ngarkesën reale për çdo pozicion pune. Një analizë të hollësishme në këtë drejtim ERRU e kryen veçanërisht në rastet kur shoqëritë aplikojnë për nivel të ri tarifor.

Në total, rritja e raportuar e numrit të stafit ka sjellë rritjen e Kostove të Punës me rreth 63.9 milion lekë në vit.

Një menaxhim i mirë i shoqërive duhet shoqëruar me menaxhim të mirë të burimeve njerëzore, duke punësuar staf të kualifikuar e në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të shoqërisë.

Kosto e Shërbimeve të Nënkontraktuara Në këtë zë shpenzimesh përfshihen kostot për shërbimin e rojeve nga nënkontraktorët, të cilët zënë pjesën më të madhe të tyre, si dhe shpenzime të tjera që kanë të bëjnë me shërbimet e kontraktuara që kryhen nga të tretët. Shoqëritë janë të detyruara të angazhojnë një numër të madh rojesh për komponentët e furnizimit me ujë, si depo, stacione pompimi, puse etj., të cilët konsiderohen si objekte me rëndësi strategjike për ruajtjen e sigurisë së shëndetit të popullsisë.

Në të gjithë sektorin UK janë 10 shoqëri që shërbimin e rojeve e kryejnë nga njësi private të licencuara për këtë shërbim, ku kryesisht përfshihen shoqëritë e mëdha të Grupit të I-rë. Vetëm UK Tiranë si shoqëria më e madhe në sektor zë rreth 69% të këtyre kostove, si edhe vlerën më të madhe të rritjes së këtyre kostove (119 milion lekë).

Rritja e këtij zëri me rreth 150 milion lekë krahasuar me vitin 2018, ka ardhur kryesisht nga rritja e numrit të punonjësve që e kryejnë shërbimin me roje të kontraktuar, si edhe nga rritja e pagës së punonjësve të tyre.

Siç është theksuar edhe në raportet e mëparshme legjislativi për garantimin e sigurisë së objekteve të rëndësishme të veçantë duhet rishikuar për të parashikuar edhe zgjidhje alternative teknike apo logjistike.

Kosto të Tjera. Ky zë ka pësuar një rritje me rreth 257.4 milion lekë krahasuar me kostot e vitit 2018.

Në kostot e tjera shoqëritë raportojnë detyrimet ndaj ERRU, SHUKALB-it, pagesat e këshillave të Administrimit, tarifatat ndaj Ministrisë së Mjedisit për përdorimin e ujit nga Basenet, ekspertë kontabël, shpenzime për penalitete dhe gjoba, shpenzime për konsulencë si dhe të tjera kosto që nuk kategorizohen në zërat e tjerë sintetik të kostove.

Rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2018 ka shënuar UK Tiranë me 64 milion lekë, UK Durrës me 38 milion lekë, UK Vlorë me rreth 21.5 milion, UK Kamëz me 11.4 milion, UK Kavajë 11.3 milion, UK Fier me 9.1 milion dhe UK Korçë me 5.7 milion lekë.

ERRU do të mund të bëjë një analizë të thelluar nëse janë të justifikuar këto rritje veçanërisht në rastet kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja pranë saj.

Kosto e Energjisë Elektrike Kostot e energjisë për vitin 2019 për shoqëritë raportohen rreth 313.2 milion lekë më të larta se viti 2018. Rreth 78% të kostove të energjisë e zënë 14 shoqëritë e Grupit të I-rë, ku UK Durrës zë rreth 33% të kostove të këtij grupi.

Në vlerë absolute, me rritje të konsiderueshme të kostove të energjisë janë UK Durrës 161 milion lekë, UK Tiranë 115.6 milion lekë, UK Kavajë 24 milion lekë milion lekë, UK Tepelenë 24.6 milion lekë. Ka dhe shumë shoqëri që kanë arritur të ulin kostot e energjisë elektrike si UK Korçë, UK Lushnje, UK Sarandë, UK Himarë, UK Patos, UK Peqin etj.

Rritja e kostove të energjisë për vitin 2019 përgjithësisht është e justifikuar sepse vëllimi i ujit të prodhuar me ngritje mekanike për vitin 2019 për të gjithë sektorin raportohet 166.8 milion m³ ujë kundrejt 163.6 milion m³ që ishte në vitin 2018. Rritja prej 3.2 milion m³ ujë justifikon edhe rritjen me 18.8 milion kwh të energjisë elektrike krahasuar me vitin 2018.

Edhe shërbimi i KUN ka shënuar rritje të sasisë së energjisë elektrike të konsumuar me rreth 6.3 milion kwh si dhe ITUN me 2.76 milion kwh. Nga shtatë shoqëri që kanë ITUN, 4.7 milion kwh ose rreth 61% të kostove të energjisë për ujin e trajtuar e ka Sha UK Durrës që ka ITUN më të madh që ofron këtë shërbim për rreth 200 mijë banorë. Ky konsum në këto vlera është real, por duke e krahasuar me vitin 2018 ka një diferencë shumë të madhe. Kjo diferencë ka ardhur për shkak të mbifaturimit të energjisë në vitin 2017, i cili është kompensuar më tej në faturimin e vitit 2018, gjë që sjell një krahasim jo real të performancës për këtë zë ndërmjet viteve 2018 dhe 2019.

Për shoqërinë UK Lezhë rritja e kostos së energjisë elektrike të konsumuar për vitin 2019 ka ardhur sepse OSHEE ka bërë një korrigjim të sasisë së harxhuar që ka ardhur nga konvertimi i energjisë në total duke marrë parasysh faktorin e energjisë reaktive. Shoqëritë e tjera raportojnë pothuajse nivele të njëjta konsumi.

Problem për Sektorin UK vazhdojnë të mbeten detyrimet e prapambetura që shoqëritë kanë ndaj OSHEE-së, të cilat në mbyllje të vitit 2019 raportohen rreth 7.5 miliard lekë ose rreth 61% të detyrimeve që sektori UK ka ndaj të tretëve sipas tabelës 44, Aneks 6, e cila jep listën dhe me vlerat përkatëse të 50 nga 57 shoqëritë UK që kanë debi të trashëguara ndaj OSHEE.

Konstatohet që UK Durrës ka detyrimin më të madh në vlerën 2 178 milion lekë ose 29% të detyrimit total të sektorit. Me nivele të larta të detyrimit paraqiten edhe shoqëritë UK Vlorë, Patos, Fier, Kavajë, Tiranë, Elbasan, Kurbin, Shkodër, Lushnje, Kamëz, Krujë, Peqin dhe Delvinë, totali i të cilave llogaritet 4 476 milion lekë. Këto detyrime janë mbartur ndër vite pasi pothuajse të gjitha shoqëritë kanë pamundësi financiare për shlyerjen e tyre. Përgjithësisht shlyerja e këtyre detyrimeve ndaj OSHEE kërkon zgjidhje në nivel të qeverisë qendrore sepse është e pamundur që ajo të realizohet me anë të rritjes së tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Në disa shoqëri komponenti i kostos së energjisë elektrike është mjaft i lartë për tu përballuar me rritje tarife. Këto shoqëri duhet të vazhdojnë të subvencionohen në të ardhmen nga buxheti i shtetit.

Theksohet fakti se për UK Durrës për vetë specifikën që ka sistemi i tij i furnizimit me ujë me ngritje mekanike që duhet pompuar nga një largësi rreth 50 km nga qyteti i Durrësit, si dhe futja në punë e

sistemit të ri sëbashku me atë ekzistues, ka sjellë si pasojë që kjo shoqëri do të duhet të përballojë një faturë mjaft të madhe vjetore ndaj OSHEE-së. Prandaj kjo shoqëri, ose duhet të vazhdojë të subvencionohet nga qeveria qendrore, ose duhet gjetur mundësia për një furnizim me energji elektrike plotësisht ose pjesërisht të pavarur financiarisht nga OSHEE.

Kostot e Riparimeve Kostot e riparimeve gjatë vitit 2019 krahasuar me ato të vitit 2018 janë ulur me 31 përqind ose 171.2 milion lekë.

Investimet fizike të bëra në rrjetin e ujësjellësit kanë dhënë ndikimin e vet në reduktimin e kostove të riparimeve. Shumica e shoqërive gjatë vitit 2019 kanë raportuar kosto të ulura të këtij shërbimi si UK Tiranë me 201.8 milion lekë, UK Elbasan me 14.3 milion lekë, UK Lushnje me 7.6 milion lekë dhe shoqëri të tjera me vlera deri në 4 milion lekë. Nga ana tjetër janë dhe shoqëri që kanë rritje të kostove të riparimeve si UK Durrës me 33.4 milion lekë, UK Kamëz me 14.7 milion lekë, UK Kavajë me 4.4 milion lekë etj.

Rritje të kostove të defekteve kanë patur edhe shoqëritë ku janë bërë investime, por këto investime kanë qenë të orientuara në zonën urbane, ndaj rritja e defekteve ka ardhur kryesisht nga gjendja e rënduar e sistemeve që janë marrë nga zonat rurale mbas riorganizimit të shoqërive ku riparimet kanë qenë relativisht të shpeshta.

Kostot Kapitale. Kostot Kapitale përfshijnë kostot e Amortizimit dhe të Interesave të Kredive. Referuar Tabelës 5 vërehet se këto kosto zënë një peshë të konsiderueshme me rreth 28% të totalit të kostove të sektorit.

Kostot e amortizimit për vitin 2019 rezultojnë 695 milion lekë më të larta se viti 2018, e cila kryesisht ka ardhur nga saktësimi i vlerës së aktiveve të shoqërive nëpërmjet rivlerësimeve apo kalimeve në asetet e shoqërive të rikrijuara si edhe nga investimet e kryera dhe të pasqyruara në aktivet në bilancet e shoqërive për të cilat është llogaritur amortizimi i vitit.

Me rritje të konsiderueshme (332.3 milion lekë) rezultojnë dhe kostot e kredive, por akoma ato janë shumë larg detyrimit real që shoqëritë përfituese të kredive afat gjata kanë ndaj Institucioneve të Kredive. Mjaft shoqëri nuk kanë mundësi financiare për të përballuar këto kosto.

Kostot Totale të aktivitetit të shoqërisë përbëhen nga Kostot Direkte të O&M plus vlerën e Kostove Kapitale. Theksohet fakti se sektori UK vazhdon të jetë larg mbulimit 100% të Kostove Totale. Aktualisht janë 4 shoqëri, UK Tiranë, UK Ersekë, UK Librazhd dhe UK Dibër që arrijnë që ti mbulojnë ato në nivelin mbi 100%. Konstatohet se shumë shoqëri si UK Korçë, UK Lezhë, UK Pogradec, UK Malësi e Madhe, UK Sarandë të cilat megjithëse kanë nivele të larta të mbulimit të kostove O&M nga 112% deri në 179 %, por ngaqë kanë vlera mjaft të larta të kostove kapitale e kanë treguesin e Mbulimit të Kostove Totale ndërmjet vlerave 52% dhe 79%.

1.1.3 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është një nga treguesit më të rëndësishëm të performancës së shoqërive, që lidhet me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj. Raporti ka konsideruar dy tregues në lidhje me Normën e Arkëtimeve, përkatësisht Normën e Arkëtimit të Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korente (NAK). NAP në përlllogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet e kryera nga shoqëria, d.m.th. edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK përjashton këto të fundit.

Tabela 40, Aneks 2 jep për secilën shoqëri NAP dhe NAK të vitit 2019 dhe krahasuar ato me vitin 2018.

Norma e Arkëtimit Korente raportohet për të gjithë sektorin për vitin 2019 në nivelin 79.8 %, pra me një përmirësim prej 0.8 % krahasuar me vitin 2018. Ky tregues mund të mos jetë real pasi shumë shoqëri në kontabilizimet e arkëtimit korrent përjashtojnë arkëtimet e vonuara në kohë, por që kryhen brenda vitit dhe i raportojnë si arkëtim i debive. NAP është më reale pasi e amortizon “gabimin” që konstatohet në NAK.

Nga shembujt pozitivë që performojnë me normë të lartë arkëtimi korente përmenden shoqëritë UK Berat-Kuçovë, UK Lezhë, UK Belsh, UK Malësi e Madhe, UK Poliçan, UK Tepelenë si dhe UK Pogradec, ndërsa disa nga shoqëritë që operojnë me normë arkëtimi korente të ulët janë përkatësisht, UK Fier, UK Cërrik, UK Pustec, UK Kukës, UK Divjakë, U Klos, U Has, UK Lushnje si dhe UK Mat.

Norma e Arkëtimit e Përgjithshme për vitin 2019 ka rezultuar të jetë në nivelin 95,8% kundrejt 98% që ishte në vitin 2018. Ka një rënie të vlerës së arkëtuar nga debitë e prapambetura, e cila për vitin 2019 rezulton në vlerën e 1.6 miliard lekë nga 1.7 miliard lekë që ishte në vitin 2018. Kjo rënie konsiderohet normale sepse mbledhja e debive të prapambetura bëhet gjithnjë e më e vështirë sepse një pjesë e mirë e tyre janë debi të këqija me mundësi zero praktikisht për mbledhjen e tyre. Gjithsesi niveli i i Normës së Përgjithshme të Arkëtimit realizuar në vitin 2019 tregon për punën e mirë që shoqëritë po kryejnë në këtë drejtim. Shoqëritë shpesh për arkëtimin e debive të vjetra të krijuara ndër vite përdorin alternativën e lidhjes së akt marrëveshjes me debitorët me qëllim shtrirjen në kohë në funksion të mundësisë së likuidimit të tyre nga këto të fundit.

Vlera absolute e debisë së akumuluar në mbyllje të vitit 2019 rezulton rreth 14.3 miliard lekë nga të cilat rreth 80% i takon kategorisë së klientëve familjarë.

1.1.4 Niveli i Matjes

Treguesi i Nivelit të Matjes për vitin 2019 është 77.3%, tregues i cili krahasuar me atë të vitit 2018 ka përmirësim me rreth 3%, konsiderohet akoma larg objektivit të përcaktuar nga ERRU. Duke patur parasysh riorganizimin e shoqërive me ndarjen e re administrative, aktualisht asnjë shoqëri UK nuk i ka të pajisur me matës 100% të konsumatorëve, madje në disa shoqëri ky tregues është në nivelin nën 40%, si UK Dropull, UK Kurbin, UK Libohovë, UK Selenicë, UK Kukës dhe UK Patos. Konsumatorët duhet të paguajnë për sasinë reale të ujit të konsumuar prej tyre. Pjesa e konsumatorëve që faturohen pa matje, pra aforfe me 150 litra/ditë/banor, nuk është korrekte pasi përgjithësisht i mbifaturon ato sepse shumica e konsumatorëve familjarë konsumojnë nën këtë normë të presupozuar ose një pjesë e tyre abuzojnë pasi kanë shtëpi private apo janë në zona rurale ku uji shpesh herë përdoret për ujtime.

Prioritet i shoqërive UK duhet të jetë pajisja 100% me ujëmatës në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë dhe konsumatorëve individuale, por për këtë kërkohet edhe mbështetja me financime nga qeveria qendrore.

Shoqëritë UK për vitin 2019 kanë raportuar instalimin e 47 543 matëseve të rinj duke e çuar numrin e lidhjeve me matës në 685 376 lidhje nga 886 474 lidhje ekzistuese në total në të gjithë shoqëritë.

Ende Sektori vazhdon të faturojë aforfe 673 Institucione si dhe 7516 biznese ku në zbatim të Vendim Nr. 236, datë 10.5.1993 dhe VKM nr.96, datë 21.2.2007 duhet të kishte përfunduar instalimi i matësve në kategorinë klientë jofamiljarë të financuara nga vetë këto klientë.

Konstatohen ritme të ulëta të instalimit të matësve krahasuar me vitin 2018. Më shumë matës janë instaluar nga shoqëritë UK Tiranë, (9779), UK Vlorë (6710), UK Durrës (7328) dhe UK Fier (3313).

Pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit mbetet një nga objektivat kryesorë të shoqërive, si një element që lehtëson mjaft problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve dhe të mbikonusimit në sisteme.

1.1.5 Efiçenca e Stafit

Efiçenca e Stafit përfaqëson numrin e stafit të shoqërisë për 1000 lidhje UK. Ky tregues merr rëndësi të veçantë sepse lidhet direkt me kostot e punës të cilat zënë një peshë të konsiderueshme ndaj totalit të kostove. Nga të dhënat, vihet re që gjatë vitit 2019 numri total i punonjësve në sektorin UK është rritur me 336 punonjës.

Treguesi i performancës së Eficences së Stafit për vitin 2019 është mesatarisht 5,33 staf/1000 lidhje UK, me një përmirësim të vogël prej (0.2 staf/1000 lidhje UK), por që akoma qëndron larg nivelit të kërkuar. Ky përmirësim ka ardhur vetëm nga shtimi me 24 095 i numrit të lidhjeve të ujit dhe me 37 342 lidhje lidhjeve të KUN duke mbizotëruar efektin negativ mbi këtë tregues nga rritja e numrit të punonjësve. Përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish, numër i cili në mjaft raste rritet artificialisht me punonjës që nuk përputhen me kërkesat dhe përshkrimet e vendit të punës. Vetëm disa shoqëri, si UK Korçë, UK Tiranë, UK Kamëz, UK Sarandë, UK Berat Kuçovë, UK Lezhë etj. plotësojnë kushtin ku efiçenca e stafit është në nivele bashkëkohore. Nga ana tjetër, zgjerimi i zonës së shërbimit nga zona rurale ka sjellë nevojën e rritjes së numrit të punonjësve të shoqërive UK për mbulimin me shërbime në këto zona.

Një problem evident në sektorin UK është punësimi i njerëzve nga shoqëritë UK në baza militantizmi partiak dhe jo mbi baza të nevojave reale të shoqërisë për shtesë stafi dhe sipas kualifikimeve të duhura.

Është theksuar dhe në raportimet e mëparshme që në mjaft raste treguesi i Efiçencës së Stafit është artificialisht i lartë për shkak të veçorive që paraqesin komponentët e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në plotësim të detyrimeve ligjore në garantim të sigurisë së këtyre veprave me personel roje. Kështu në ato zona shërbimi ku sistemet e furnizimit me ujë kanë një numër të madh deposh, pusesh etj., shoqëritë paraqesin në organigramën e tyre një numër mjaft të madh punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte. ERRU në aplikimet e shoqërive për tarifa analizon në thellësi këtë tregues i cili lidhet direkt me kostot e punës, duke konsideruar vetëm kostot e justifikuara për përballimin nëpërmjet tarifës.

Është theksuar edhe në raportet e mëparshme që garantimi i sigurisë së objekteve të ujësjellësit si objekte të rëndësishme të veçante duhet konsideruar së bashku me zgjidhje teknike dhe logjistike për të ulur kostot e tepërta të stafit për garantimin e sigurisë së tyre.

1.1.6 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Për vitin 2019 treguesi i Vazhdimësisë së Furnizimit me Ujë për sektorin është në nivelin 13.3 orë/ditë me një përmirësim prej 0.6 orë/ditë. *Gjatë vitit 2019 në sektor, si rezultat i investimeve fizike të suksesshme nga Qeveria Qendrore nëpërmjet AKUM-it është përmirësuar cilësia e shërbimeve, veçanërisht në qytetet Tepelenë, Memaliaj, Përmet dhe Cërrik.* Tashmë këto qytete furnizohen me ujë 24 orë në ditë duke iu bashkangjitur listës së 9 qyteteve, përkatësisht Korçë, Pogradec, Fier, Lezhë, Fushë Arrëz, Tropojë, Bilisht, Konispol dhe Maliq, të cilat kanë realizuar që në vitet e mëparshme një furnizim me ujë pa ndërprerje për popullsinë.

Edhe pse i përmirësuar ky tregues është në nivel të papranueshëm për shoqëritë që akoma ofrojnë shërbim deri në 6 orë/ditë, si UK Kamëz, UK Roskovec, UK Kavajë, UK Klos, UK Lushnjë, UK Dropull, UK Finiq dhe UK Krujë. Ky tregues krahas nivelit të ulët të shërbimit të ofruar lidhet edhe me problemet e rrezikut të shëndetit të publikut nga mundësia e futjes në tubacione të ujërave nëntokësore të ndotura gjatë kohës që tubacionet janë bosh madje dhe shpesh herë nën presion negativ.

Për vitin 2020, nga investimet e qeverisë qendrore nëpërmjet AKUM pritet që të realizohet furnizimi me ujë për 24 orë/ditë edhe për 8 qendra urbane të tjera (qytete), përkatësisht, Pukë, Vau Dejës, Koplik, Krujë, Peqin, Këlcyrë, Ersekë, Rrëshen dhe Poliçan, që e çon në fund të vitit 2020 në 22 numrin e qyteteve të furnizuara me ujë pa ndërprerje në të gjithë vendin.

Qeveria qendrore nëpërmjet AKUM ka në objektivin e saj afat shkurtër që nga 66 qendra urbane në vend, 52 prej tyre do të kenë furnizim me ujë pa ndërprerje deri në fund të vitit 2021, dhe 58 deri në fund të vitit 2023.

Theksohet fakti se me riorganizimin e ri të shoqërive, asnjë shoqëri nuk ofron furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur si mesatare për të gjithë zonën e re të shërbimit ku përfshihet edhe zona rurale. Referuar të dhënave të vitit 2019 krahasuar me vitin 2015 (para fillimit të reformës territoriale) popullsia e zonës rurale që shërbehet nga shoqëritë UK është rritur, por kohëzgjatja e furnizimit me ujë të pijshëm për këto zona përgjithësisht është e ulët krahasuar me zonën urbane. Kjo është arsyeja që ky tregues ka pësuar rënie për shumë shoqëri UK. Nga ana tjetër, ky tregues aktualisht llogaritet vetëm duke u nisur nga koha e zbrazjes së depos kur furnizon rrjetin shpërndarës, e cila nuk është metoda e duhur për matjen dhe vlerësimin e tij.

1.1.7 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe të KUN

Treguesi “Mbulimi me FU” dhe “Mbulimi me KUN” për vitin 2019 ka shënuar një rënie respektivisht me 0.2% dhe 1% krahasuar me vitin 2018.

Popullsia në zonën e juridiksionit për vitin 2019 raportohet rreth 4.3 milion banorë me një rritje me 231 mijë banorë krahasuar me vitin paraardhës.

Popullsia e shërbyer me furnizimin me ujë në krahasim me vitin 2018 raportohet të jetë shtuar me 145 mijë banorë, ndërsa ajo me kanalizime është shtuar me 70 mijë banorë ose të shprehura në përqindje, 63% dhe 30 %. Ndërkohë në vitin 2019 popullsia e shtuar në të gjithë vendin në total rezulton të jetë 231 mijë banorë. Gjithsesi këto të dhëna për popullsinë duhet të përditësohen dhe saktësohen me censusin e ri që pritet të realizohet së shpejti sepse dihet që popullsia rezidente në vendin tonë sipas të dhënave të census-it të vitit 2011 është mjaft më e ulët (rreth 2,8 milion banorë).

Në lidhje me mbulimin me KUN, në pjesën më të madhe në zonën rurale mungon rrjeti mbledhës i tyre dhe shkarkimet e ujërave të ndotura realizohen kryesisht individualisht me gropa septike që përgjithësisht nuk respektojnë standardet teknike të zbatimit të tyre, respektimi i të cilave mbetet sfida për tu realizuar në të ardhmen.

Zona urbane aktualisht shërbehet me ujë të pijshëm në nivelin 92 % kundrejt 58.8% që shërbehet në zonat rurale. Shërbimi i kanalizimeve të UN në zonën rurale është në nivelin rreth 13% kundrejt 80.6% që është në zonën urbane.

1.2 Rezultatet Financiare të Sektorit

1.2.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet

Tabela 41 në Aneks 3 jep për çdo shoqëri UK të ardhurat nga aktiviteti duke i krahasuar ato me Kostot e O&M dhe Kostot Totale, si dhe rezultatin përkatës financiar vjetor të tyre me humbje ose fitim. Në të jepen gjithashtu edhe nevojat reale për subvencione për të mbuluar kostot e O&M si dhe subvencionet e marra nga shoqëritë.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 9 763.5 milion lekë të ardhura nga aktiviteti i shoqërive UK, që krahasuar me vitin paraardhës të ardhurat janë ulur me 35.7 milion lekë, ndërkohë që të ardhurat nga subvencionet e akorduara nga qeveria qendrore janë zvogëluar me 391,7 milion lekë.

Tabela 6 jep në mënyrë të përmblendhur të ardhurat për sektorin nga aktiviteti i shoqërive UK dhe nga subvencionet e akorduara nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM-it.

Tabela 6. Të Ardhurat e Sektorit UK për Vitet 2018-2019 nga Aktiviteti dhe Subvencionet

Nr.	Emërtimi	Viti 2018 (në 000 lekë)	Viti 2019 (në 000 lekë)	Diferenca (në 000 lekë)
1	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	9,799,216	9,763,452	-35,764
2	Të Ardhurat nga Subvencionet	1,055,910	700,000	-355,910
3	TOTALI	10,855,126	10,463,452	-391,674

Duke patur parasysh ndarjen e shoqërive në grupe, tabela 7 jep të dhënat mbi të Ardhurat e Sektorit për Vitet 2018-2019 të ndara sipas Grupeve të Shoqërive UK.

Tabela 7. Të Ardhurat e Sektorit UK për Vitet 2018-2019 sipas Grupeve të Shoqërive UK

Nr.	Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2019
		Grupi i I-rë (në 000 lekë)		Grupi i II-të (në 000 lekë)		Grupi i III-të (në 000 lekë)	
1	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	8,528,246	8,395,141	1,103,420	1,238,406	167,550	129,906
2	Të Ardhurat nga Subvencionet	616,026	419,544	373,190	257,213	66,695	23,243
3	TOTALI	9,144,272	8,814,685	1,476,610	1,495,619	234,245	153,149
	Diferenca pa Subvencionet	-133,105		+134,986		-37,644	

Nga tabela e mësipërme vërehet se në shoqëritë e **Grupit të I-rë** të ardhurat kanë pësuar një rënie të konsiderueshme prej 133 milion lekë, ku brënda Grupit veçohen UK Tiranë (-74.4 milion lekë), UK Durrës (-18.4 milion lekë), UK Korçë (-41.5 milion lekë), UK Kamëz (-26 milion lekë) dhe UK Lezhë (-27.9 milion lekë). Në këtë grup janë disa shoqëri që kanë rritur të ardhurat si, UK Vlorë me (+12 milion lekë), UK Fier (+10 milion lekë), UK Kavajë (+19 milion lekë), UK Berat Kuçovë (+11.3 milion lekë) dhe UK Sarandë (+7 milion lekë).

Në **Grupin e II-të** konstatohet rritje e të ardhurave për vitin 2019 në shumën 76.4 milion lekë ku rritjen më të madhe e kanë shënuar UK Gjirokastrë, UK Dibër, UK Librazhd, UK Cërrik, UK Dropull. Në këtë grup

ka gjithashtu shoqëri që kanë pasur rënie të të ardhurave, si UK Kurbin (-5.5 milion lekë), UK Skrapar (-5 milion lekë), UK Vorë (-4.9 milion lekë).

Grupi i III-të me peshën minimale në totalin e të ardhurave rezulton me rritje të të ardhurave me rreth 21.6 milion lekë duke mos konsideruar UK Finiq dhe UK Klos të cilat nuk kanë raportuar të dhëna për vitin 2018, pra nuk ka bazë krahasimore.

Analiza konstaton se **për vitin 2019 janë 14 shoqëri që i mbulojnë mbi 100% kostot O&M nga 57 shoqëri** në total. Niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes për shoqëritë e Grupit të I-rë sidomos ka rënë në 115% nga 133% që është raportuar në vitin 2018.

Në analizën e situatës financiare të vitit 2019 duhen konsideruar dhe problemet e mëdha që shkaktuan dy tërmetet e fuqishme në Shtator dhe Nëntor të këtij viti, ku ndërmjet të tjerave vështirësuan mjaft procesin e faturimit në muajt e fundit të vitit duke bërë që të ardhurat të mos jenë ato të parashikuara.

Kjo konstatohet edhe nga fakti që sasia e ujit të faturuar për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 është rritur me 1.6 milion m³ ujë që nuk i përgjigjet rritjes me 24 083 lidhje të reja të furnizimit me ujë. E njëjta situatë konstatohet edhe në faturimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura, ku niveli i rritur i faturimit nuk përkon me rritjen me 37 342 lidhje të reja të tyre.

Spektori akoma qëndron larg mbulimit të kostove totale, dhe diferenca është rritur akoma më shumë për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. Nevoja për subvencionim mbetet e domosdoshme, por adresimi i tyre drejt shoqërive që kanë më shumë nevojë duhet të jetë prioritet.

Nevoja për subvencione për Spektorin për vitin 2019 për të mbuluar diferencat e kostove të O&M me të ardhurat është llogaritur në vlerën prej 1,340.5 milion lekë (rreth 10.7 milion euro), ndërkohë që fondi i akorduar shoqërive si subvencion është rreth 700 milion lekë (5.7 milion euro).

Përgjithësisht diferenca e pa mbuluar e kostove të O&M me subvencione ka patur si konsequencë mospagimin e faturave të energjisë elektrike të shoqërive ndaj OSHEE-së duke rritur më tej borxhin e shoqërive ndaj këtij të fundit.

Kanë përfituar 60% të totalit të subvencioneve, përkatësisht shoqëritë UK Vlorë 98 milion lekë, UK Durrës 62.3 milion lekë, UK Kavajë 36 milion lekë.

Vlerësohet pozitivisht fakti që AKUM një pjesë të mirë të subvencioneve (300 milion lekë) e ka shpërndarë si incentive performance për shoqëritë, Korçë, Berat-Kuçovë, Librazhd dhe Pogradec, të cilat i mbulojnë kostot O&M me të ardhurat nga aktiviteti.

Tabela 41 në Aneksin 3 jep një pasqyrë të detajuar të nevojës për subvencione për vitin 2019, si dhe alokimin (shpërndarjen) e realizuar praktikisht gjatë vitit për çdo shoqëri UK.

Nga tabela konstatohet që për vitin 2019 sektori UK është subvencionuar me 700 milion lekë nga të cilat 400 milion lekë për mbulimin e diferencës kosto-tarifë dhe 300 milion lekë si bonus për performancë të mirë të shoqërive.

Nga shpërndarja e subvencioneve konstatohet se pothuajse të gjitha shoqëritë (me përjashtim të 13 shoqërive UK, të cilat i mbulojnë kostot O&M me të ardhurat nga aktiviteti, janë subvencionuar nën nevojat për mbulimin e kostove O&M.

Gjithsesi kërkohet më shumë transparencë dhe objektivitet për mënyrën e shpërndarjes së fondeve të subvencioneve në të ardhmen.

1.2.2 Nevoja për Investime Kapitale dhe Financimi i Sektorit UK

Investimet nga Buxheti i Shtetit

Është i njohur fakti që sektori i ujësjellës kanalizimeve në vendin tonë ka nevoja mjaft të mëdha për investime fizike për të përmbushur kërkesat e Direktivës Evropiane të Ujit të Pijshëm dhe Ujërave të Ndotura. Nga një vlerësim i rishikuar i Master Planit Kombëtar për këtë fushë rezulton që nevojat për investime fizike në sektor të jenë rreth vlerës së 5 miliard Euro. Për përmbushjen e këtyre kërkesave rezulton që kërkojnë rreth 200 milion Euro/vit duke patur parasysh projektimin e tyre në 25 vite.

Mënyra e synuar e financimit të nevojave fizike të sektorit përcaktohet në draft Strategjinë e Financimit të sektorit të ujësjellës kanalizimeve nëpërmjet sistemit të 3T-ve, përkatësisht nga Taksat (buxheti i shtetit), Transferta (financimi i donatorëve), si dhe nga Tarifatat (faturat e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve nga konsumatorët).

Në kuadër të vazhdimësisë së reformës në sektor qeveria qendrore e ka patur në fokus kontributin në rritje nga buxheti i shtetit për investimet në fushën e ujësjellës kanalizimeve.

Qeveria Qendrore për vitin 2019 planifikoi një fond investimesh në fushën e ujësjellës kanalizimeve prej 4,432 miliard lekë që janë ekuivalente me rreth 35 milion Euro.

Tabela 8 jep në mënyrë të përmbledhur ndarjen e buxhetit të shtetit për vitin 2019 për investimet fizike në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, ndërsa lista e detajuar e të gjithë projekteve të zbatuara gjatë vitit 2019 me financim nga buxheti i shtetit jepet në Tabelën 46, Aneks 8 .

Tabela 8. Buxheti i Shtetit për Investimet në Ujësjellës Kanalizime për Vitin 2019

Nr.	Përshkrimi	Vlera (000 Lekë)
1	Objekte të prapambetura dhe të reja vitit 2018	2,579,000
2	Objekte të reja 2019	1,082,000
3	TVSH dhe Taksa Doganore	454,000
TOTALI		4,432,000 (eq. me 35 milion euro)

Burimi: AKUM

Investimet e realizuara gjatë vitit 2019 nga buxheti i shtetit kanë qenë në zbatim të prioriteteve strategjike të sektorit UK. Qeveria qendrore ka në objektivin e saj afat shkurtër për të realizuar nëpërmjet AKUM-it për periudhën 2019-2023 që nga 66 qendra urbane në vend, 52 prej tyre do të kenë furnizim me ujë pa ndërprerje deri në fund të vitit 2021, dhe 58 deri në fund të vitit 2023.

Gjatë vitit 2019 si rezultat i këtyre investimeve u arrit furnizimi me ujë pa ndërprerje (24 orë) për katër qendra urbane (qytete), përkatësisht Tepelenë, Memaliaj, Përmet dhe Cërrik.

Investimet në vazhdim edhe për qendrat e tjera urbane parashikojnë që në vitin 2020 të realizohet furnizimi me ujë për 24 orë/ditë edhe për 8 qytete të tjerë, përkatësisht, Pukë, Vau Dejës, Koplik, Krujë, Peqin, Këlcyrë, Ersekë, Rrëshen dhe Poliçan, që e çon në fund të vitit 2021 në 22 numrin e qyteteve të furnizuara me ujë pa ndërprerje në të gjithë vendin.

Në tabelën 45 aneks 7 jepet ecuria dhe perspektiva e kohës së Furnizimit me Ujë (sipas Planit Strategjik të AKUM) për zonat urbane sipas qarqeve.

Investimeve të mësipërme u shtohet edhe vlera prej 300 milion lekë (2,4 milion euro), investime që janë planifikuar dhe realizuar në mbështetje të reformës në sektor për përmirësimin e infrastrukturës fizike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për bashkitë, Durrës 76,6 milion Lekë, Malësi e Madhe 50 milion lekë, Rrogozhinë 49,5 milion lekë, Vau i Dejës 35 milion lekë, si dhe për studime dhe projekte për rreth 80 milion lekë.

Investimet nga Donatorët e Huaj

Gjatë vitit 2019 ka vazhduar zbatimi i projekteve me financime të huaja të llojit grante ose kredi në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Donatorët e huaj gjatë vitit 2019 kanë investuar (zbatim punimesh) në total rreth 34 milion Euro. Tabela 9 jep listën e projekteve që kanë qenë aktive (kanë disbursuar fonde) nga donatorë të ndryshëm në të cilën nuk përfshihen kontributet lokale apo ato të rimbursimeve të taksave doganore dhe të TVSH-së.

Nga këto projekte veçohen si të realizuara në vlera të konsiderueshme ato të financuara nga Banka Botërore dhe BE për Durrësin, projekti në mbështetje të rrjetit hidrik të Tiranës financiar nga Qeveria Italiane, si dhe programi i infrastrukturës bashkiake III dhe IV financiar nga KfW dhe SECO.

Tabela 9. Realizimi i Projekteve të Investimeve të Huaja gjatë Vitit 2019 në Sistemet e Ujësjetës KUZ

Projekti	Donatori Lloji i Financimit	Vlera Totale e Projektit (në 000 Lekë)	Realizimi për Vitin 2019 (në 000 Lekë)
Mbështetje për Rrjetin Hidrik të Tiranës	Qeveria Italiane (Kredi)	1,447,036	869,879
Projekti i KUZ të Tiranës së Madhe	Qeveria Japoneze (Kredi)	9,750,841	100,227
Projekti i Ri i FU për Qytetin Durrës	BB, BEI (Kredi)	8,750,000	2,517,427
Programi i Infrastrukturës Bashkiake III e IV	KfW/SECO (Kredi/Grante)	7,019,600	766,809
Periferitë Urbane të Tiranës, Komponenti Infrastrukturor	Qeveria Italiane (Kredi)	131,180	25,437
Infrastruktura Bashkiake V	KfW, EU, SECO (Grante)	46,900	217,976
Totali		27,145,557 (203,371,000 Euro)	4,497,755 (33,696,562 Euro)

Siç shihet vlera e investimeve të financuara nga donatorët e huaj është pothuajse e barabartë me atë të Qeverisë Qendrore në fushën e ujësjetës kanalizimeve. Në total kontributi nga buxheti i qeverisë dhe nga donatorët e huaj llogaritet rreth 70 milion Euro, që përfaqëson rreth 35 % të nevojave të sektorit (200 milion Euro) të përmendura më sipër referuar vlerësimit nga Master Plani dhe projektimit të nevojave për një periudhë 25 vjeçare.

Akoma financimi aktual në sektor nuk i përgjigjet nevojave reale në përmbushje të tre Direktivave Evropiane për Ujin e Pijshëm dhe Ujërat e Ndotura², ku vendi ynë synon të hapë së shpejti negociatat për aderimin në Komunitetin Evropian.

Ndihet gjithashtu nevoja e miratimit të draftit mbi dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit Ujësjellës Kanalizimeve në Shqipëri i iniciuar që në maj të vitit 2016, i cili përfshin një model për financimin e sektorit, i cili akoma nuk është miratuar me ndonjë Vendim të Këshillit të Ministrave. Ky model identifikoi kostot për arritjen e objektivave të sektorit, burimet e ndryshme të financimit për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të tij (3T-të), duke respektuar kushtin që tarifat të jenë të përballueshme nga konsumatorët.

1.3 Reforma në Sektor dhe Nevoja për Agregim

Reforma në sektorin e ujit e cila i ka fillimet e saj në janar 2016 në zbatim të VKM nr. 63, i cili parashikonte riorganizimin e shoqërive UK sipas parimit 1 shoqëri = 1 bashki ishte një sfidë mjaft e madhe për shoqëritë dhe bashkitë për t'u realizuar në formën e kërkuar brenda afateve të përcaktuara në VKM.

Procesi i inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit të aseteve dhe me pas regjistrimi i tyre në QKB paraqitej mjaft problematik, për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës në ish komunat që u shtuan në zonën e shërbimit të shoqërive UK.

Aktualisht shoqëritë UK operojnë dhe ofrojnë shërbimin sipas ndarjes së re territoriale, por nuk kanë arritur të plotësojnë kërkesat sipas parashikimeve që kishte procesi i riorganizimit. Procesi parashikonte gjithashtu që brenda 3 muajve nga përfundimi i tij shoqëritë duhet të aplikojnë pranë Entit Rregullator të Ujit për licencim dhe miratimin e tarifave të reja për të gjithë zonën e re të shërbimit. Reforma paraqiti mjaft vështirësi në riorganizimin burokratik të shoqërive, si dhe në përmbushje të kërkesave të kapaciteteve të stafeve të shoqërive ku deri në fund të vitit 2019, vetëm 37 nga 57 shoqëri UK kanë përfunduar riorganizimin e tyre dhe janë Licencuar nga ERRU sipas reformës (shih Tabelën 39, Aneks 1).

ERRU në vazhdimësi ka ndjekur nga afër dhe ka inkurajuar procesin e riorganizimit dhe përfundimit të licencimit të të gjithë shoqërive UK në përputhje me riorganizimin e tyre sipas reformës.

Reforma është akoma në proces zbatimi dhe gjithashtu po ndiqet nga afër edhe nga AKUM në zbatim të kontratave të performancës të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Bashkive bazuar në tregues performance që në mjaft raste janë të përcaktuara apriori. AKUM duhet të rrisë përpjekjet së bashku me shoqëritë UK përkatëse në përcaktimin më të saktë të vlerave të Treguesve Kryesorë të Performancës si bazë e këtyre Kontratave që kushtëzojnë shpërndarjen e subvencioneve, si dhe të incentivave për investimet fizike. Gjithsesi ndjekja e reformës nga AKUM ka dhënë rezultate pozitive për sektorin në drejtim të :

- eliminimit të lidhjeve të paligjshme, si rezultat i aksionit të ndërmarrë në nivel kombëtar u arrit të evidentohet një numër i konsiderueshëm lidhjesh ilegale, kjo ndikoj edhe në rritjen e numrit të klientëve;
- rritjes së numrit të ujëmatësave të vendosur: pothuajse të gjitha shoqëritë kanë shtuar numrin e ujëmatësave të instaluar, kjo ka ndikuar edhe në përmirësimin e treguesit niveli i matjes;

² Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian (Direktiva e Politikave të Ujit).
Direktiva 98/83/EC (Direktiva e Ujit të Pijshëm);
Direktiva 91/271/EEC (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura)

- arkëtimeve të debive të prapambetura: u rrit ndjeshëm përgjegjshmëria qytetare për likuidimin e debive të prapambetura duke u bërë pjesë e marrëveshjeve individuale për shlyerjen e tyre.

Në fund të vitit 2019, për përshpejtimin dhe arritjen e përmirësimit të gjendjes në sektor, MIE përpiloi një qasje që akoma është në diskutim me të gjithë aktorët në sektor para se të formalizohet për zbatim.

Qasja e propozuar për shëndoshjen e sektorit të ujësjellës kanalizimeve bazohet në ndarjen në dy kategori të shoqërive UK, përkatësisht në ato që operojnë duke mbuluar kostot e O&M dhe në ato të cilat kanë nevojë për subvencionim nga Qeveria Qendrore.

Propozimi merr në konsideratë shoqëritë e kategorisë që kanë nevojë për subvencion nga qeveria qendrore dhe propozon një Plan Veprimi për to me një shtrirje kohore zbatimi rreth dy vjeçare.

Theksohet fakti se janë 43 nga 57 shoqëri UK që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M. Për këtë kategori të shoqërive, në princip, qasja propozon agregimin e tyre “të detyruar” ku qeveria bëhet aksionere me investimet fizike që do të investojë në shoqëri, përndryshe nuk i kryen financimet për investime fizike dhe nuk akordon subvencionet për të mbuluar kostot e O&M. Kjo qasje përgjithësisht synon krijimin e shoqërive të agreguara përgjithësisht gjigande që do të menaxhohet nga një staf qendror (Struktura e Kompetencave të Përbashkëta ose SKP). Gjithashtu për shoqëritë që nuk përmbushin treguesit e performancës në mënyrë të vazhdueshme qasja presupozon futjen në veprim të Operatorit të Alternatives së Fundit, i cili merr përsipër manaxhimin e shoqërisë për një periudhë të caktuar deri në përmirësimin e treguesve të performancës dhe më tej ja kthen përsëri shoqërisë së mëparshme UK.

Gjithsesi eksperiencia ndërkombëtare dhe ajo e vendeve me kushte të përafërta me tonat nuk njeh ndonjë shembull suksesi ku sektori është agreguar pothuajse në mënyrë të menjëhershme.

Shëndoshja afatshkurtër financiare e sektorit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit pritet të vijë kryesisht nga reduktimi i fuqisë punëtore dhe rritja e normës së arkëtimit. Lënia në njëfarë mënyre, e bashkive jashtë procesit kompromenton sidomos faktorin e dytë (normën e arkëtimit), ku roli i bashkisë është mjaft i rëndësishëm në mbështetje kundër debitorëve dhe abuzuesve.

Studimi i bëshmerisë i vitit 2008 për agregimin e sektorit të ujit në Shqipëri, financuar nga Banka Botërore, ka konkluduar se agregimi duhet realizuar mbi baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore. Procesi duhet të jetë diskret (kërkon kohën e duhur), gradual, mbështetje me fonde (incentiva) dhe me angazhim të fortë institucional të pushtetit qendror dhe atij vendor.

Nga ana tjetër, krijimi i shoqërisë së agreguar në përmasa të tilla, në kufi kohorë mjaft të shkurtër, është pothuajse i pamundur të realizohet. Afati minimal për plotësimin e kërkesave burokratike të krijimit dhe vënies në operim të shoqërisë së agreguar është rreth 2 vjet.

Për sa më sipër, ERRU për vazhdimësinë e reformës në sektorin e ujit rekomandon:

- Të vazhdohet procesi i vlerësimit të treguesve të performancës (të arritjes së objektivave) për secilën shoqëri UK, si proces mjaft i rëndësishëm në përcaktimin e instrumentave përkatës për shëndoshjen financiare të tyre;
- Në kontratat e reja të performancës AKUM duhet të vlerësojë sesa janë treguesit e performancës, të dakortësojë me shoqëritë objektivat që duhen arritur prej saj në fund të vitit 2020.
- Duhet të nisët procesi i agregimit të shoqërive UK si avantazh i ekonomisë së shkallës sipas principit “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore” duke synuar që fillimisht të realizohen 2-3 agregime të suksesshme. Seleksionimi i rasteve të mundshme me pritshmëri pozitive duhet të bazohet në një studim anketimi të të gjithë bashkive të vendit ku mund të zbatohet principi i mësipërm.

1.4 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave

Raporti i performancës së shoqërive UK dhe të sektorit për vitin 2019 për herë të parë është hartuar duke u bazuar në të dhënat që shoqëritë UK kanë dorëzuar pranë ERRU në vijim të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator Nr. 31, datë 28.06.2019 mbi “Platformën e Data Bazës për Grumbullimin e të Dhënave nga Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime”.

ERRU mori iniciativën për të patur bazën e saj të pavarur të të dhënave për monitorimin e shoqërive dhe hartimin e Raporteve Vjetore të Performancës së shoqërive UK si një nevojë për të mënjeluar problematikat e vazhdueshme që ERRU ka patur në vite për varësinë e të dhënave të marra nga Drejtoria e Monitorimit dhe Benchmarkut pranë AKUM si dhe për të minimizuar problemin kronik të vërtetësisë dhe pasaktësisë së të dhënave që jo rrallë ka influencuar në konkluzionet për përmirësimin e performancës së sektorit.

Me gjithë përpjekjet e ERRU në asistencën e dhënë ndaj çdo shoqërie UK si në takime të drejtpërdrejta me drejtuesit dhe personat kyç të shoqërisë ashtu edhe në komunikimet e shpeshta telefonike dhe elektronike me to në drejtim të plotësimit dhe raportimit të të dhënave, ende vërehen pasaktësi jo të vogla në drejtim të të dhënave tekniko-ekonomike. Ky fakt reflektohet veçanërisht në bilancet e ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së, të cilat hartohen me vlerësime jo me instrumenta matëse, në mënyrë empirike për shkaqe të ndryshme, por kryesisht për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë. Kjo sjellë si pasojë që treguesi kryesor i performancës, Uji Pa të Ardhura të rezultojë me shkallë relativisht jo të vogël pasaktësie.

Pasaktësi ka gjithashtu edhe në raportimet që bëjnë shoqëritë në drejtim të arkëtimit të detyrimeve korente dhe atyre të prapambetura mbi bazën e të cilave llogaritet treguesi Norma e Arkëtimit.

Përveç faktorëve të njohur lidhur me mungesën e saktësisë së të dhënave nga shoqëritë UK, një ndikim negativ të konsiderueshëm ka patur mos përfundimi i riorganizimit të shoqërive sipas Reformës Territoriale që duhej të kishte përfunduar në fund të vitit 2016. Deri në fund të vitit 2019 akoma nga totali prej 57 shoqëri UK vetëm 37 prej tyre janë riorganizuar dhe licencuar nga ERRU sipas reformës.

Tabela 39 në Aneks 1 paraqet në detaje gjendjen e riorganizimit të sektorit për të gjithë shoqëritë UK sipas raportimeve të tyre. Bashkitë dhe shoqëritë përkatëse UK duhet të forcojnë angazhimin e tyre për të përfunduar procesin e riorganizimit me regjistrimin e asetëve dhe hapat e tjerë burokratike të domosdoshme sepse pjesa dërmuese e shoqërive raportojnë të dhënat për të gjithë zonën, pasi ato kryejnë shërbimin UK në zonë sipas ndarjes së re Administrative, pavarësisht se nuk ka përfunduar ligjërisht procesi i riorganizimit të tyre.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm është përgjegjshmëria e stafëve drejtues në drejtim të raportimit të të dhënave të kërkuara ku bëhen raportime në vlera të ndryshme për të dhëna të njëjta nga drejtori të ndryshme brenda të njëjtës shoqërie.

Nisur nga faktorët e mësipërm për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, hartuesit e Raportit kanë qenë shumë të kujdesshëm në kryerjen e analizës së të dhënave për të përjashtuar në konkluzionet e tij atë pjesë të të dhënave që nuk ka një bazë justifikimi për të eliminuar vlerësimet e gabuara mbi performancën e sektorit në përgjithësi, si dhe të secilës shoqërie UK në veçanti.

2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime

2.1 Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Grupimeve të Shoqërive UK

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjellës kanalizime është i bazuar në 9 tregues kryesorë të performancës (Norma e Arkëtimit Korente dhe ajo Totale përmbledhen në një tregues) të cituara dhe në kapitujt e mëparshëm dhe të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Duke patur parasysh nevojën për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare, në përzgjedhjen e TKP përparësi u është dhënë atyre treguesve që vlerësojnë situatën ekonomike të shoqërive, kapacitetet aktuale menaxhuese si dhe shërbimin ndaj konsumatorëve.

Nëpërmjet këtyre treguesve janë analizuar dhe vlerësuar drejtimet më të rëndësishme të punës së operatorëve duke na dhënë një pasqyrë të plotë të nivelit të ofruar të shërbimeve.

Të gjitha shoqëritë UK raportojnë të dhënat për zonën e shërbimit sipas reformës edhe pse kemi akoma 20 shoqëri të pa licencuara nga ERRU në përputhje me reformën. Treguesit e llogaritur të këtyre shoqërive mund të krahasohen me ato të një viti më parë pasi janë shoqëri të cilat kanë raportuar të dhëna për të dytin vit radhazi dhe ka një bazë për ti vlerësuar dhe krahasuar treguesit e performancës së tyre.

Për vitin 2019 janë dy shoqëri që kanë raportuar për herë të parë përkatësisht UK Finiq dhe Bashkia Klos (akoma nuk është krijuar si Sh.a) detyrimisht këto shoqëri janë pasqyruar në grafikët dhe tabelat e raportit vetëm për vitin 2019, por janë përjashtuar nga krahasimi me vitin paraardhës i cili në këtë raport performance do të bëhet vetëm për 55 shoqëri të ndara në tre grupe respektive nga 57 shoqëri që operojnë gjithsej në sektor.

Edhe në këtë raport performance është përdorur e njëjta metodologji, si për ndarjen në grupe të shoqërive, ashtu dhe në vlerësimin e treguesve të tyre.

Ka një ndryshim në Grupet e renditjes së shoqërive krahasuar me vitin paraardhës, bazuar në kriterin e numrit të lidhjeve për klasifikimin e shoqërive, tre shoqëri përkatësisht UK Ersekë, UK Delvinë dhe UK Mirditë janë përfshirë në Grupin e II-të për shkak të shtimit të numrit të lidhjeve në përputhje me këtë kategori.

Tabela 10 jep tre grupimet e shoqërive UK sipas madhësisë (numrit të lidhjeve).

Tabela 10. Grupimet e Shoqërive Sipas Numrit të Lidhjeve

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup	Numri i shoqërive që do të analizohen në grup
Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjellës kanalizime	14	14
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjellës kanalizime	32	32
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjellës kanalizime	11	11

Në detaje numri i lidhjeve për çdo shoqëri në secilin grup jepet në Tabelën 11

Tabela 11. Numri i lidhjeve për çdo Shoqëri sipas Grupimeve

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)
Grupi 1			Grupi 2 (vazhdimi)		
UK	Tiranë	251,886	UK	Malësi e Madhe	5,197
UK	Durrës	87,885	UK	Vorë	4,800
UK	Vlorë	56,579	U	Bulqize	4,798
UK	Elbasan	39,754	UK	Tepelenë	4,773
UK	Fier	37,659	U	Përmet	4,764
UK	Shkodër	31,464	UK	Dropull	4,625
UK	Korçë	29,147	U	Selenicë	4,209
UK	Berat -Kuçovë	28,858	UK	Ura Vajgurore	4,102
UK	Kavajë	26,156	UK	Vau i Dejës	4,047
UK	Lushnje	23,005	U	Peqin	3,974
UK	Sarandë	19,797	UK	Skrapar	3,704
UK	Kamëz	17,794	UK	Roskovec	3,219
UK	Lezhë	17,277	UK	Ersekë	3,141
UK	Pogradec	17,277	UK	Delvinë	3,134
Grupi 2			UK	Mirditë	3,040
UK	Maliq	10,183	Grupi 3		
UK	Gjirokastrë	10,091	UK	Poliçan	2,995
UK	Devoll	8,482	UK	Tropoje	2,995
UK	Dibër	8,126	UK	Finiq	2,567
UK	Kurbini	7,604	U	Konispol	2,011
UK	Cërrik	7,481	UK	Pukë	1,742
UK	Belsh	7,000	UK	Këlcyrë	1,706
UK	Kukës	6,899	U	Has	1,550
UK	Librazhd	6,579	U	Klos	1,528
UK	Mat	6,578	UK	Libohovë	1,513
UK	Divjake	6,332	UK	Fushë – Arrëz	735
UK	Krujë	6,290	UK	Pustec	734
UK	Himare	6,332			
U	Patos	5,835			-
UK	Mallakastër	5,774			
U	Gramsh	5,626			
UK	Rrogozhinë	5,594			

Burimi i Informacionit ERRU

2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU

Për efekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar objektivat e synuar (që duhen arritur nga shoqëritë UK) për vlerësimin e performancës. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit të synuar për arritjen e një performance të mirë, gjithçka poshtë vijës së kuqe tregon performancë të dobët. Segmenti ndërmjet dy vijave konsiderohet performancë e “pranueshme”, që tregon nga njëra anë përpjekjet e bëra nga shoqëritë dhe nga ana tjetër domosdoshmërinë për përmirësime të mëtejshme.

Në tabelën nr. 12 tregohen kufijtë minimal dhe maksimal të përcaktuar për secilin TKP, ndërsa në grafikun 1 më poshtë është një shembull i grafikëve të analizës së TKP.




Figura 1. Grafik i Analizës së TKP-ve

Tabela 12 Objektivat për TKP të Vendosura nga ERRU

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivat nga ERRU		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Eficienca e Stafit (numri i stafit për 1000 lidhje) ³	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji Pa të Ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i Matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤8 orë/ditë
8 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%

³ Për TKP Eficienca e Stafit, objektivi i benchmarking është më i lartë për shoqëritë e vogla, duke marrë parasysh faktin që shoqëritë më të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me densitet popullsie më të madhe) e kanë më të lehtë të mbajnë më të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës

2.3.1 Uji Pa të Ardhura

Sasia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve quhet "Ujë Pa të Ardhura". Ky tregues ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive si dhe në mbulimin e kostove operative duke qenë se humbjet komerciale reduktojnë të ardhurat dhe humbjet teknike rrisin kostot operative. Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues, shpërndarës etj.).

Në rang sektori, treguesi "Ujë Pa të Ardhura" në nivelin 63,7% për vitin 2019 nuk paraqet trend përmirësimi, pasi shumë shoqëri si pasojë e reformës territoriale kanë përfshirë në zonën e juridiksionit sisteme furnizimi gjendja teknike e të cilave ka influencuar negativisht në performancën e shoqërive. Analiza e Bilancit të Ujit tregoi se gjatë vitit 2019, në sektorin UK janë rritur humbjet nga lidhjet e paligjshme në transmetim (+0.18%) dhe shpërndarje (+2%) krahasuar me vitin paraardhës.

ERRU thekson se menaxhimi më i mirë i kompanive, hartimi i planeve të biznesit dhe përfshirja në to e planeve të veprimit për përmirësimin e treguesve të performancës dhe sidomos të UPA do të sjellë ndryshimet e kërkuara në sektorin UK.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2019




Figura 2. Uji Pa të Ardhura për Grupin e I-rë, viti 2019

Në Grupin e I-rë të përbërë nga 14 shoqëri UK, pranë kufirit të mirë të performacës qëndron shoqëria UK Korçë me nivel të UPA 30.6%, pasuar nga UK Lezhë 35% dhe UK Pogradec 35.40%. Performojnë dobët, me nivelin e Ujit Pa të Ardhura nga 50-80%, 10 shoqëri UK.

Vazhdueshmëri për reduktimin e UPA paraqesin shoqëritë UK Kavajë (-13.5%), UK Sarandë (-13.4%), UK Berat-Kuçovë (-4.7%), UK Lezhë (-4%) etj.

Perkeqësim të treguesit paraqesin UK Fier (+13.30%), UK Kamëz (+9.50%), UK Pogradec (+6.40%), UK Korçë (+4.60%) etj. Me gjithë investimet e kryera gjatë viteve të fundit, shoqëria UK Vlorë (78%) ende paraqitet me nivelin më të lartë të humbjeve në grup.

Tabela 13. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Kavajë	UK	53.00	39.50	-13.50
2	Sarandë	UK	64.00	50.60	-13.40
3	Berat - Kuçovë	UK	77.00	72.30	-4.70
4	Lezhë	UK	39.00	35.00	-4.00
5	Tiranë	UK	62.00	60.20	-1.80
6	Lushnje	UK	75.00	74.00	-1.00
7	Durrës	UK	74.00	73.90	-0.10
8	Vlorë	UK	77.00	78.00	+1.00
9	Elbasan	UK	75.00	76.80	+1.80
10	Shkodër	UK	67.00	69.70	+2.70
11	Korçë	UK	26.00	30.60	+4.60
12	Pogradec	UK	29.00	35.40	+6.40
13	Kamëz	UK	52.00	61.50	+9.50
14	Fier	UK	59.00	72.30	+13.30

Nga krahasimi i të dhënave për dy vitet e fundit vërehet se shoqëritë UK Kavajë, UK Sarandë, UK Berat-Kuçovë dhe UK Lezhë kanë përmirësim për treguesin e UPA.

Grupi 2 - Uji Pa të Ardhura (%)




Figura 3. Uji Pa të Ardhura për Grupin e II-të, viti 2019

Në Grupin e II-të të shoqërive, mungesa e matësave në prodhim dhe në pikat kyçe të sistemit për shumicën e shoqërive UK, bën të pabesueshëm dhe me luhatje të mëdha nga një vit në tjetrin nivelin e UPA veçanërisht për shoqëritë UK Belsh, UK Kukës, UK Dropull, UK Roskovec, UK Selenicë, UK Skrapar, UK Divjakë, UK Dibër etj. Gjatë vitit 2019, nën kufirin 30-50% të Benchmarking kanë performuar 11 shoqëri UK ndërsa 17 shoqëri të tjera performojnë dobët. Për shoqërinë UK Dibër, rritja e sasisë së ujit që hyn në sistem së bashku me orët e furnizimit (me rreth +4 orë) nuk janë shoqëruar me rritje të faturimit e për pasojë ky tregues është përkeqësuar me (+25.50%).

Përkeqësim të treguesit paraqesin shoqëritë UK Peqin (+10.60%), UK Skrapar(+10.40%), UK Rrogozhinë (+9.30%) etj. Me nivelin më të lartë të Ujit Pa të Ardhura paraqiten UK Cërrik (68.40%), UK Peqin (67.60%), UK Bulqizë (65.6%), UK Vorë (65.30%) etj.

Për shoqëritë e grupit të dytë, emergjente mbetet instalimi i ujëmatësave në prodhim pasi këto shoqëri kanë nivelin më të ulët të matjes (25%) për faktorin “Ujë i prodhuar që hyn në sistem”.

Më poshtë në tabelën 14, jepet ecuria e treguesit Uji Pa të Ardhura për dy vitet e fundit për Grupin e II-të

Tabela 14. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Dropull	UK	70.00	25.90	-44.10
2	Selenice	U	68.00	50.10	-17.90
3	Divjake	UK	54.00	41.00	-13.00
4	Gjirokastër	UK	56.00	44.40	-11.60
5	Malësi e Madhe	UK	57.00	46.00	-11.00
6	Belsh	UK	22.00	12.90	-9.10
7	Vau i Dejës	UK	55.00	46.70	-8.30
8	Përmet	U	52.00	44.00	-8.00
9	Roskovec	UK	68.00	60.00	-8.00
10	Krujë	UK	68.00	60.80	-7.20
11	Tepelenë	UK	62.00	57.10	-4.90
12	Himarë	UK	59.00	54.40	-4.60
13	Kolonje	UK	43.00	39.00	-4.00
14	Vorë	UK	68.00	65.30	-2.70
15	Delvinë	UK	48.00	45.60	-2.40
16	Ura Vajgurore	UK	59.00	57.20	-1.80
17	Kukës	UK	23.00	21.30	-1.70
18	Gramsh	U	41.00	39.60	-1.40
19	Librazhd	UK	66.00	64.70	-1.30
20	Devoll	UK	22.00	20.90	-1.10
21	Kurbini	UK	65.00	64.20	-0.80
22	Maliq	UK	41.00	40.30	-0.70
23	Mirditë	UK	48.00	47.60	-0.40
24	Mallakastër	UK	62.00	64.50	+2.50
25	Bulqizë	U	60.00	65.60	+5.60
26	Patos	UK	54.00	59.90	+5.90
27	Mat	UK	38.00	44.00	+6.00
28	Cerrik	UK	62.00	68.40	+6.40
29	Rrogozhinë	UK	54.00	63.30	+9.30
30	Skrapar	UK	44.00	54.40	+10.40
31	Peqin	UK	57.00	67.60	+10.60
32	Dibër	UK	35.00	60.50	+25.50

Grupi 3 - Uji Pa të Ardhura (%)




Figura 4. Uji Pa të Ardhura për Grupin e III-të, viti 2019

Në Grupin e III-të të shoqërive, nën kufirin e performancës së mirë paraqiten shoqëritë UK Libohovë (26.30%) dhe UK Klos (29.50%), dy shoqëri performojnë dobët dhe pjesa tjetër performon mbi kufirin 50% të Benchmarking. Me nivelin më të lartë të humbjeve paraqiten UK Finiq (82.40%), UK Kelcyrë (82.10%), UK Fushë Arrëz (70.20%) etj. Për përmirësim të treguesit spikasin UK Poliçan (-4.80%), UK Tropojë (4.60%) dhe UK Pukë (1.50%). Shoqëritë UK Klos dhe UK Finiq raportojnë të dhënat pranë ERRU për herë të parë.

Tabela 15. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Pustec	UK	50.00	42.00	-8.00
2	Libohovë	UK	34.00	26.30	-7.70
3	Poliçan	UK	46.00	41.20	-4.80
4	Tropojë	UK	61.00	56.40	-4.60
5	Pukë	UK	64.00	62.50	-1.50
6	Kelcyrë	UK	80.00	80.10	+0.10
7	Konispol	UK	50.00	50.40	+0.40
8	Fushë Arrëz	UK	69.00	70.20	+1.20
9	Has	UK	52.00	56.80	+4.80
10	Finiq	UK		82.40	
11	Klos	U		29.50	

Krahasimi i të dhënave për dy vitet e fundit paraqet trend në përmirësim të treguesit UPA për shoqëritë UK Poliçan, UK Tropojë si dhe UK Pukë. Vështirësitë në hartimin e Bilancit të Ujit, raportimet jo korrekte në vlerësimin e ujit të prodhuar në vite, bëjnë të pabesueshëm nivelin e UPA dhe trendin e tij për shoqëritë UK Pustec dhe UK Libohovë

Përfundime

- Nga analiza e mësipërme vërehet se gjatë vitit 2019, treguesi UPA në rang sektori është rritur në nivelin 0.7% pasi shumë nga sistemet e zonave të reja administrative, të cilat ju bashkuan shoqërive UK në zbatim të reformës së re territoriale, ishin mjaft të amortizuara e me lidhje të shumta të paligjshme të cilat ndikuan në rritjen e nivelit të UPA. Në shumë raste konsumatorët e rinj (zonat rurale të shtuara) janë faturuar me tarifë fikse pavarësisht konsumit real i cili përgjithësisht është shumë më i lartë se vlerësimi i bërë nga shoqëria. Gjithashtu, instalimi i matësve të rinj për konsumatorët në disa prej shoqërive është shoqëruar me fenomenin e rënies së konsumit të faturuar.
- Niveli i Ujit Pa të Ardhura për vitin 2019 është 63.7%, performojnë nën kufirin 30% të performancës së mirë gjashtë shoqëri UK, 17 prej tyre performojnë brenda kufirit 30-50% dhe pjesa e mbetur mbi kufirin 50%.
- Shqetësim për ERRU vazhdon të mbetet niveli i ulët i matjes për ujin e prodhuar i cili për këtë vit ka pësuar rënie në nivelin 3% (Analiza Bilanci i Ujit për vitin 2019), mungesa e matësve në pikat kyçe të prodhimit dhe vlerësimi jo i saktë i prodhimit është shoqëruar me luhatje të nivelit të UPA i pa argumentuar në disa shoqëri UK. Për këtë arsye instalimi i ujëmatësve në prodhim dhe për të gjithë kategoritë e konsumatorëve paraqitet domosdoshmëri.
- Hartimi i planeve të biznesit dhe përfshirja në to e planeve të veprimit për të reduktuar humbjet komerciale (dukshme) dhe atyre teknike (reale) mbetet emergjente për shumicën e shoqërive UK.
- Eliminimi i lidhjeve të paligjshme, evidentimi i klientëve të rinj, përmirësimi i situatës teknike të sistemeve të vjetruara mbeten ende detyrat kryesore për të gjitha shoqëritë UK, për përmirësimin e treguesit UPA dhe në tërësi të situatës financiare së tyre.
- ERRU sugjeron të gjitha shoqëritë UK që ti kushtojnë vëmendje "Bilancit të Ujit", i cili ende nuk hartohet saktë nga shumë shoqëri ose neglizhohet prej tyre. Vlerësimi i saktë i komponentëve që përbëjnë këtë bilanc do të jetë pasqyra në të cilën duhet të bazohen për të hartuar planet e veprimit për të reduktuar në kohë Ujin Pa të Ardhura.

2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M

“Mbulimi i Kostove O&M” është treguesi që pasqyron se deri në çfarë mase shoqëria mbulon me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kostot e drejtpërdrejta që i nevojiten për funksionimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e tij, (pa kostot kapitale dhe të amortizimit), tregues që bën të mundur vlerësimin e situatës financiare të një shoqërie.

Në vitin 2019, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 107.1% nga 119 % që ishte në vitin paraardhës duke shënuar përkeqësim të ndjeshëm. Sektori nga viti 2013 e në vijim ka mbuluar kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes mbi 100 % me luhatje pozitive apo negative gjatë viteve. ERRU konstaton se në sektor janë 14 shoqëri që kanë këtë tregues mbi 100%. Me poshtë ky tregues analizohet në detaje për secilin grupim të shoqërive.

Performanca për Vitin 2019

Në Grupin e I-rë, bëjnë pjesë 14 shoqëritë më të mëdha, një pjesë e të cilave për disa vite rresht arrijnë të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100%. Figura 5 jep grafikisht realizimin e këtij treguesi për shoqëritë e Grupit të I-rë për vitin 2019.

Siç shihet nga grafiku, niveli i objektivit të synuar për performancë të mirë 100% i vendosur nga ERRU është tejkaluar nga 6 shoqëri, përkatësisht: UK Berat-Kuçovë, UK Sarandë, UK Pogradec, UK Korçë, UK Tiranë dhe UK Lezhë nga 9 shoqëri që ishin në vitin 2018.




Figura 5. Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e I-rë, viti 2019.

Këto shoqëri edhe pse janë në nivele të performancës shumë të mirë, krahasuar me vitin 2018 kanë rënie të këtij treguesi, me përjashtim të UK Sarandë që raporton të ardhura të rritura me 7 milion lekë, të pesë shoqëritë e tjera kanë shënuar rënie të të ardhurave. Nga ana tjetër kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes kanë shënuar rritje për të gjitha këto shoqëri.

Në këtë grup janë tre shoqëri që prej vitesh vazhdojnë të mbeten në zonën e performancës së dobët dhe konkretisht UK Vlorë, UK Kavajë dhe UK Lushnje respektivisht me 60.8%, 43.5% dhe 76.2%.

UK Kavajë raporton rreth 148.6 milion kosto të rritura dhe 19.1 milion rritje të të ardhurave që e ka pozicionuar këtë shoqëri në nivel shumë të ulët, por dhe me rënie të konsiderueshme prej 17.5% krahasuar me vitin 2018.

Në brezin e performancës së pranueshme (80%-100%) janë 5 shoqëri, UK Durrës, UK Fier, UK Kamëz, UK Elbasan dhe UK Shkodër.

Tabela 16 paraqet ecurinë e treguesit mbulimi i Kostove O&M për dy vitet e fundit.

Tabela 16. Ecuria e Treguesit Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Elbasan	UK	92.00	94.60	+2.60
2	Vlorë	UK	60.00	60.80	+0.80
3	Lushnje	UK	77.00	76.20	-0.80
4	Berat - Kuçovë	UK	138.00	136.10	-1.90
5	Sarandë	UK	115.00	112.00	-3.00
6	Shkodër	UK	89.00	86.00	-3.00
7	Pogradec	UK	123.00	117.50	-5.50
8	Fier	UK	103.00	90.30	-12.70
9	Kavajë	UK	61.00	43.50	-17.50
10	Korçë	UK	199.00	179.20	-19.80
11	Durrës	UK	107.00	86.90	-20.10
12	Tiranë	UK	186.00	160.40	-25.60
13	Lezhë	UK	201.00	139.10	-61.90
14	Kamëz	UK	170.00	82.30	-87.70

Krahasuar më vitin 2018 në këtë grup përgjatë vitit 2019 kanë pasur përmirësim minimal vetëm UK Elbasan dhe UK Vlorë, të 12 shoqëritë e tjera kanë rënie të këtij treguesi. Regresin më të madh e ka shënuar UK Kamëz (-87.7%), UK Lezhë (-61.9%) duke vijuar me UK Tiranë, UK Durrës UK Vlorë e shoqëritë e tjera referuar tabelës së mësipërme.

Shoqëritë e grupit të parë duke përjashtuar vetëm UK Korçë dhe UK Lushnje ku niveli i kostove mbetet pothuajse i njëjti me vitin 2018, raportojnë kosto të rritura në nivele të larta ku si total është 923.3 milion lekë.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2019

Grupi II-të për vitin 2019 në përputhje me kriterin e grupimit sipas numrit të lidhjeve përfshin 32 shoqëri nga 29 që ishin në vitin 2018. Evidentohen si shoqëri me performancë të mirë 8 shoqëri që kanë arritur të mbulojnë Kostot e O&M me mbi 100%. Sipas grafikut shoqëria e radhitur e para në performancë është UK Librazhd me 127.4 % e ndjekur nga UK Kolonjë, UK Himarë, UK Malësi e Madhe, UK Devoll, UK Kukës, UK Dibër dhe UK Mat.

Grupi 2 - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 6. Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e II-të, viti 2019

Në zonën e performancës së dobët nën 80% renditen 19 shoqëri. Shoqëria me performancën më të dobët me 22.9% mbulim kosto O&M është UK Patos e cila për vite mbetet në fund të klasifikimit.

Në brezin e performancës së pranueshme, (80%-100%) janë renditur pesë shoqëri, ku UK Dropull është shoqëria që ka përmirësim me 20,9% duke arritur në nivelin e treguesit 98%. Nga ana tjetër është UK Bulqizë e cila ka shënuar rënie më të madhe në Grupin e II-të prej 21.8% duke e kaluar shoqërinë nga performanca e mirë me 110% për vitin 2018 në atë të pranueshme me 88.2%.

Tabela 17 paraqet ecurinë e këtij treguesi për Grupin e II-të gjatë dy viteve të fundit.

Tabela 17. Ecuria e mbulimit të kostove O&M për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Dropull	UK	60.00	80.90	+20.90
2	Himarë	UK	98.00	117.20	+19.20
3	Vau i Dejës	UK	34.00	48.30	+14.30
4	Dibër	UK	91.00	101.60	+10.60
5	Librazhd	UK	117.00	127.40	+10.40
6	Malësi e Madhe	UK	111.00	115.90	+4.90
7	Mallakastër	UK	55.00	59.50	+4.50
8	Belsh	UK	74.00	78.10	+4.10
9	Përmet	UK	71.00	75.00	+4.00
10	Rrogozhinë	UK	58.00	60.80	+2.80
11	Gjirokastrë	UK	95.00	95.80	+0.80
12	Patos	UK	23.00	22.90	-0.10
13	Cërrik	UK	69.00	67.00	-2.00
14	Selenicë	UK	60.00	57.60	-2.40
15	Ura Vajgurore	UK	53.00	50.60	-2.40
16	Skrapar	UK	72.00	69.30	-2.70
17	Peqin	UK	52.00	48.90	-3.10
18	Krujë	UK	71.00	67.80	-3.20
19	Mirditë	UK	61.00	56.30	-4.70
20	Maliq	UK	76.00	70.80	-5.20
21	Kurbin	UK	40.00	33.50	-6.50
22	Gramsh	U	100.00	93.30	-6.70
23	Roskovec	UK	78.00	69.40	-8.60
24	Mat	UK	110.00	100.10	-9.90
25	Devoll	UK	124.00	113.80	-10.20
26	Divjakë	U	69.00	58.60	-10.40
27	Vorë	UK	92.00	80.90	-11.10
28	Delvinë	UK	88.00	75.40	-12.60
29	Tepelenë	UK	45.00	28.50	-16.50
30	Kukës	UK	120.00	102.30	-17.70
31	Kolonjë	UK	141.00	121.00	-20.00
32	Bulqizë	UK	110.00	88.20	-21.80

Nga 32 shoqëri të këtij grupi raportohen 11 shoqëri që e kanë përmirësuar treguesin e mbulimit të Kostove të O&M në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. Përmirësimi në mbulimin e Kostove të O&M varion nga 0.8% deri në 20.9%.

Përmirësimin më të madh e ka shënuar UK Dropull me 20.9 % duke arritur nivelin e mbulimit në 80.9%, nga 60% që ishte në vitin 2018. Arsyeja e përmirësimit është rritja e të ardhurave me 7.8 milion lekë kundrejt kostove që janë rritur me 5.5 milion lekë

UK Himarë gjithashtu ka një përmirësim me 19.2% duke e renditur shoqërinë nga performanca e pranueshme në atë të performancës shumë të mirë me mbulimin 117.2 % të kostove O&M. Gjithashtu

edhe UK Vau Dejës ka shënuar progres me (+14.3%), por që vijon të mbetet në shoqëritë që performojnë dobët në lidhje me këtë tregues.

Në këtë grup ka shoqëri si UK Mat, UK Devoll, UK Kukës dhe UK Kolonjë të cilat edhe pse kanë performancë shumë të mirë (mbi 100%) kanë shënuar regres për vitin 2019. Rënia e këtij treguesi për këto katër shoqëri ka ardhur sepse kanë rritur kostot në nivele më të larta se të ardhurat.

Grupi i III-të i Shoqërive

Në Grupin e III-të bëjnë pjesë 11 shoqëri, nga të cilat shoqëria UK Finiq dhe Bashkia Klos nuk kanë raportuar të dhëna për vitin 2018 për të cilat nuk do të behet analiza në mënyrë krahasimore me vitin aktual 2019.

Performanca për Vitin 2019




Figura 7. Mbulimi i Kostove O&M Grupi III-të, Viti 2019

Objektivi i vendosur nga ERRU për performancë të mirë, për të mbuluar tërësisht Kostot O&M nuk është arritur nga asnjë shoqëri e grupit të tretë.

Në zonën e performancës së pranueshme për vitin 2018 janë dy shoqëri, UK Tropojë (88.4%) që ka shënuar dhe përmirësimin më të madh në grup (+2.4%) si dhe UK Pukë (87,3%) e cila ka shënuar regres me (-1.7%). Shoqëria me performancën më të dobët është UK Libohovë që mbulon (25.6%) të Kostove të O&M dhe që ka rënien më të madhe me (-19.4%).

Tabela 18 paraqet ecurinë e këtij treguesi për Grupin e III-të gjatë dy viteve të fundit.

Tabela 18. Ecuria e Mbulimit të Kostove O&M për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Tropojë	UK	86.00	88.40	+2.40
2	Fushë Arrëz	UK	49.00	49.60	+0.60
3	Has	UK	49.00	48.20	-0.80
4	Këlcyrë	UK	58.00	52.90	-5.10
5	Konispol	UK	73.00	62.40	-10.60
6	Pukë	UK	99.00	87.30	-11.70
7	Pustec	UK	64.00	51.40	-12.60
8	Poliçan	UK	71.00	56.30	-14.70
9	Libohovë	UK	45	25.6	-19.4
10	Finiq	UK	-	66.7	NA
11	Klos	UK	-	46.30	NA

Për shoqëritë e Grupit të III-të, për pjesën më të madhe të shoqërive, treguesi i mbulimit të Kostove O&M në vitin 2019 ka patur tendencë negative krahasuar me vitin 2018.

Ky grup përbëhet nga shoqëri shumë të vogla, impakti pozitiv apo negativ i tyre në sektor është i papërfillshëm pasi të ardhurat dhe kostot e tyre O&M zënë respektivisht 2% dhe 1%.

Përfundime

- Nga analiza e këtij treguesi për të tre grupet e shoqërive rezulton se niveli i mbulimit të kostove O&M për vitin 2019 është përkeqësuar krahasuar me vitin 2018. Nga 57 shoqëri të cilat kanë raportuar të dhëna për vitin 2019, rezultojnë se 14 prej tyre kanë arritur të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M, 12 shoqëri janë në nivelin e mbulimit 80%-100% dhe 31 shoqëri janë në nivelin nën 80%. Në sektor operojnë 10 shoqëri të cilat nuk mbulojnë as 50% të kostove O&M. Këto shoqëri nuk kanë aftësi financiare për të përballuar kostot e O&M, rrjedhimisht mbështetja me subvencione nga buxheti i shtetit është e domosdoshme.
- UK Kamëz, është një shoqëri që ka përkeqësimin më të madh në sektor në lidhje me nivelin e mbulimit të kostove. Kjo shoqëri është e pa licencuar dhe pa tarifa të miratuara nga ERRU për probleme të përmbushjes së kushteve ligjore për licencim.
- Kostot e O&M janë elementi bazë i propozimeve të shoqërive për tarifa të reja për ti mbuluar ato. Shoqëritë duhet të argumentojnë në mënyrë të detajuar kostot që raportojnë, ti raportojnë shpenzimet sipas qendrave të kostos për të bërë një tarifim sa më të saktë për të dy shërbimet veç e veç dhe për të qenë transparent ndaj konsumatorëve.

2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale

Që një shoqëri të quhet e qëndrueshme financiarisht duhet të përballojë kostot totale për shërbimet që ofron me të ardhurat e realizuara nga këto shërbime. Ende sektori është larg këtij qëllimi, dhe ky vit e ka larguar edhe më shumë pasi niveli i mbulimit të kostove totale ka rënë me 14.5%.

Edhe në këtë raport, ERRU nuk i ka analizuar në grupe shoqëritë, por sektorin në tërësi pasi janë vetëm katër shoqëri që përballojnë kostot totale të operimit me të ardhurat nga aktiviteti përkatësisht UK Tiranë (119%), UK Kolonjë (110.7%), UK Librazhd (106%), dhe UK Dibër (100.2%).

Në nivelin e performancës (50%-80%) raportohen 27 shoqëri, në nivelin e performancës së mirë (mbi 80%) raportohen 5 shoqëri nga 18 që ishin në vitin 2018.

Pjesa tjetër e shoqërive janë në brezin e performancës së dobët, ku ka shoqëri me nivele minimale të mbulimit të kostove si UK Patos (21.8%), UK Tepelenë (22.7%), UK Libohovë (24.7%), dhe UK Kurbin (31.2%).

ERRU e thekson se një situatë e tillë është e papranueshme pasi shoqëritë nuk arrijnë të përballojnë kostot e punës e jo më të shikohet mundësia e përmirësimit të cilësisë së shërbimit nëpërmjet investimeve qofshin edhe minimale. Si një mundësi e rregullimit të tyre mbetet agregimi me shoqëri të forta financiarisht ose subvencionimi i vazhdueshëm i tyre nga qeveria qendrore.

Për përballimin e Kostove Totale për sektorin UK nevojat për subvencione llogariten në 28 milion euro. Tabela 19 e mëposhtme paraqet ecurinë e këtij treguesi për të gjithë shoqëritë gjatë dy viteve të fundit.

Edhe pse shoqëritë kanë nivele të ulëta të treguesit “Mbulimi i Kostove Totale”, ajo që paraqitet akoma më problematike është se për vitin 2019 nga 55 shoqëri të marra në analizën krahasimore raportohen 44 shoqëri me rënie të treguesit të mbulimit të kostove totale nga 21 shoqëri që ishin në vitin 2018.

Tendencën pozitive më të mirë e kanë UK Dibër (14.2%), UK Librazhd (14%), UK Krujë (13.1%) dhe UK Vau Dejës (12.5%), por ky i fundit vazhdon të qëndrojë në nivelin e performancës së dobët.

Në shumicën dërmuese të shoqërive konstatohen rritje të kostove totale në nivele shumë më të larta se rritja e të ardhurave nga aktiviteti UK.

Për vitin 2019 rezulton që nga 1 914,3 milion lekë kosto totale të rritura shoqëritë e Grupit të I-rë zënë 88 % të tyre ose në vlerën 1 689 milion lekë.

Të ardhurat e sektorit kanë shënuar rënie me 35.7 milion lekë, shoqëritë e Grupit të II-të dhe të tretë rezultojnë me të ardhura të rritura, por pa arritur të mbulojnë rënien e konsiderueshme që ka shënuar grupi i parë me 133 milion lekë.

Ndikim negativ ka dhënë dhe situata e vështirë e krijuar nga tërmetet e vitit 2019 sidomos në qytetet Durrës, Lezhë, Kurbin, Krujë, Tiranë, Vorë ku nxjerrja jashtë funksionit e shumë banesave dhe pallateve ka sjellë uljen e numrit të klientëve e si rrjedhojë dhe mos faturim të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, situatë e cila vazhdon dhe aktualisht.

Tabela 19. Ecuria e Mbulimit të Kostove Totale

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Lezhë	UK	94	55.8	-38.20
2	Kamëz	UK	83	51.4	-31.60
3	Tiranë	UK	148	119	-29.00
4	Durrës	UK	94	70.7	-23.30
5	Kukës	UK	94	72.6	-21.40
6	Sarandë	UK	92	71.8	-20.20
7	Libohovë	UK	43	24.7	-18.30
8	Roskovec	UK	58	39.9	-18.10
9	Kolonjë	UK	127	110.7	-16.30
10	Malësi e Madhe	UK	83	68.8	-14.20
11	Fier	UK	88	75	-13.00
12	Poliçan	UK	66	53	-13.00
13	Pustec	UK	55	42.3	-12.70
14	Mat	UK	97	84.9	-12.10
15	Korçë	UK	90	78.4	-11.60
16	Vlorë	UK	48	37.9	-10.10
17	Konispol	UK	67	57.4	-9.60
18	Tepelenë	UK	32	22.7	-9.30
19	Vorë	UK	85	76.4	-8.60
20	Kavajë	UK	50	41.7	-8.30
21	Devoll	UK	89	81	-8.00
22	Berat - Kuçovë	UK	98	90.1	-7.90
23	Fushë Arrëz	UK	37	29.2	-7.80
24	Shkodër	UK	57	49.3	-7.70
25	Gjirokastër	UK	82	75.2	-6.80
26	Divjakë	UK	62	56	-6.00
27	Maliq	UK	68	62.5	-5.50
28	Pukë	UK	70	64.6	-5.40
29	Pogradec	UK	58	52.6	-5.40
30	Tropojë	UK	65	60	-5.00
31	Kurbin	UK	36	31.2	-4.80
32	Rrogozhinë	UK	52	47.3	-4.70
33	Cërrik	UK	63	58.8	-4.20
34	Këlcyrë	UK	50	46.6	-3.40
35	Selenicë	U	60	57.4	-2.60
36	Delvinë	UK	64	61.8	-2.20
37	Elbasan	UK	75	73.1	-1.90
38	Peqin	UK	48	46.1	-1.90
39	Ura Vajgurore	UK	45	43.3	-1.70
40	Gramsh	U	78	77.1	-0.90
41	Mallakastër	UK	48	47.4	-0.60
42	Himarë	UK	92	91.4	-0.60
43	Lushnje	UK	52	51.8	-0.20
44	Patos	UK	22	21.8	-0.20
45	Skrapar	UK	54	54.5	+0.50
46	Mirditë	UK	34	35.9	+1.90
47	Përmet	U	68	70.6	+2.60
48	Has	UK	32	35.3	+3.30
49	Belsh	UK	68	73.5	+5.50
50	Dropull	UK	47	54.1	+7.10
51	Bulqizë	U	79	87.5	+8.50
52	Vau i Dejës	UK	24	36.5	+12.50
53	Krujë	UK	48	61.1	+13.10
54	Librazhd	UK	92	106	+14.00
55	Dibër	UK	86	100.2	+14.20

2.3.4 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është shprehja në përqindje e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës kanalizime. Ky tregues tregon efektivitetin e shoqërisë për të garantuar likuiditetin e saj.

Norma e Arkëtimit varet kryesisht nga faktorë manaxherial. ERRU në analizën e shoqërive sipas grupeve edhe për vitin 2019 llogarit treguesit Norma e Arkëtimit Korente (NAK) që tregon arkëtimet e shitjeve të shërbimeve UK për vitin korent (2019) si dhe Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (NAP) ku janë përfshirë dhe arkëtimet e debive përpara vitit raportues.

Për vitin 2019 NAK rezulton 79,8% që ka shënuar një përmirësim me 0.8% krahasuar me vitin 2018.

Nga debitë e prapambetura gjatë vitit 2019 janë arkëtuar rreth 1,6 miliard lekë, duke shënuar rënie me 100 milion lekë krahasuar me vitin 2018.

Në analizën e Grupeve fokusi është NAK pasi sa më e lartë efijenca e mbledhjes së të ardhurave korente aq më shumë rritet mundësia për eliminimin e debisë vjetër.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2019




Figura 8. Norma e Arkëtimit Korente për Grupin e I-rë, Viti 2019

Në Grupin e I-rë, shoqëritë me performancën më të mirë me mbi 82% të këtij treguesi për vitin 2019 janë UK Lezhë me 90.7%, UK Berat-Kuçovë me 89.5%, UK Pogradec me 87.8%, UK Fier me 83% të cilat raportojnë dhe përmirësim të këtij treguesi si dhe UK Tiranë me 84.9%, por për vitin 2019 ka rënie të treguesit me (-2.1%).

Në këtë grup nuk raportohet asnjë shoqëri në brezin e performancës së dobët, pjesa tjetër e shoqërive janë në brezin e performancës së pranueshme (60-82%).

Tabela 20 paraqet ecurinë e treguesit Norma e Arkëtimit Korente për Grupin e I-rë.

Tabela 20. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Kavajë	UK	50.00	78.60	+28.60
2	Elbasan	UK	63	78.9	+15.90
3	Vlorë	UK	63.00	78.20	+15.20
4	Pogradec	UK	75.00	87.80	+12.80
5	Fier	UK	72.00	83.00	+11.00
6	Shkodër	UK	71.00	79.40	+8.40
7	Berat - Kuçovë	UK	83.00	89.50	+6.50
8	Lezhë	UK	85.00	90.70	+5.70
9	Korçë	UK	74.00	78.80	+4.80
10	Sarandë	UK	79.00	78.00	-1.00
11	Tiranë	UK	87.00	84.90	-2.10
12	Durrës	UK	74.00	70.20	-3.80
13	Lushnje	UK	79.00	64.80	-14.20
14	Kamëz	UK	96.00	74.50	-21.50

Nga 14 shoqëri të analizuar, 9 prej tyre kanë shënuar përmirësim të treguesit NAK. Për vitin 2019 progresin më të madh e ka shënuar UK Kavajë e cila në vitin 2018 ishte e vetmja shoqëri e grupit të parë që performonte dobët. Përmirësimi me (28.6%) e ka radhitur këtë shoqëri në brezin e performancës së pranueshme. Me përmirësim dyshifror janë dhe shoqëritë UK Elbasan, Vlorë, Pogradec dhe Fier. Rënien më të madhe të treguesit në këtë grup e ka UK Lushnje me 14.2% dhe UK Kamëz me 21.5%.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2019

Grupi 2 - Norma e Arkëtimit Korente (%)




Figura 9. Norma e Arkëtimit Korente për Grupin e II-të, Viti 2019

Në Grupin e II-të nga 32 shoqëri, 14 prej tyre janë në brezin e performancës së mirë ku kryeson UK Krujë me 93.1% duke vijuar me UK Peqin 92.6%, UK Himarë me 91.2%, UK Ura Vajguore me 91.5%, duke vijuar më tej me shoqëritë e tjera deri te UK Mirditë me 82%. Të gjitha shoqëritë e këtij brezi kanë shënuar përmirësim të këtij treguesi me përjashtim të UK Gramsh që ka rënie me 3.4%.

Në brezin e performancës së pranueshme janë 16 shoqëri duke filluar nga UK Patos me 76.5% e duke vijuar sipas grafikut deri te UK Divjakë me 60.2%. Konstatohet se 12 shoqëri të këtij brezi kanë raportuar rënie të këtij treguesi e cila tregon për një keq menaxhim nga ana e drejtuesve të shoqërisë. Theksohet fakti se tre shoqëri UK Kolonjë, UK Patos dhe UK Skrapar kanë kaluar nga brezi i performancës së mirë (mbi 82%) në brezin e performancës së pranueshme.

Në zonën e performancës së dobët janë dy shoqëri, përkatësisht UK Mat me 59.8% dhe me rënie të konsiderueshme (-14.2%) si dhe UK Dibër me 48.6%, me ndryshim të pakonsiderueshëm me vitin 2018. Tabela 21 paraqet ecurinë e treguesit të Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e II-të të shoqërive.

Tabela 21. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktivitet	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Vorë	UK	64.00	90.10	+26.10
2	Belsh	UK	69.00	91.20	+22.20
3	Himarë	UK	72.00	91.80	+19.80
4	Dropull	UK	68.00	87.00	+19.00
5	Roskovec	UK	42.00	60.80	+18.80
6	Malësi e Madhe	UK	70.00	88.20	+18.20
7	Mirditë	UK	64.00	82.00	+18.00
8	Tepelenë	UK	74.00	88.90	+14.90
9	Mallakastër	UK	63.00	73.30	+10.30
10	Ura Vajguore	UK	83.00	90.50	+7.50
11	Peqin	UK	86.00	92.60	+6.60
12	Kurbin	UK	79.00	83.20	+4.20
13	Krujë	UK	89.00	93.10	+4.10
14	Devoll	UK	63.00	66.60	+3.60
15	Librazhd	UK	81.00	84.20	+3.20
16	Maliq	UK	82.00	83.00	+1.00
17	Rrogozhinë	UK	62.00	63.00	+1.00
18	Gjirokastër	UK	75.00	75.90	+0.90
19	Dibër	UK	48.00	48.60	+0.60
20	Gramsh	U	88.00	84.60	-3.40
21	Vau i Dejës	U	76.00	72.10	-3.90
22	Bulqizë	U	75.00	70.80	-4.20
23	Selenicë	UK	76.00	71.30	-4.70
24	Patos	U	82.00	76.50	-5.50
25	Përmet	UK	79.00	72.50	-6.50
26	Skrapar	UK	84.00	75.50	-8.50
27	Divjakë	UK	69.00	60.20	-8.80
28	Kukës	UK	71.00	60.70	-10.30
29	Delvinë	UK	78.00	64.50	-13.50
30	Mat	UK	74.00	59.80	-14.20
31	Kolonjë	UK	90.00	75.50	-14.50
32	Cërrik	UK	76.00	60.70	-15.30

Ecurinë më të mirë e ka UK Vorë me (+26.1%) duke vijuar me UK Belsh, UK Himarë, UK Dropull, UK Malësi e Madhe, UK Mirditë UK Tepelenë dhe UK Kurbin ku progresi i shënuar i ka çuar këto shoqëri nga performanca e pranueshme në performancën e mirë

Në këtë Grup janë 13 shoqëri që kanë përkeqësuar treguesin e NAK nga të cilat 5 shoqëri kanë rënien më të madhe, si UK Cërrik me (-15.3%), UK Kolonjë (-14.5), UK Mat (-14.2%), UK Delvinë (-13.5), dhe UK Kukës (-10.3%).

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2019




Figura 10. Norma e Arkëtimit Korente për Grupin e III-të, Viti 2019

Në Grupin e III-të bëjnë pjesë 11 shoqëri, por në analizën krahasimore janë 9 shoqëri pasi UK Finiq dhe UK Klos nuk kanë të dhëna për vitin paraardhës.

Në brezin e performancës së mirë janë tre shoqëri, UK Poliçan me 99.7%, UK Konispol me 92.9% dhe UK Pukë me 83.6%, të tre këto shoqëri për vitin 2018 renditeshin në shoqëritë me performancë të pranueshme.

Në brezin e performancës së dobët janë tre shoqëri, përkatësisht UK Klos me 59.5%, UK Has me 58.7% dhe UK Pustec me 49.9% që e rendit këtë shoqëri në fund të klasifikimit.

Në nivelin e performancës së pranueshme (60-82%) janë 5 shoqëri duke filluar me UK Tropojë me NAK 73.9% e me radhe sipas grafikut deri te UK Finiq me 64.4%.

Tabela 22 paraqet ecurinë e treguesit të Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e III-të të shoqërive.

Tabela 22. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Poliçan	UK	79.00	99.70	+20.70
2	Konispol	UK	77.00	92.90	+15.90
3	Pustec	UK	38.00	49.90	+11.90
4	Pukë	UK	73.00	83.60	+10.60
5	Tropojë	UK	64.00	73.90	+9.90
6	Këlcyrë	UK	71.00	73.50	+2.50
7	Libohovë	UK	69.00	71.00	+2.00
8	Has	UK	59.00	58.70	-0.30
9	Fushë Arrëz	UK	82.00	68.10	-13.90

Siç tregohet në tabelën 19, në Grupin e III-të me përjashtim të UK Fushë Arrëz që për vitin 2019 ka shënuar rënie të treguesit në nivel shumë të lartë shoqëritë e tjera kanë përmirësim.

Përfundime

- Shoqëritë kanë raportuar për vitin 2019 të dhëna të ndara për secilin tregues. Gjithsesi edhe për këtë vit ekziston një marzh gabimi në lidhje me treguesin NAK pasi ka disa shoqëri që ende konsiderojnë dhe i raportojnë debitë e krijuara gjatë vitit, të cilat likuidohen nga klientët brenda vitit si shlyerje të debive të prapambetura.
- Referuar sektorit në tërësi, nga 57 shoqëri që kanë raportuar të dhëna rezultojnë 21 shoqëri në brezin e performancës së mirë (mbi 82%), 31 shoqëri në brezin e pranueshëm (60%-82%) dhe 5 shoqëri në nivelin e performancës së dobët (nën 60%).
- Për vitin 2019, vërehet se 62% ose (34 shoqëri) e shoqërive kanë progres, ndërsa 21 shoqëritë e tjera paraqiten me rënie të këtij treguesi.
- Norma Përgjithshme e Arkëtimit për vitin 2019 ka shënuar një rënie me 2.2%. Në sektor janë 24 shoqëri që raportojnë NAP mbi 100% që do të thotë se kanë performuar shumë mirë për arkëtimin e debive të vjetra duke krijuar mundësinë për shlyerjen e detyrimeve që kanë ndaj të tretëve.
- Një saktësim i mëtjeshëm dhe i tendencës së ecurisë për këto indikatorë është i nevojshëm për disa shoqëri që janë të reja, ose akoma nuk kanë përfunduar riorganizimin, vlerësimi i të cilave do të kryhet rast pas rasti.

2.3.5 Niveli i Matjes

Niveli i Matjes është raporti i lidhjeve me matës ndaj numrit total të lidhjeve i shprehur në përqindje. Treguesi “Niveli i Matjes” është një ndër treguesit që ka ruajtur trendin në përmirësim në vite për sektorin UK. Për vitin 2019 ky tregues është 77.3%, duke pësuar rritje në nivelin 3.3% krahasuar me vitin paraardhës. Me nivel të matjes 100%, për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, paraqitet vetëm UK Devoll, nd Ky tregues analizon vetëm lidhjet me matësa të kategorive të konsumatorëve dhe nuk pasqyron nivelin e matjes në sistemin e furnizimit me ujë.

rkohe nevoja për investime për të paisur të gjithë konsumatorët me matësa Ky tregues analizon vetëm lidhjet me matësa të kategorive të konsumatorëve dhe nuk pasqyron nivelin e matjes në sistemin e furnizimit me ujë është imediate.

Ka akoma konsumatorë që paguajnë për sasi uji pa matje (aforfe 150 litra/ditë, banor), që nuk është korrekte sepse shumica e konsumatorëve familjarë konsumojnë nën këtë normë të presupozuar, por edhe një pjesë e tyre konsumojnë shumë më tepër për ujitje (shtëpi private dhe zona rurale).

Faturimi aforfe shpesh herë stimulon mbi konsum të ujit duke cenuar cilësinë e shërbimit (orët e furnizimit dhe presionet) në zonat e mbuluara me shërbim, sidomos gjatë stinës së nxehtë. Pajisja 100% me ujëmatës në të gjithë konsumatorët individuale dhe me ujëmatësa të mëdhenj në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë është prioritet bazë i shoqërive UK që kërkon mbështetje financiare nga qeveria qendrore. Për vitin 2019, shoqëritë UK kanë raportuar instalimin e 47,543 ujëmatësave më shumë se vitin paraardhës, por sektori ende është larg objektivit për të pajisur 100% të konsumatorëve me matësa.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2019




Figura 11 . Niveli i Matjes Grupi I-rë, Viti 2019

Përfundimi i riorganizimit të shoqërive sipas reformës së re territoriale ka influencuar edhe në treguesin e nivelit të matjes, pasi ky tregues në zonat e reja të shtuara ishte në nivele mjaft të ulta. Në Grupin e I-rë asnjë shoqëri nuk raporton me nivel të matjes 100%. Nga 14 shoqëri, 13 prej tyre paraqesin trend në përmirësim ndërsa UK Kavajë (-23%) raporton rënie në nivele të larta.

Krahasuar me vitin 2018, përmirësim të dukshëm të treguesit raportojnë UK Vlorë (+11%), UK Sarandë (+10.6%), UK Fier (+8.6 %) dhe UK Kamëz (+8.3 %). Mbi nivelin e performancës së mirë prej 85%, performojnë shoqëritë UK Korçë 95%, UK Sarandë 94.6%, UK Lushnje 94.4%, UK Durrës 94.3%, UK Tiranë 88.2% dhe UK Pogradec 88%, shoqëritë e tjera performojnë nën kufirin e performancës së mirë.

Ecuria e nivelit të matjes për shoqëritë e Grupit të I-rë paraqitet e detajuar për dy vitet e fundit më poshtë në tabelën 20.

Tabela 23. Ecuria e Nivelit të Matjes Grupi I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Vlorë	UK	46.00	57.00	+11.00
2	Sarandë	UK	84.00	94.60	+10.60
3	Fier	UK	56.00	64.60	+8.60
4	Kamëz	UK	58.00	66.30	+8.30
5	Shkodër	UK	60.00	66.10	+6.10
6	Pogradec	UK	84.00	88.00	+4.00
7	Elbasan	UK	69.00	72.20	+3.20
8	Berat - Kuçovë	UK	71.00	73.50	+2.50
9	Tiranë	UK	86.00	88.20	+2.20
10	Lezhë	UK	83.00	84.50	+1.50
11	Lushnje	UK	93.00	94.40	+1.40
12	Durrës	UK	93.00	94.30	+1.30
13	Korçë	UK	94.00	95.00	+1.00
14	Kavajë	UK	54.00	31.00	-23.00

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2019




Figura 12. Niveli i Matjes Grupi II-të, viti 2019

Në Grupin e II-të të përbërë nga 32 shoqëri, mbi kufirin e performancës së mirë (mbi 85%) performojnë 11 shoqëri UK. Përmirësim të treguesit paraqesin UK Roskovec (+35.3%), UK Delvinë (+29.2%), UK Maliq (+17.4%), UK Përmet (+15.8%), UK Skrapar (+14.6%), UK Malësi e Madhe (+13.5%), UK Gramsh (12.7%), UK Kukës (+12.5%), UK Mirditë (+11.7%) etj.

Nivel të matjes 100% raporton vetëm UK Devoll, ndërsa me nivel të lartë të treguesit performojnë UK Librazhd 98.8%, UK Peqin 96.7%, UK Divjakë 96.5%, UK Roskovec 94.3% etj.

UK Dropull me nivel të matjes 18.8% raporton të dhënat për herë të parë.

Përkeqësim të treguesit paraqesin UK Himarë (-5%), UK Kolonjë (-3.4%), UK Belsh (-1.5%).

Në tabelën 24, si më poshtë paraqitet ecuria e këtij treguesi për Grupin e II-të sipas dy viteve të fundit.

Tabela 24. Ecuria e Nivelit të Matjes, Grupi II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Roskovec	UK	59.00	94.30	+35.30
2	Delvinë	UK	44.00	73.20	+29.20
3	Maliq	U	71.00	88.40	+17.40
4	Përmet	UK	76.00	91.80	+15.80
5	Skrapar	UK	27.00	41.60	+14.60
6	Malësi e Madhe	UK	48.00	61.50	+13.50
7	Gramsh	UK	67.00	79.70	+12.70
8	Kukës	UK	23.00	35.50	+12.50
9	Mirditë	UK	55.00	66.70	+11.70
10	Gjirokastrë	UK	46.00	54.40	+8.40
11	Patos	UK	32.00	38.10	+6.10
12	Mat	UK	57.00	62.60	+5.60
13	Ura Vajgurore	UK	89.00	94.00	+5.00
14	Dibër	UK	47.00	51.70	+4.70
15	Rrogozhinë	UK	90.00	94.10	+4.10
16	Kurbini	UK	19.00	22.60	+3.60
17	Krujë	U	70.00	73.60	+3.60
18	Vorë	UK	63.00	65.50	+2.50
19	Mallakastër	UK	62.00	64.50	+2.50
20	Bulqizë	UK	18.00	20.30	+2.30
21	Cërrik	UK	80.00	82.10	+2.10
22	Librazhd	UK	97.00	98.80	+1.80
23	Vau i Dejës	UK	70.00	71.70	+1.70
24	Peqin	UK	95.00	96.70	+1.70
25	Devoll	UK	99.00	100.00	+1.00
26	Divjakë	UK	96.00	96.50	+0.50
27	Tepelenë	UK	67.00	67.40	+0.40
28	Selenicë	UK	8.00	8.30	+0.30
29	Belsh	UK	88.00	86.50	-1.50
30	Kolonjë	UK	52.00	48.60	-3.40
31	Himarë	UK	97.00	92.00	-5.00
32	Dropull	U	0.00	18.80	n/a

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2019

Grupi 3 - Niveli i Matjes (%)




Figura 13. Niveli i Matjes Grupi III-të, Viti 2019

Në Grupin e III-të, të dhënat e raportuara tregojnë për tendencë përmirësimi të këtij treguesi nga të gjitha shoqëritë UK. Mbi nivelin e performancës së mirë performon vetëm UK Pustec. Përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi kanë shoqëritë UK Pustec (+28.7%), UK Këlcyrë (+26.8)% dhe UK Fushë Arrëz (+11.6%) etj. Shoqëritë UK Klos dhe UK Finiq raportojnë për herë të parë për vitin 2019.

Me nivelin më të ulët të treguesit performojnë shoqëritë UK Libohovë dhe UK Klos.

Krahasimi i të dhënave gjatë dy viteve të fundit tregon trendin në përmirësim të treguesit nga të gjitha shoqëritë e këtij grupi.

Të dhënat mbi ecurinë e Nivelit të Matjes gjatë dy viteve të fundit për këtë grup paraqitet në tabelën 25.

Tabela 25. Ecuria e Nivelit të Matjes për grupin e III-

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Pustec	UK	60.00	88.70	+28.70
2	Këlcyrë	UK	46.00	72.80	+26.80
3	Fushë Arrëz	UK	31.00	42.60	+11.60
4	Pukë	UK	55.00	58.80	+3.80
5	Poliçan	UK	64.00	67.50	+3.50
6	Has	UK	68.00	71.30	+3.30
7	Tropojë	UK	74.00	76.70	+2.70
8	Konispol	UK	96.00	97.70	+1.70
9	Libohovë	UK	1.00	1.90	+0.90
10	Finiq	UK	-	58.50	-
11	Klos	U	-	0.00	-

Përfundime

- Në rang sektori, niveli i matjes për vitin 2019 është 77.3%, që krahasuar me vitin 2018 ky tregues është përmirësuar me 3.3%. Me gjithë trendin në përmirësim, kërkohet më shumë angazhim nga shoqëritë për të përmbushur objektivin prej 85% të performancës së mirë të vendosur nga ERRU.
- Në total për të tre grupet, 19 shoqëri UK operojnë mbi nivelin e performancës së mirë të Benchmarking dhe vetëm UK Devoll ka nivelin e matjes 100% në sektor.
- Pjesa e konsumatorëve familjarë që faturohen aforfe me 150 litra/ditë, banor, nuk është korrekte pasi i mbifaturon shumicën prej tyre që konsumojnë nën këtë normë, si dhe një pjesë e tyre abuzojnë pasi kanë shtëpi private apo janë në zona rurale ku konsumi është realisht më i madh se faturimi për shkak të përdorimit prej tyre të ujit për ujitje.
- Prioritet i shoqërive UK duhet të jetë pajisja 100% me ujëmatës të mëdhenj në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë, por duhet konsideruar mundësia e financimit të tyre nga qeveria qendrore.
- Shoqëritë UK për vitin 2019 kanë raportuar instalimin e 43,467 ujëmatësave duke e çuar numrin e lidhjeve me matës në 685,376 lidhje nga 886,474 lidhje gjithsej.
- Konstatohen ritme të ulëta të instalimit të matësave krahasuar me vitin 2018. Më shumë matësa janë instaluar në Tiranë (9779), Vlorë (6710), Durrës (7328) dhe Fier (3313).
- Pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit mbetet një nga objektivat kryesorë të shoqërive, si një element që lehtëson mjaft problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve dhe të mbi konsumit në sisteme.

2.3.6 Efienca e Stafit

Kosto e personelit zë një përqindje të madhe të kostove O & M, rrjedhimisht treguesi i efiençës së stafit është tregues mjaft i rëndësishëm në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.

Efikasiteti i stafit nënkupton që shoqëritë të mos kenë njerëz në organikën e tyre që nuk justifikojnë pozicionin dhe intensitetin e punës që presupozohet të kryejnë. Sektori paraqitet i mbingarkuar me staf të pajustifikuar që në përgjithësi janë punësuar pa arsimin kualifikimin përkatës. Në mjaft raste kjo pjesë e stafit është jo vetëm jo efikase, por dekurajon edhe pjesën tjetër të stafit si shembull negativ i performancës në punë.

E veçanta e gjendjes së stafeve të shoqërive UK për vitin 2019 është se për shkak të marrjes në administrim të zonave rurale ka bërë që numri i stafit administrativ dhe operativ të rritet me rreth 336 punonjës. Duke patur parasysh që sektori gjatë vitit 2019 ka patur rritje të numrit të lidhjeve me 24 095 lidhje të reja ujësjellësi dhe 37 342 lidhje KUN, efikasiteti i stafit për 1000 lidhje UK për sektorin në vitin 2019 është ulur minimalisht nga 5,35 në vitin 2018 në 5.33 në vitin 2019.

Nisur nga specifikat e operimit dhe shërbimit të shoqërive si shtrirjen e shërbimit UK, numrin e sistemeve të furnizimit me ujë e të tjera arsye, ERRU ka vendosur nivel të diferencuar të objektivit të performancës së mirë për të tre grupet e shoqërive.

Performanca për Vitin 2019

Për Grupin e I-rë, ERRU ka përcaktuar si nivel të performancës shumë të mirë deri në 4 punonjës për 1000 lidhje, performancë të pranueshme 4-6 punonjës për 1000 lidhje, dhe mbi 6 punonjës për 1000 lidhje atë të performancës së dobët.

Figura 14 jep grafikisht Eficiencën e Stafit për Grupin e I-rë të shoqërive UK




Figura 14. Eficienca e Stafit për Grupin e I-rë, Viti 2019

Në këtë grup në zonën e performancës së mirë renditen tre shoqëritë UK Korçë me 2.26 staf për 1000 lidhje, UK Kamëz me 2.67 staf për 1000 lidhje, UK Sarandë 3.69 staf për 1000 lidhje dhe UK Tiranë me 3.82 staf për 1000 lidhje. Në brezin e performancës së pranueshme sipas grafikut paraqiten 7 shoqëri nga UK Vlorë me 4.37 staf për 1000 lidhje deri tek UK Lushnje me 5.84 staf për 1000 lidhje.

Në brezin e performancës së dobët janë 3 shoqëri dhe konkretisht UK Shkodër me 6.2 staf për 1000 lidhje, UK Fier me 6.26 staf për 1000 lidhje dhe UK Kavajë me 6.86 staf për 1000 lidhje.

Tabela 26 paraqet ecurinë e treguesit të Eficiencës së Stafit për Grupin e I-rë të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela 26. Ecuria e Efijencës së Stafit për Grupin e I-

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 nr.	2019 nr.	Diferenca 2019-2018 staf/1000 lidhje
1	Kavajë	UK	8.14	6.86	-1.28
2	Lushnje	UK	6.63	5.84	-0.79
3	Shkodër	UK	6.56	6.20	-0.36
4	Sarandë	UK	5.14	4.82	-0.32
5	Vlorë	UK	4.38	4.37	-0.01
6	Tiranë	UK	3.81	3.82	+0.01
7	Elbasan	UK	4.58	4.59	+0.01
8	Lezhë	UK	4.47	4.48	+0.01
9	Berat - Kuçovë	UK	4.85	4.88	+0.03
10	Korçë	UK	2.18	2.26	+0.08
11	Fier	UK	6.15	6.26	+0.11
12	Durrës	UK	5.08	5.33	+0.25
13	Pogradec	UK	5.24	5.57	+0.33
14	Kamëz	UK	2.27	2.67	+0.40

Tendencën pozitive më të mirë në Grupin e I-rë e ka pasur UK Kavaja, UK Lushnje, UK Shkodër dhe UK Saranda ku numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur përkatësisht me (1.28), (0.79), (0.36) dhe (0.32) punonjës për 1000 lidhje.

Shoqëria UK Kavajë ka ecurinë më të mirë duke ulur treguesin staf për 1000 lidhje me (1.28) si rezultat i rritjes të numrit të lidhjeve me 1877 Ujë dhe 11846 lidhje KUN, për shkak të marrjes së zonave të reja me shërbim KUN.

Përmirësimi për shoqërinë UK Lushnje ka ardhur për faktin se si numri i stafit dhe ai i lidhjeve kanë pasur tendencë pozitive ku stafi është zvogëluar me 15 punonjës dhe lidhjet UK janë shtuar me 1849 lidhje. Për UK Shkodër stafi është zvogëluar me (3) punonjës dhe janë shtuar lidhjet me 2571 lidhje UK.

Shoqëritë e tjera të grupit të I-rë, referuar tabelës 26, duke filluar nga UK Vlorë deri tek UK Fier kanë tendencë negative dhe pozitive të papërfillshme.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2019

Për Grupin e II-të, niveli i objektivit për performancë të pranueshme të vendosur nga ERRU është 6-10 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 10 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 6 staf për 1000 lidhje.

Figura 15 jep grafikisht Efijencën e Stafit për Grupin e II-të të shoqërive UK

Grupi 2 - Efienca e Stafit (staf / 1000 lidhje)




Figura 15. Efienca e Stafit për Grupin e II-të, viti 2019

Në këtë grup në nivelin e performancës së mirë bëjnë pjesë UK Librazhd me një përmirësim 0.86, UK Kolonjë me një përmirësim prej 0.30, UK Devoll e cila megjithëse ka një përkeqësim të këtij treguesi me 0.35 përsëri mbetet në nivelin e performancës së mirë me 5.54 staf për 1000 lidhje si dhe UK Maliq me një përmirësim prej 0.38 dhe UK Dropull me një përmirësim prej 0.59 staf për 1000 lidhje.

Në nivelin e pranueshëm të këtij treguesi janë 14 shoqëri duke filluar nga UK Kukës deri tek UK Tepelenë që variojnë brenda kufirit prej 6.13 deri 9.97 staf për 1000 lidhje.

Këtë vit është marrë në analizë edhe shoqëria UK Dropull pasi raporton për të dytin vit radhazi dhe ka një përmirësim me 0.59 staf për 1000 lidhje. UK Delvinë ka kaluar nga grupi 3-të në Grupin e II-të me një ndryshim +0.46 staf për 1000 lidhje.

Në zonën e kuqe, atë të performancës së dobët mbi 10 staf për 1000 lidhje renditen 12 shoqëri. Për të dytin vit radhazi performuesi më i dobët në këtë grup është UK Peqin me tregues 23.15, duke vijuar me UK Mallakastër me 15.24, UK Përmet me 14.06, si dhe UK Patos, UK Malësi e Madhe, UK Roskovec e deri tek UK Belsh me 10.04 staf për 1000 lidhje UK.

Tabela 27 paraqet ecurinë e treguesit të Efiençës së Stafit për Grupin e II-të të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela 27. Ecuria e Efijencës së Stafit për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 nr.	2019 nr.	Diferenca 2019-2018 staf/1000 lidhje
1	Vau i Dejës	UK	10.82	7.58	-3.24
2	Kurbin	U	11.49	8.33	-3.16
3	Kukës	UK	8.19	6.13	-2.06
4	Gjirokastër	UK	11.07	9.03	-2.04
5	Ura Vajgurore	UK	11.27	10.16	-1.11
6	Librazhd	UK	6.06	5.20	-0.86
7	Divjakë	UK	12.58	11.84	-0.74
8	Malësi e Madhe	UK	13.11	12.51	-0.60
9	Dropull	UK	6.58	5.99	-0.59
10	Maliq	UK	6.06	5.68	-0.38
11	Himarë	UK	7.35	6.99	-0.36
12	Mallakastër	UK	15.59	15.24	-0.35
13	Kolonjë	UK	5.83	5.53	-0.30
14	Peqin	UK	23.16	23.15	-0.01
15	Bulqizë	UK	9.99	10.00	+0.01
16	Gramsh	UK	8.84	8.89	+0.05
17	Cërrik	UK	7.4	7.49	+0.09
18	Mirditë	UK	11.77	11.86	+0.09
19	Patos	UK	12.43	12.55	+0.12
20	Dibër	UK	7.06	7.20	+0.14
21	Rrogozhinë	UK	7.87	8.13	+0.26
22	Devoll	UK	5.19	5.54	+0.35
23	Delvinë	UK	6.21	6.67	+0.46
24	Selenicë	U	10.94	11.40	+0.46
25	Belsh	UK	9.10	10.04	+0.94
26	Mat	UK	6.45	7.44	+0.99
27	Skrapar	UK	8.24	9.28	+1.04
28	Përmet	U	12.99	14.06	+1.07
29	Tepelenë	UK	8.43	9.97	+1.54
30	Vorë	UK	8.96	10.64	+1.68
31	Krujë	UK	6.39	8.28	+1.89
32	Roskovec	UK	8.84	12.04	+3.20

Në grupin e dytë përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi kanë UK Vau Dejës (3.24), U Kurbin (3.16), Si dhe UK Kukës, UK Gjirokastër dhe UK Ura Vajgurore me nivele më të ulëta. Tendencë përmirësimi, por në nivelin nën 1 punonjës që është përcaktimi që ERRU e konsideron pozitiv, kanë dhe 9 shoqëri duke filluar nga UK Ura Vajgurore deri te UK Peqin.

Tendencë negative në nivele të larta kanë patur 6 shoqëri duke filluar nga UK Roskovec që ka përkeqësimin më të madh në grup (3.2) duke vijuar me shoqëritë e tjera deri te UK Skrapar me (1.04)

Janë 12 shoqëri duke filluar nga UK Bulqizë deri te UK Mat që kanë shënuar përkeqësim në nivele të ulëta ,por gjithsesi është përkeqësim.

Performanca për Vitin 2019

Për Grupin e III-të niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të pranueshme është 10-15 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 15 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 10 punonjës për 1000 lidhje.

Figura 16 jep grafikisht Eficiencën e Stafit për Grupin e III-të të shoqërive UK




Figura 16. Eficienca e Stafit për Grupin e III-të, Viti 2019

Në Grupin e III-të, 8 nga 11 shoqëri kanë më shumë se 10 punonjës për 1000 lidhje. Performuesi më i mirë është UK Poliçan me 7.95 punonjës për 1000 lidhje, por që ka një rritje të numrit të punonjësve.

Në nivelin e performancës së mirë renditen gjithashtu edhe shoqëritë UK Fushë-Arrëz me 8.96 dhe UK Pukë me 9.90 punonjës për 1000 lidhje.

Në brezin e performancës së pranueshme, pra në nivelin 10-15 punonjës janë 5 shoqëri, respektivisht, UK Tropojë, UK Pustec, UK Libohovë, UK Konispol dhe UK Finiq e cila raporton për herë të parë këtë vit.

Me performancë të dobët, të renditura mbi vijën e kuqe, janë 3 shoqëri UK Has, UK Klos e cila raporton për herë të parë këtë vit si dhe UK Këlcyrë e cila renditet e fundit me (19.93) punonjës për 1000 lidhje. Shoqëria UK Has megjithëse ka një tendencë përmirësimi me 3.96 punonjës për 1000 lidhje përsëri mbetet në brezin e performancës së dobët me 15.48 punonjës për 1000 lidhje.

Tabela 28 paraqet ecurinë e treguesit të Eficiencës së Stafit për Grupin e III-të të shoqërive për dy vitet e fundit. punonjës janë 3 shoqëri, respektivisht,

Tabela 28. Ecuria e Efijencës së Stafit për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 nr.	2019 nr.	Diferenca 2018-2017 staf/1000 lidhje
1	Has	UK	19.44	15.48	-3.96
2	Libohovë	UK	14.09	11.90	-2.19
3	Këlcyrë	UK	20.55	19.93	-0.62
4	Konispol	UK	12.99	12.43	-0.56
5	Fushë Arrëz	UK	9.16	8.96	-0.20
6	Pukë	UK	9.84	9.90	+0.06
7	Poliçan	UK	7.88	7.95	+0.07
8	Tropojë	UK	10.42	10.68	+0.26
9	Pustec	UK	8.85	11.89	+3.04
10	Finiq	UK		13.25	
11	Klos	U		16.36	

Shoqëria UK Has megjithëse ka një tendencë përmirësimi me 3.96 punonjës për 1000 lidhje përsëri mbetet në brezin e performancës së dobët me 15.48 punonjës për 1000 lidhje. Ndryshim pozitiv të ndjeshëm ka patur edhe UK Libohovë me (2.19) punonjës për 1000 lidhje.

Nga 9 shoqëritë krahasimore tendencën negative më të madhe e ka UK Pustec me +3.04. Shoqëritë e tjera nga UK Këlcyrë deri te UK Tropojë kanë luhatje pozitive/negative nën nivelin e përcaktuar nga ERRU si kriter përmirësimi apo përkeqësimi.

Gjithsesi vlerësimi i performancës për të tre grupet e këtij treguesi duhet të realizohet rast pas rasti në funksion të karakteristikave dhe numrit të sistemeve të furnizimit me ujë brenda zonës së shërbimit të shoqërisë. Është i njohur fakti që ky tregues influencohet mjaft nga numri i personelit roje të cilin shoqëria është e detyruar ta zbatojë për të garantuar sigurinë në këto objekte që konsiderohen të rëndësishë së veçantë. Kjo influencë është më e dukshme në shoqëritë e vogla që i përkasin Grupit të III-të.

Përfundime

- Në vitin 2019, treguesi staf për 1000 lidhje ka pësuar përmirësim të lehtë me vitin paraardhës.
- Numri i lidhjeve UK është rritur me rreth 24 095 lidhje uji dhe 37 342 Lidhje, nga ana tjetër rritja e numrit të punonjësve me 336 ka amortizuar efektin pozitiv të rritjes së lidhjeve UK.
- Rritja e numrit të punonjësve justifikohet në pjesën më të madhe të tyre nga zhvillimet në sektor, riorganizimi i shoqërive dhe zgjerimi i zonës së shërbimit.
- Rritja e numrit të punonjësve është e lidhur direkt me kostot e punës. Në kuadër të objektivit të përgjithshëm strategjik të sektorit për të arritur qëndrueshmëri financiare përmes përmirësimeve në mbulimin e kostove, përmirësimi i efijencës së stafit është jo vetëm një element thelbësor i përmirësimit të efijencës operacionale, por ndikon edhe në reduktimin e kostove të punës.
- Rritja e kapaciteteve profesionale, tërheqja dhe motivimi i profesionistëve të trajnuar dhe transferimi efikas i njohurive teknike do të kishte efekt të drejtpërdrejtë në mirëfunksionimin dhe zhvillimin e shoqërive.

- ERRU, në mënyrë të vazhdueshme i kushton kujdes të veçantë shqyrtimit të organogramës së stafit të shoqërive UK kur ato paraqesin aplikime për tarifa të reja në mënyrë që ato të jenë të justifikuara në numër punonjësish, pozicione dhe përshkrime të punës për secilin prej tyre.

2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë është një nga treguesit më të rëndësishëm cilësisë së shërbimit. Për vlerësimin e këtij treguesi përdoret mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë, e cila për vitin 2019 është 13.13 orë/ditë, me një rritje 0.33 orë/ditë krahasuar me vitin paraardhës. Objektivi i performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë në ditë ende është larg për tu arritur nga shumë shoqëri.

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë lidhet me aftësinë e shoqërisë për të mbajtur rrjetin e shpërndarjes nën një presion të caktuar shërbimi në mënyrë që t'u japë konsumatorëve të saj shërbimin në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje. Faktori kryesor i vazhdimësi të ulët të furnizimit me ujë janë mbikonsumi nga humbjet e ujit teknike dhe administrative.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2019

Grupi 1 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 17. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për Grupin e I-rë, Viti 2019

Në Grupin e I-rë të shoqërive, vetëm pesë prej tyre arrijnë të furnizojnë konsumatorët me mbi 18 orë/ditë që është dhe kufiri i performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Përmirësim të treguesit raportojnë shoqëritë UK Tiranë (+3.2 orë/ditë), UK Durrës (+3.22 orë/ditë), UK Sarandë (+3 orë/ditë), UK Fier (+2.3 orë/ditë) etj. Shoqëria UK Korçë është e vetmja që dhe pas reformës territoriale arrin të furnizojë me ujë 24 orë/ditë të gjithë zonën e shërbimit.

Gjatë vitit 2019, orët e furnizimit janë reduktuar dukshëm nga shoqëritë UK Lushnje (-2.4 orë/ditë), UK Berat - Kuçovë (-2.3 orë/ditë), UK Vlorë (-2.2 orë/ditë) dhe UK Kavajë (-2 orë/ditë).

Ecuria e këtij treguesi për Grupin e I-rë të shoqërive për dy vitet e fundit paraqitet në tabelën 29.

Tabela 29. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Durrës	UK	5.08	8.30	+3.22
2	Tiranë	UK	10.10	13.30	+3.20
3	Sarandë	UK	9.00	12.00	+3.00
4	Fier	UK	19.70	22.00	+2.30
5	Pogradec	UK	21.00	21.60	+0.60
6	Korçë	UK	23.50	24.00	+0.50
7	Elbasan	UK	11.50	12.00	+0.50
8	Shkodër	UK	20.40	20.80	+0.40
9	Kamëz	UK	4	4	+0.00
10	Lezhë	UK	21.3	21	-0.30
11	Kavajë	UK	6.00	4.00	-2.00
12	Vlorë	UK	12.30	10.10	-2.20
13	Berat - Kuçovë	UK	14.30	12.00	-2.30
14	Lushnje	UK	7.4	5	-2.40

Shoqëritë e Grupit të I-rë arrijnë të mbulojnë me shërbim pjesën më të madhe të popullsisë në vend, ndaj dhe prioriteti për përmirësimin e nivelit të shërbimit duhet të jetë në vëmendje nga të gjitha shoqëritë. Shoqëria me performancë më të dobët është UK Kamëz me kohëzgjatjen e furnizimit me ujë 4 orë/ditë.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2019

Grupi 2 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 18. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për Grupin e II-të, Viti 2019

Në Grupin e II-të të përbërë nga 32 shoqëri, vetëm 4 prej tyre si rezultat i investimeve fizike nga AKUM-i arrijnë të furnizojnë me ujë 24 orë/ditë, përkatësisht qendrat urbane (qytetet) Tepelenë, Memaliaj, Përmet dhe Cërrik

Mbi kufirin e performancës së mirë, me furnizim me ujë mbi 18 orë/ditë, performojnë 9 shoqëri UK, ndërsa për 8 shoqëri, niveli i këtij treguesi është nën kufirin e performancës së dobët (8 orë/ditë). UK Roskovec dhe UK Kurbin, me 4 orë furnizimi me ujë në ditë, janë performuesit më të dobët në grup.

Gjatë vitit 2019 orët e furnizimit janë rritur ndjeshëm për shoqëritë UK Përmet (+6.6 orë/ditë), UK Peqin (+6.1 orë/ditë), UK Bulqizë (+5.9 orë/ditë), UK Kolonjë (+5.9 orë/ditë), UK Cërrik (+4.8 orë/ditë), UK Dibër (+4 orë/ditë), UK Belsh (+3.9 orë/ditë), UK Skrapar (+3.6 orë/ditë) etj. Orët e furnizimit kanë pësuar rënie për shoqëritë UK Himarë (-5.1 orë/ditë), UK Gjirokastër (-4.30 orë/ditë), UK Mat (-3.3 orë/ditë), UK Vau i Dejës (-1.9 orë/ditë) etj.

Ecuria e shoqërive në Grupin e II-të për dy vitet e fundit pasqyrohet në tabelën 30.

Tabela 30. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Përmet	U	17.40	24.00	+6.60
2	Peqin	UK	13.90	20.00	+6.10
3	Bulqizë	U	13.10	19.00	+5.90
4	Kolonje	UK	12.10	18.00	+5.90
5	Cërrik	UK	17.20	22.00	+4.80
6	Dibër	UK	8	12.00	+4.00
7	Belsh	UK	11.10	15.00	+3.90
8	Skrapar	UK	8.4	12.00	+3.60
9	Ura Vajgurore	UK	6.60	10.00	+3.40
10	Malësi e Madhe	UK	8.80	12.00	+3.20
11	Divjakë	UK	3.4	6	+2.60
12	Maliq	UK	11.70	14.00	+2.30
13	Vorë	UK	5.30	7.50	+2.20
14	Delvinë	UK	7.00	9.00	+2.00
15	Devoll	UK	20.1	22	+1.90
16	Gramsh	U	22.50	24.00	+1.50
17	Dropull	UK	4.60	5.50	+0.90
18	Roskovec	UK	3.40	4.00	+0.60
19	Kukës	UK	8.10	8.50	+0.40
20	Librazhd	UK	23.70	24.00	+0.30
21	Selenicë	U	6.20	6.50	+0.30
22	Kurbin	UK	3.70	4.00	+0.30
23	Tepelenë	UK	24.00	24.00	+0.00
24	Rrogozhinë	UK	9.20	9.00	-0.20
25	Patos	UK	8.30	8.00	-0.30
26	Mirditë	UK	15.60	15.00	-0.60
27	Krujë	UK	6.60	6.00	-0.60
28	Mallakastër	UK	7.4	6	-1.40
29	Vau i Dejës	UK	10.90	9.00	-1.90
30	Mat	UK	19.30	16.00	-3.30
31	Gjirokastër	UK	17.30	13.00	-4.30
32	Himarë	UK	19.10	14.00	-5.10

Grupi 3 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 19. Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë për Grupin e III-të, Viti 2019

Në Grupin e III-të të përbërë nga 11 shoqëri, 6 prej tyre arrijnë të kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë mbi kufirin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Furnizimin me ujë 24 orë/ditë e ofrojnë shoqëritë UK Poliçan, UK Fushë Arrëz, UK Pukë dhe UK Këlcyre. Me investimet e kryera në sistemin e furnizimit me ujë, shoqëria UK Këlcyre ka përmirësuar ndjeshëm treguesin pasi ka rritur kohëzgjatjen e furnizimit me +18.4 orë/ditë.

Nën nivelin e performancës së dobët (8 orë/ditë) performojnë UK Has, UK Pustec, UK Finiq dhe UK Klos. Përkeqësim të treguesit paraqesin UK Libohovë (-3.1 orë/ditë), UK Konispol (-2.3 orë/ditë) dhe UK Tropojë (-0.5 orë/ditë).

Në tabelën 31 të mëposhtme është paraqitur ecuria e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë për Grupin e III-të të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela 31. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Këlcyre	UK	5.60	24.00	+18.40
2	Poliçan	UK	15.30	24.00	+8.70
3	Pukë	UK	21.90	24.00	+2.10
4	Fushë Arrëz	UK	23.30	24.00	+0.70
5	Has	UK	7.70	8.00	+0.30
6	Pustec	UK	8.1	8	+0.10
7	Tropojë	UK	22.50	22.00	-0.50
8	Konispol	UK	22.30	20.00	-2.30
9	Libohovë	UK	16.10	13.00	-3.10
10	Finiq	UK		6.00	
11	Klos	U		4.00	

Përfundime

- Gjatë vitit 2019 konsumatorët janë furnizuar mesatarisht 13.13 orë/ditë. Krahasuar me vitin paraardhës treguesi është përmirësuar në nivel të ulët (+0.3 orë/ditë) duke qëndruar ende larg realizimit të objektivit të performancës së mirë përcaktuar nga ERRU 18 orë/ ditë. Shoqëritë ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë varion nga 4-24 orë/ditë.
- Nga 57 shoqëri që operojnë në sektor, 9 prej tyre ofrojnë furnizim të pandërprerë dhe me presionin e duhur, ndërkohë performojnë mbi kufirin e performancës së mirë (18 orë/ditë) 20 shoqëri UK.

2.3.8 Mbulimi me Kanalizime

Treguesi i Mbulimit me Kanalizime është raporti i popullsisë që i ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe i largimit të ujërave të ndotura me popullsinë që jeton në zonën e juridiksionit të një shoqërie UK. Shoqëritë të cilat ofrojnë këtë shërbim, arrijnë të mbulojnë në nivel kombëtar mesatarisht 51 % të popullsisë nga 52.2 % e raportuar në vitin 2018. Shihet se ky tregues ka rënie në më shumë se 50 % të shoqërive që raportojnë.

Si pasojë e reformës territoriale numri i shoqërive të cilat kryejnë shërbimet e KUN është rritur, ndërsa pjesa tjetër e shoqërive është në proces të licensimit për kategorinë për largimin e ujërave të ndotura. Rritja e këtij treguesi kërkon investime mjaft të mëdha në këtë sektor.

Nga ana tjetër, që shërbimi me kanalizime të jetë më cilësorë nevojitet që shoqëritë UK të kenë impiante të trajtimit të ujërave të ndotur. Për vitin 2019 treguesi i mbulimit me ITUN nga tetë impiantet ekzistuese është rritur me 0.6 % krahasuar me vitin 2018 duke çuar këtë tregues në 12 %. Domosdoshmëri për ndërtim të impianteve të reja dhe vënia në punë me kapacitet të plotë e impianteve të ndërtuara do të rrisë ndjeshëm cilësinë e këtij shërbimi duke krijuar njëkohësisht mbrojtje më të madhe të mjedisit.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Në Grupin e I-rë të shoqërive, mbi kufirin 75% të performancës së mirë performojnë vetëm 2 shoqëri, UK Kamëz (100 %) dhe UK Tiranë (90.5 %), prej të cilave UK Kamëz vazhdon të bëjë raportim të pasaktë, kështu që mbetet vetëm UK Tiranë të jetë mbi këtë nivel. Në vitin 2018 mbi këtë kufi ka qenë dhe UK Sarandë, por që për vitin 2019 ka një rënie prej 16 % duke bërë që treguesi i mbulimit me kanalizime për këtë shoqëri të arrijë në nivelin 74 %.

Shoqëri të tjera që performojnë dobët dhe vazhdojnë të jenë dhe për këtë vit me mbulimin me kanalizime nën 50 % janë UK Pogradec me 49.1 %, UK Shkodër 44.1%, UK Fier me 38.3 %, dhe UK Lushnje 33 %.

Në këtë grup rënien më të lartë të treguesit e kanë raportuar UK Sarandë (-16 %) duke çuar mbulimin me kanalizime në nivelin prej 74 %, UK Korçë (-9.7 %) duke çuar mbulimin me kanalizime në nivelin prej 65.3 % dhe UK Berat- Kuçovë (-8.8 %) duke e çuar mbulimin në 54.2%.

Grupi 1 - Mbulimi me Kanalizime (%)




Figura 20. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e I-rë, Viti 2019

Shoqëria me ecuri më të mirë në këtë grup raportohet vetëm UK Kavajë me një rritje të mbulimit me kanalizime (+28.1 %) duke çuar këtë tregues në 62.1 %. Trajtimi i ujërave të ndotura në këtë grup bëhet nga shoqëritë e licencuara UK Durrës, UK Pogradec, UK Korçë dhe UK Shkodër.

Tabela 32 .Ecuria e mbulimit me kanalizime për Grupin I-të 2019

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Kavajë	UK	34.00	62.10	+28.10
2	Tiranë	UK	89.00	90.50	+1.50
3	Shkodër	UK	43.00	44.10	+1.10
4	Lushnje	UK	32.00	33.00	+1.00
5	Fier	UK	38	38.3	+0.30
6	Kamëz	UK	100	100	+0.00
7	Durrës	UK	53.00	52.60	-0.40
8	Vlorë	UK	60.00	58.40	-1.60
9	Elbasan	UK	63.00	60.70	-2.30
10	Lezhë	UK	64	59.2	-4.80
11	Pogradec	UK	54.00	49.10	-4.90
12	Berat - Kuçovë	UK	63.00	54.20	-8.80
13	Korçë	UK	75.00	65.30	-9.70
14	Sarandë	UK	90.00	74.00	-16.00

Grupi i II-të i Shoqërive

Në Grupin e II-të janë 32 shoqëri nga të cilat vetëm 24 prej tyre kanë raportuar për këtë të dhënë.

UK Vau – Dejës nuk do të merret në analizë për këtë tregues pasi ka raportuar për herë të parë këtë vit. Ky grup ka pasur përkeqësim të këtij treguesi, ku përveç UK Kolonjë me 81.6 % dhe UK Dibër me 80.6 % dhe që ndodhen mbi kufirin 75% të nivelit të performancës së mirë, shoqëritë e tjera të këtij grupi janë të gjitha nën nivelin 48 %.

Duke krahasuar vitin 2019 me vitin 2018, rënie të theksuar të treguesit mbulimi me kanalizime kanë raportuar 5 shoqëri, UK Tepelenë (-46.9 %) duke bërë që ky tregues të shkojë në nivelin 39.10 %, UK Mat (-19.1 %) duke bërë që ky tregues të shkojë në nivelin 45.9 %, UK Ura Vajgurore (-12.3 %) duke bërë që ky tregues të shkojë në nivelin 12.7 %, UK Himarë (-9 %) duke bërë që ky tregues të shkojë në nivelin 15 % dhe UK Gjirokastrë (-7.5 %) duke bërë që ky tregues të shkojë në nivelin 39.5 %. Përsa i përket shoqërive të tjera kanë një rënie të lehtë nën 2.3 %. Ndërsa 3 shoqëritë UK Kurbin, UK Dropull dhe UK Rrogozhinë kanë të njëjtin nivel të mbulimit me kanalizime si në vitin 2018.

Performanca për vitin 2019

Grupi 2 - Mbulimi me Kanalizime (%)




Figura 21. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e II-të, Viti 2019

Ky grup në përgjithësi ka performuar dobët pasi rritje të mbulimit me kanalizime ka raportuar vetëm UK Dibër (+39.6 %) duke çuar mbulimin me kanalizime në 80.6 %, pra mbi nivelin e performancës së mirë prej 75%. Pesë shoqëri kanë rritje të lehtë nga (+1.7 %) deri në (+5.5 %).

Tabela 33. Ecuria e Mbulimit me Kanalizime për Grupin II-të 2019

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Dibër	UK	41	80.6	+39.60
2	Skrapar	UK	40	45.5	+5.50
3	Vorë	UK	44	48.4	+4.40
4	Belsh	UK	10	13.9	+3.90
5	Kukës	UK	38.00	41.70	+3.70
6	Patos	UK	36	37.7	+1.70
7	Kurbin	UK	37.00	37.00	+0.00
8	Rrogozhinë	UK	8	8	+0.00
9	Dropull	UK	1	1	+0.00
10	Maliq	UK	24	23.9	-0.10
11	Librazhd	UK	21	20.9	-0.10
12	Mirditë	UK	40.00	39.80	-0.20
13	Cërrik	UK	27	26.6	-0.40
14	Kolonje	UK	82.00	81.60	-0.40
15	Roskovec	UK	17	16.5	-0.50
16	Mallakastër	UK	22	21.4	-0.60
17	Delvinë	UK	39.00	38.10	-0.90
18	Krujë	UK	28.00	25.70	-2.30
19	Gjirokastër	UK	47.00	39.50	-7.50
20	Himarë	UK	24	15	-9.00
21	Ura Vajgurore	UK	25.00	12.70	-12.30
22	Mat	UK	65.00	45.90	-19.10
23	Tepelenë	UK	86.00	39.10	-46.90
24	Vau i Dejës	UK		2.4	
25	Malësi e Madhe	UK			
26	Divjakë	U			
27	Gramsh	U			
28	Përmet	UK			
29	Devoll	U			
30	Selenicë	UK			
31	Peqin	UK			
32	Bulqizë	U			

Grupi i III-të i Shoqërive

Në Grupin e III-të vetëm 5 shoqëri kanë raportuar të dhëna për shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura nga 11 në total.

Nga 5 shoqëritë që merren në analizë shihet se asnjë nga shoqëritë nuk kalon mbi nivelin e performancës së mirë mbi 75 %. UK Poliçan ka mbulim 67.8 % ndërsa 4 shoqëritë e tjera përformojnë nën kufirin e dobët me 50 %.

Grupi 3 - Mbulimi me Kanalizime (%)




Figura 22 . Mbulimi me Kanalizime për Grupin e III-të, Viti 2019

Rënie të këtij treguesi kanë paraqitur 2 shoqëri, UK Tropojë (-19.30 %) duke bërë që ky tregues të zbresë në 24.7 % si dhe UK Poliçan (-12.2 %) duke bërë që mbulimi me kanalizime të bjerë në 67.8 %.

Tendencë në përmirësim të këtij treguesi ka vetëm UK Pukë (+9.1 %), por që sërish mbetet në nivel shumë të ulët të mbulimit me kanalizime prej 25.1%.

Ndërsa dy shoqëritë e tjera UK Fushë - Arrëz dhe UK Pustec kanë rritje shumë të vogël me (+1.5%) dhe (+1 %) të këtij treguesi.

Tabela 34. Ecuria e Mbulimi me Kanalizime për Grupin e III-të, Viti 2019

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2018 (%)	2019 (%)	Diferenca 2019-2018 (%)
1	Pukë	UK	16	25.1	+9.10
2	Fushë Arrëz	UK	33	34.5	+1.50
3	Pustec	UK	23	24	+1.00
4	Poliçan	UK	80.00	67.80	-12.20
5	Tropojë	UK	44.00	24.70	-19.30
6	Has	UK			
7	Këlcyrë	UK			
8	Libohovë	UK			
9	Finiq	UK			
10	Klos	U			
11	Konispol	UK			

Përfundime

- Treguesi i mbulimit me kanalizime është ndër treguesit që ka pësuar rënie pothuajse për të gjitha shoqëritë. Për vitin 2018 për të tre grupet rezultoi që nga 7 shoqëri që arrinin të mbulonin me shërbim mbi 75 % të popullsisë në zonën e juridiksionit, në vitin 2019 janë vetëm 3 shoqëri të tilla, përkatësisht, UK Tiranë, UK Kolonjë dhe UK Dibër.
- UK Vau-Dejës ka raportim për herë të parë për mbulimin me kanalizime për vitin 2019. Nëntë shoqëri performojnë midis nivelit më të dobët 50 % dhe nivelit të mirë 75 %, ndërsa shoqëritë e tjera arrijnë të mbulojnë me shërbim një përqindje të ulët të popullsisë në juridiksion. Përqindja me mbulim në rang vendi për këtë vit është 51 % me një rënie prej 1 % nga viti 2018.
- Nga 51 % mbulim me shërbim të kanalizimeve në rang vendi, shihet që 45 % ju ofrohet shërbim zonave urbane dhe vetëm 6 % është për zonat rurale. Trajtimi i ujërave të ndotura kryhet nga 8 shoqëri UK Durrës, UK Kavajë, UK Korçë, UK Pogradec, UK Shkodër, UK Sarandë, UK Vlorë (Impianti i Orikumit) dhe UK Lezhë, por nga këto 8 shoqëri me licencë nga ERRU ka arritur të pajisen vetëm 4 shoqëri (UK Durrës, UK Korçë, UK Pogradec dhe UK Shkodër) pasi shoqëritë e tjera nuk kanë mundur të pajisen me lejen mjedisore gjë që ka sjellë pengesë në marrjen e kategorisë D për këto shoqëri.
- Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve duhet të jetë një nga sfidat kryesore për të gjitha shoqëritë UK të cilat gjatë hartimit të planeve të biznesit, krahas investimeve për mbulimin me ujë, duhet të planifikojnë edhe investime dhe të vendosin objektiva për rritjen e këtij treguesi pasi shihet një rënie për të gjitha shoqëritë.

3 Konkluzione dhe Rekomandime

- Kërkohet një angazhim më serioz nga Bashkitë dhe shoqëritë përkatëse UK për të përfunduar procesin e licencimit pasi akoma janë 20 shoqëri të pa licencuara nga ERRU në përputhje me reformën e riorganizimit të shoqërive.
- Shoqëritë duhet të kenë në vëmendje të tyre mirë menaxhimin e aseteve duke hartuar dhe zbatuar Planet e Menaxhimit të Aseteve që mundësojnë një planifikim më efikas të investimeve në sektor dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve për konsumatorët.
- Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura mbetet problem serioz për mjaft shoqëri UK. Shoqëritë e dobëta financiarisht duhet të mbështeten nga qeveria qendrore për instalimin e matësave të ujit në burim dhe konsumatorët familjarë në mënyrë që të hartohen bilancet e ujit të sakta si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Duhet të rritet përgjegjshmëria nga stafet drejtuese të shoqërive në drejtim të saktësisë të raportimit të të dhënave në ERRU në mënyrë që të disponohet një bazë e saktë dhe e besueshme e të dhënave për vlerësimin dhe monitorimin e sektorit.
- Duke pasur parasysh rëndësinë e Planeve të Biznesit 5 Vjeçare për shoqëritë UK, të nxitet nga ERRU hartimi tyre si një kërkesë e detyrueshme e metodologjisë së tarifave që do të aprovohet së shpejti. AKUM të vlerësojë nevojat dhe të nxisë financimin e hartimit të tyre nga qeveria qendrore dhe donatorët, në veçanti për shoqëritë që kanë mundësi financiare të kufizuara.
- Të analizohen thellësisht elementët bazë të qasjes së re si strategji për agregimin e sektorit në aspektet praktiko-ligjore të ngritjes dhe veprimtarisë së Operatorit të Alternativës së Fundit dhe Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta, si dhe të rekomandimit për agregimin e sektorit me disa shembuj agregimi të suksesshëm.
- ERRU rekomandohet të përfshihet në procesin e përcaktimit të prioriteteve të investimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve.
- Të përditësohet Master Plani Kombëtar i Sektorit të UK për të përfshirë në të nevojat për investime edhe të zonave të reja rurale që më parë kanë qenë jashtë zonës së shërbimit të shoqërive UK dhe ndryshimet të cilat duhet të reflektohen edhe në draftin e Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve.

4 Tema e Veçantë (Studim i ERRU-së Tetor 2019)

Përballueshmëria e Pagesës së Faturës së Ujit (Affordabiliteti)

Të Përgjithshme

Referuar Metodologjisë së vendosjes së tarifave, ERRU i mbështet politikat tarifore për konsumatorët në katër kritere kryesore, përkatësisht:

- Mbulimi i Kostove
- Efikasiteti Menaxhues
- Efikasiteti Mjedisor
- **Përballueshmëria**

Kriteri i mbulimit të kostove nga ERRU zbatohet mbas një analize të kostove që Shoqëria paraqet duke pranuar vetëm ato të justifikuara. Efikasiteti menaxhues vlerësohet mbi bazën e analizës së treguesit të Ujit Pa të Ardhura, kryesisht të komponentit të humbjeve administrative që lidhen direkt me kapacitetet dhe angazhimin e stafit të shoqërisë për një menaxhim efikas të veprimtarisë së saj.

Mbasi vlerësohet edhe mundësia për një propozim me blloqe të tarifës për mos shpërdorimin apo mbi përdorimin e burimeve ujore, kriteri i fundit për aprovimin e tarifave nga ERRU mbetet **Përballueshmëria e pagesës së faturës së shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve nga konsumatorët familjarë**.

Koncepti i Përballueshmërisë, si përkufizim lidhet me mundësinë ekonomike të konsumatorëve familjarë për të paguar për konsumin e nevojshëm të shërbimeve të UK pa cenuar vlerën minimale që një familje ka nevojë për të konsumuar shërbime/mallra të tjera të nevojshme.

Pyetja që ngrihet është nëse fatura e ujit për konsumatorët familjarë është e përballueshme financiarisht në rastin kur Shoqëria UK propozon tarifa që synojnë mbulimin 100% të kostove të shërbimeve FU dhe KUZ me të ardhurat nga fatura e ujit?

Në fakt konsumatorët familjarë instiktivisht kanë gjithnjë tendencë që ti konsiderojnë tarifat e ujit të larta pavarësisht se në ç'vlerë ato propozohen. Për të zbutur një reaksion apriori kundër tarifave të propozuara nga Shoqëria kërkohet një analizë e këtij kriteri bazuar në një tregues specifik krahasues për të vlerësuar nëse këto tarifa janë vërtet të përballueshme financiarisht nga konsumatorët familjarë ose jo.

Praktika e deritanishme e ERRU-së në vlerësimin e këtij treguesi ka konsistuar:

- Në marrjen parasysh si kriter që fatura për shërbimin e FU dhe KUZ të jetë e PËRBALLUESHME financiarisht nga konsumatorët familjarë, nuk duhet të kalojë 5% të të ardhurave të tyre mesatare⁴.

⁴ Rezoluta e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut për Ujë të Pijshëm dhe Kanalizime, në Këshillin e të Drejtave të Njeriut në 24 Mars 2011 rekomandon që shpenzimet për faturën e ujit nuk duhet të tejkalojnë 5% të të ardhurave mesatare mujore familjare.

Ky koeficient reflektohet në metodologjinë e aprovuar nga KKRR sipas Vendimit Nr. 39, datë 09.12.2015 «Për miratimin e Politikës tarifore për shërbimet e FU dhe KUN ».

- Në marrjen në konsideratë në vend të të ardhurave mesatare mujore të shpenzimeve mesatare të një familje duke qenë se INSTAT jep të dhëna vetëm për këto të fundit.
- Rregullatori përjashton nga ky rregull “familjet në nevojë” që trajtohen me politika dhe mbështetje financiare të veçanta nga pushteti qendror dhe/ose lokal.

Kriteri i përdorur nga ERRU për verifikimin e Përballueshmërisë i referohet praktikave ndërkombëtare, si Evropiane edhe ato të Kombeve të Bashkuara për këtë subjekt.

Theksohet fakti që Rezoluta e mëparshme e Kombeve të Bashkuara e vitit 2006 e përcaktonte këtë kufi në 3%.por duke analizuar nevojat për investime për të plotësuar kërkesat për furnizimin me ujë të pijshëm të sigurtë dhe akses për të gjithë popullsinë, si edhe nevojat për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, ky kriter për faturën e shërbimeve u rrit në 5%.

Në kontinentin Evropian përgjithësisht me të ardhura mjaft të larta familjare ky kriter zbret në vlerën 3% të të ardhurave mesatare familjare, siç tregohet në Tabelën 35.

Tabela 35. Situata mbi Përballueshmërinë në disa vende të Europës

Shteti	Kufiri i Përballueshmërisë	Fatura e Ujit ndaj Ardhurave Mujore për Familje (në %)	Komente
Belgjika	3%	1,1%	Diskutojnë të ulin kufirin e përballueshmërisë në 2%.
Gjermania	-	0,9%	Tarifat nga Pushteti Lokal dhe mbulojnë kostot pa fitim.
Spanja	-	0,8%	Tarifat vendosen nga Pushteti Lokal.
Skocia, Anglia	3%	nën 3%	Tarifat vendosen nga Rregullatori
Italia	-	Nuk përdoret si kriter	Tarifa merr parasysh një koeficient të përqindjes së ujit të papaguar që ndryshon nga Veriu-Jug (2,4-8,6%)
Shqipëria	5%	Rreth 2%	Jepet ndaj shpenzimeve mesatare mujore
Kombet e Bashkuara	5%		Rezoluta e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut për Ujë të Pijshëm dhe Kanalizime, në Këshillin e të Drejtave të Njeriut në 24 Mars 2011.

Burimi: WAREG – 2017, *Affordability in European Water Systems*

Rikonceptimi i Kriterit të Përballueshmërisë

Vlerësimi i saktë i këtij kriteri për aprovimin e tarifave të propozuara nga Shoqëritë UK ka rendësi të veçantë sepse mundëson një përlllogaritje dhe planifikim më të saktë të nevojave që kanë Shoqëritë UK për grante nga Qeveria Qendrore, si për të mbuluar shpenzimet e O&M, edhe ato të investimeve për të mbuluar Kostot Totale të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve.

Metodologjia e deritanishme që përdor ERRU, merr parasysh shpenzimet mujore mesatare të një familje, por nuk konsideron faktorin e shpërndarjes së të ardhurave sipas shtresave të ndryshme të popullsisë.

Përballueshmëria si kriter matës është më i perceptueshëm nga konsumatori nëse shprehet në vlerë mesatare të faturës së ujit që ai duhet të paguajë, kur faturohet me matje dhe aforfe (fatura Lek/muaj), dhe jo si kosto mesatare e shërbimeve të FU dhe KUZ për 1m³ ujë (Lek/m³ ujë).

Duke patur parasysh krahasimin me vlerën e faturës mujore të ujit që duhet të paguajnë konsumatorët familjarë, përfaqësuese në këtë rast do të ishte një familje me 4 persona dhe që faturohen me matje. Për këtë kategori familjesh do të merret parasysh një normë konsumi mesatar ditor prej rreth 100 litra/ditë, person, si vlerë e konfirmuar tashmë për zonat e shërbimit në Shqipëri që janë të pajisura 100% me ujëmatës.

Si vlerë krahasimi mund të përdoret gjithashtu një familje me 4 persona, por të faturohen aforfe me normën prej 150 litra/dite, person. Në fakt kjo e fundit duhet të përdoret si kriter për rastin e Shoqërive UK që kanë një tregues të ulët të mbulimit të konsumatorëve me ujëmatës, dhe natyrisht nuk do të përdoret si kriter për Shoqëritë UK që i kanë të mbuluar 100% të konsumatorëve me matje, ose mbi 80% të tyre.

INSTAT që nga viti 2014 ofron të dhëna të detajuara që mundësojnë rikonceptimin e analizës dhe vlerësimit të kriterit të Përballueshmërisë, përkatësisht:

- Jepen të dhëna në bazë qarku për shpenzimet mesatare mujore të një familje për 10 kategori (decila) nga shtresa e varfër (decila 1) deri tek shtresa e të pasurve (decila 10).
- Të dhënat janë të detajuara për madhësi të ndryshme të familjeve sipas numrit të personave dhe si mesatare e tyre. Të dhënat jepen për një mesatare 3,8 persona për familje për totalin e 10 decilave dhe për një mesatare prej 3,9 persona për familje për decilat nga 1-9.
- Të dhënat japin në përqindje shpenzimet mujore të familjeve për totalin e shpenzimeve në zërin energji, ujë, qera banesë (rreth 10,2% deri 10,4% e totalit).
- Të dhënat tregojnë se konsumi mesatar i decilës 10 është 2,35 herë më i lartë se i mesatares së 90% të familjeve, faktor i cili duhet marrë në konsideratë për pabarazinë e theksuar në lidhje me të ardhurat/shpenzimet e kësaj shtrese ndaj pjesës tjetër të popullsisë.

Një shembull i të dhënave që ofron INSTAT bazuar në anketën vjetore të shpenzimeve familjare për vitin 2017 jepet në Tabelën 36.

Tabela 36. Shpenzimet Familjare Mesatare Mujore – Viti 2017

Decili	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
1	27,299	34,309	35,926	34,023	31,562	28,715	30,850	39,360	40,565	34,187	32,907	29,639
2	45,128	41,000	47,466	41,967	43,621	40,043	37,714	51,174	44,631	48,881	44,748	9,713
3	54,262	43,354	54,170	46,528	48,819	46,676	50,086	59,654	57,645	53,101	53,133	40,485
4	56,811	54,019	59,060	56,137	57,535	54,474	47,060	71,145	61,457	58,849	62,478	47,123
5	59,301	55,246	56,309	53,571	63,163	52,285	60,356	61,219	66,649	60,265	69,367	46,046
6	64,325	57,507	77,765	69,239	68,872	64,276	70,924	71,652	68,349	75,761	73,967	58,963
7	77,625	64,185	85,158	72,912	76,013	66,257	74,798	80,817	72,434	79,375	77,376	61,310
8	87,085	67,052	91,334	70,219	86,030	92,150	78,955	72,722	81,933	84,465	92,259	75,886
9	94,555	89,439	110,239	85,987	110,271	82,262	104,372	71,885	116,322	101,662	108,199	101,133
Shuma 1-9	566,391	506,111	617,427	530,583	585,886	527,138	555,115	579,628	609,985	596,546	614,434	470,298
Mesatare (1-9)	62,932	56,234	68,603	58,953	65,098	58,570	61,679	64,403	67,776	66,282	68,270	52,255
10	141,868	91,948	138,155	101,560	163,988	135,669	154,703	183,805	167,664	163,115	158,404	136,702
Shpenzimet Mesatare Mujore (1-10)	69,948	59,806	76,129	63,214	74,987	66,280	70,981	76,343	77,765	75,966	77,284	60,700

Nga të dhënat e Tabelës 36 duke patur parasysh se të dhënat për shpenzimet mesatare mujore familjare jepen të ndara në 10 decila të shtresave të shoqërisë duhet të përcaktohet se çfarë vlerë e shpenzimeve mesatare mujore duhet konsideruar si më e arsyeshme dhe përfaqësuese për zbatimin e kriterit të përbalueshmërisë.

Referuar të dhënave të INSTAT sipas strukturës së tabelës së mësipërme, konsiderohet e arsyeshme që fillimisht të përjashtohen për llogaritjen e vlerës mesatare të shpenzimeve mujore familjare shtresa e pasur e familjeve të cilët konsumojnë mesatarisht mbi 2 herë të vlerës mesatare të mbi 90% të familjeve në rang vendi. Nëse do të merret në konsideratë në mesataren e përgjithshme edhe decila 10 e «të pasurve». Kjo e fundit do ta ç'ballancojë mjaft mesataren në kurriz të shtresave më të varfra.

Pra do të konsiderohet si mesatare përfaqësuese mesatarja e shumës së shpenzimeve mesatare mujore familjare të decilave nga 1 deri 9.

Gjithashtu për efekt krahasimi vlerësimi i Përbalueshmërisë mund të bëhet edhe për shpenzimet e familjeve relativisht të varfëra të decilave 1 dhe 3. Në fakt krahasimi i vlerës së shpenzimeve mujore familjare të këtyre shtresave nuk duhet të bëhet me vlerën përfaqësuese të faturës mujore të shërbimeve. Duhet të kemi parasysh që norma mesatare e konsumit prej 100 litra/ditë, person presupozon që këto shtresa të kenë konsum mesatar mujor më të vogël se 100 litra ditë⁵ për person, që i referohet fatura mujore familjare, ndërkohë që decilat e tjera (nga 5 e sipër) normalisht duhet të kenë një konsum më të madh se 100 litra/ditë, person.

Nga ana tjetër duhet marrë parasysh fakti që në përgjithësi sektori ofron shërbime me orar të kufizuar dhe pa presionin e duhur, faktor tjetër vlerësues për përbalueshmërinë janë edhe kostot shtesë që duhet të përballojë konsumatori për energjinë e konsumuar nga pompat individuale që furnizojnë rezervuarët që ka secila familje mbi tarraca apo çati të banesave të tyre.

⁵ Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO), janë të nevojshme nga 50 deri 100 litra për person në ditë në mënyrë që të plotësohen nevojat bazike.

Këto kosto vlerësohen të jenë rreth 2-fishi i koston së faturës së ujit⁶, por duke patur parasysh karakterin tranzitor të regjimit me orar të kufizuar, këto kosto nuk do të përfshihen në kriterin e përballueshmërisë.

Nga ana tjetër, të dhënat që përcaktojnë kriterin e përballueshmërisë duhet të jenë në dispozicion të Shoqërive UK që ato ti kenë parasysh si reference krahasuese për vlerat e tarifave që ato propozojnë për tu aprovuar nga ERRU-ja.

Vlerësimi i Kriterit të Përballueshmërisë për Sektorin Ujësjellës Kanalizime

Më poshtë jepet vlerësimi i gjendjes së Sektorit UK në lidhje me kriterin e Përballueshmërisë duke patur parasysh vlerat e faturave mujore dhe të dhënave të INSTAT për vitin 2017. Siç u përmend më sipër krahasimi dhe vlerësimi i situatës do të bëhet me të dhënat mesatare të shumatores së decilave nga 1 deri 9, të deciles 1 dhe të deciles 3.

Tabela 37. Fatura Mujore me TVSH për Konsumatorët Familjar – Viti 2017

Nr.	Shoqëria	FU Tarifë variabël	Tarifë fikse	KUZ Tarifa variabël	Fatura Mujore 12 m3 (me matje)	Fatura Mujore 18 m3 (aforfe me 4 persona)
1	Berat-Kuçovë	48	100	13	998	1,438
2	Bulqizë	17	100		365	487
3	Devoll	38	50		607	881
4	Delvinë	58	167	18	1,295	1,842
5	Dibër	27			389	583
6	Durrës	70	150	50	1,908	2,772
7	Elbasan	38		8	662	994
8	Fier	52	200	13	1,176	1,644
9	Gramsh	32	60		533	763
10	Gjirokastër	46	100	11	941	1,351
11	Kavajë	38		15	763	1,145
12	Kolonjë	38	100	10	811	1,157
13	Korçë	72	140	42	1,810	2,630
14	Krujë	33		8	590	886
15	Kurbin	30	50		492	708
16	Lezhë	58	200	18	1,334	1,882
17	Librazhd Prrenjas	42	100	15	941	1,351
18	Lushnje	58	100	17	1,200	1,740
19	Malësi e Madhe	50	167		920	1,280
20	Mat	23		2	360	540
21	Mirditë	30		10	576	864
22	Peqin	30	50		492	708
23	Përmet	40	100		696	984
24	Pogradec	22/62	200/100	11/33	1,170	2116.8
25	Poliçan	50	100	12	1,013	1459.2
26	Pukë	35	100	8	739	1048.8
27	Rrogozhinë	48	50	10	895	1312.8
28	Sarandë	52	150	20	1,217	1735.2
29	Skrapar	35	100	10	768	1092
30	Shkodër	40	100	15	912	1308
31	Tepelenë	33	90	12	756	1080
32	Tiranë	65	200	11	1,334	1881.6
33	Tropojë	19			274	410.4
34	Ura Vajgurore	40			576	864
35	Vau i Dejës	42	83	7	805	1158
36	Vlorë	30		11	590	885.6


⁶ COWI, draft Modeli i Financimit të Strategjisë së Sektorit FU dhe KUZ, Maj 2016

Tabela 37 jep gjendjen e tarifave që aplikojnë Shoqëritë UK sipas strukturës volumore dhe fikse, si dhe vlerat korresponduese të faturës mujore të konsumatorëve familjarë me 4 persona që faturohen me matje dhe aforfe.


Grafiku 23 dhe 24 jep gjendjen e Sektorit UK në drejtim të rezervave që ekzistojnë për rritjen e faturës në respektim të kriterit të përballueshmërisë që fatura e shërbimeve nuk duhet të kalojë 5% të shpenzimeve mesatare mujore familjare.

Krahasimi jepet për mesataren e decilave 1-9, të deciles 1 dhe deciles 3. Pikat në grafik përfaqsojnë vlerat mesatare të faturës mujore të shërbimeve për tarifatat që Shoqëritë zbatojnë në vitin 2017, përkatësisht për faturimin me matje dhe atë aforfe.

Grafiku 23 Faturimi me Matje Mesatar per Sektorin (ne %)



Grafiku 24 Faturimi Aforfe Mesatar për Sektorin (ne %)




Referuar dy grafikeve të mësipërm, Tabela 38 jep në mënyrë të përmblodhur gjendjen e Sektorit UK në drejtim të përmbushjes së kriterit të Përballueshmërisë.

Tabela 38. Gjendja e Përmbushjes së Kriterit të Përballueshmërisë për Sektorin UK

Decilat	Për Faturimin me Matje	Për Faturimin Aforfe
Përballueshmëria	5%	5%
Mesatare (Decila 1-9)	1,2%	1,85%
Decila 3	1,65%	2,35%
Decila 1	2,55%	3,6 %

Grafiku 25 jep gjendjen e Sektorit të UK për secilin qark më vete në lidhje me përmbushjen e kriterit të Përballueshmërisë



Përfundime:

- ❑ Në rang vendi si mesatare Përballueshmëria duket e garantuar dhe me mjaft rezerva edhe për shtresën e varfër të popullsisë (decila 1), por që vlerësimi duhet bërë sipas secilit qark sepse gjendja nuk paraqitet e njëjtë nga njëri qark në tjetrin.
- ❑ Përgjithësisht secili qark ka tarifa mesatare të shërbimeve që plotësojnë kriterin e Përballueshmërisë, si për faturimin me matje, edhe për atë aforfe.
